At the end I would also like to point out that the global spatial data infrastructure (GSDI) in the spatial data infrastructure hierarchy (SDI) is the highest and most generalized level of spatial data. Logically, it should be related to the NSDI- national infrastructure of spatial data of Albania, but in this case the two infrastructures of Albania, the national and the global are not related to each other, neither in formal legal terms nor in technical terms in Albanian geoportal. Certainly this could be a next challenge, which must be analyzed in the future.

1 HYRJJE

Mjedisi është shumë i rëndësishëm për të gjitha vendet në botë sepse të gjitha llojet e burimeve mund të shfrytëzohen, habitatet mund të gjenden dhe gjithashtu mund të merret vendimmarrja e duhur në lidhje me zgjidhjen e shumë llojeve të fatkeqësive natyrore si ndotja e ajrit, përmytjet etj. Pothuajse në çdo vend të botës ka shumë ndryshime dhe përkeqësime të mjedisit përmes deponive, gërmimeve dhe ndotjeve të shkaktuara nga aktivitetet urbane, industriale, akuakulturës dhe bujqësore.

Një infrastrukturë e të dhënave hapësinore (SDI) mund të mbështesë përmbushjen e kërkesave të direktivave të niveleve të ndryshme. Mund të ndihmojë zyrtarët administrativë dhe shkencëtarët të gjejnë të dhënat e nevojshme, të publikojnë të dhëna në mënyrë që përdoruesit e tjerë të jenë në gjendje t'i përdorin ato dhe të përgatisin raporte që pasqyrojnë gjendjen e mjedisit në përgjithësi.

Këto informacione mund të rrjedhin nga, ndër të tjera, teknologjitë e ndjesisë nga larg, hartografimit dhe rilevimit. Të dhënat statistikore mund të përfshihen në këtë përkufizim në diskrecionin e agjencisë mbledhëse (Urdhri Ekzekutiv i Dokumenteve Presidenciale 12906, 1994).

Prandaj, është e rëndësishme të sigurohen informacione përkatëse hartografike nga burime të ndryshme në të gjitha nivelet e njohurive nga serverët ndërkombëtarë hartografikë për komunitetet e vogla.

Kushdo që ka një qasje në internet, mund t'i modifikojë shënimet, dhe t'i sigurojë asaj një përshkrim adekuat (Goodchild, M., 2009). Pothuajse çdo ditë të gjithë e përdorin Geo-informacionin rregullisht, mjaft shpesh pa qenë të vetëdijshëm për të (Swisstopo, 2017).

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) është një sistem i kompjuterizuar për të kapur, analizuar, ruajtur, manipuluar, menaxhuar dhe paraqitur të dhëna të referuara gjeografikisht, me fjalë të tjera, GIS-i na lejon të vizualizojmë, pyesim, analizojmë dhe interpretojmë të dhënat për të kuptuar marrëdhëniet, modelet dhe trendet (ESRI.com, 2017). Infrastruktura e të dhënave hapësinore (SDI) është një koncept dinamik, hierarkik dhe shumë-disiplinor që përfshin njerëzit, të dhënat, rrjetet e hyrjes, politikën institucionale, standardet teknike dhe dimensionet e burimeve njerëzore (Rajabifard, 2008). SDI-të fillimisht u zhvilluan si një mekanizëm për të lehtësuar aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave hapësinore për t'u përdorur brenda një ambienti të GIS-it (Rajabifard, 2008).

Shumë vende në botë prodhojnë dhe mirëmbajnë Informacionin Gjeografik të tyre (GI), pasi të dhënat e tilla janë thelbësore për të marrë vendime të shëndosha në nivel lokal, rajonal dhe global (Nebert, 2004). Sot është rritur rëndësia e informacionit gjeografik për shfrytëzime komplekse në ekonomi, shoqëri dhe mjedis, por kostoja për të prodhuar, shkëmbyer dhe shpërndarë të dhënat është shumë e lartë.

Rrjeti ose infrastruktura për shpërndarjen, integrimin dhe menaxhimin e të dhënave mund të realizohet brenda një autoriteti lokal, një province, një kombi, një rajoni ose e gjithë bota. Brenda një kombi, një rajoni dhe në tërë globin, infrastrukturat e të dhënave hapësinore emërtohen si Infrastruktura Kombëtare, Regjionale dhe Globale e të Dhënave Hapësinore (NSDI, RSDI, GSDI) (Idrizi, et al, 2009).

Bota ka ndryshuar, në lidhje me të dhënat hapësinore, nga qasja tejet e centralizuar, ku qeveritë mbanin kontroll të pakontestuar mbi të dhënat nën interesin kombëtar.

Në dekadat e fundit ka një nevojë thelbësore për zhvillim jo vetëm të një Infrastruktura Globale të të Dhënave Hapësinore (GSDI) që mund të përdoret nga të gjitha vendet, por edhe për zhvillimin e një projekti Global Hartografik. Harta Globale është një tërësi hartash dixhitale që mbulojnë me saktësi të caktuar tërë globin për të shprehur statusin e mjedisit në nivel global (Lubishtani et al, 2020). Një iniciativë për të zhvilluar Hartën Globale nën bashkëpunimin ndërkombëtar, Projekti i Hartografisë Globale, u mbështet në vitin 1992 nga Ministria e Ndërtimit të Japonisë, menjëherë pas propozimit për krijimin e Hartës Globale në Samitin e Rio de Janeiro në 1992.

Republika e Shqipërisë është përfshirë në projektin e Hartografisë Globale përmes Autoritetit Shtetëror për Informimin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Departamentin e Gjeodezisë së Universitetit Politeknik të Tiranës dhe, ka zhvilluar të dhënat vektoriale dhe rasteriale për Hartën Globale versioni 2 për Shqipërinë, që janë botuar në 14 korrik 2016 në www.iscgm.org.

Në këtë tezë të disertacionit, është dhënë një përmbledhje e përgjithshme e SDI-së, GSDI-së dhe zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale në formatin vektor dhe raster për Shqipërinë. Përveç kësaj është dhënë shpjegimi i transferimit të të dhënave të Hartës Globale në UNGIS (Rajabifard 2017). Ekzistojnë gjithashtu propozime për ide për vlerësimin dhe përmirësimin e të dhënave hapësinore të GM-së nga aspekte të ndryshme për të zbatuar një shpërndarje më të efektshme dhe operative të të dhënave hapësinore brenda kornizës së të dhënave të Hartës Globale nën juridiksionin e Kombeve të Bashkuara (KB).

1.1 Motivi

Procesi i zhvillimit të Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore në Shqipëri ka filluar në dekadën e fundit dhe ai është ende në proces. Për ta bërë më të lehtë aksesin në të dhënat dhe bashkimin e informacionit në lidhje me tema të ndryshme, siç janë inxhinieria bregdetare, hidrografia dhe vëzhgimi, mbrojtja e mjedisit, ruajtja detare, planifikimi rajonal dhe hulumtimi bregdetar, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG); Instituti i Transportit; Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT); Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë; Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet akademike janë duke punuar në zhvillimin e SDI-së për Shqipërinë dhe të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë. Të dhënat e zhvilluara të SDI-së dhe Hartës Globale do të mundësojnë që punonjësit dhe / ose / shkencëtarët të gjejnë të dhënat e nevojshme.

Përveç qasjes më të lehtë të të dhënave dhe bashkimit të informacionit përmes një gjeoportali qendror, është një aspekt përkatës dhe do të jetë edhe më i rëndësishëm në të ardhmen kur direktivat (siç është INSPIRE- Infrastruktura për Informacionin

Hapësinor në Evropë) do të zbatohen dhe do të kërkojnë të dhëna dhe raporte për një fushë specifike të kërkimit dhe marrjes së vendimit.

Të dhënat e zhvilluara në kuadrin e Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore dhe Hartës Globale të Shqipërisë, të vendosur në një gjeoportali qendror, do të ndihmojnë në përputhje me kërkesat e raportimit për shkak të standardizimit të tij, përkatësisht harmonizimit dhe qasjes së lehtë dhe të centralizuar në të dhënat.

Harmonizimi i të Dhënave kërkon gjithashtu harmonizimin e Metadatave. Për të dhënat dhe metadatat, termat luajnë rol të rëndësishëm (<http://gsdi.org/>).

Sasia e madhe e informacioneve hartografike të ndërtuara nga të gjitha burimet e ndryshme ka provokuar një vështirësi në ruajtjen e të gjithë këtyre informacioneve në një mënyrë të organizuar mirë. Organizatat duhet të koordinojnë dhe shpërndajnë të gjitha llojet e informacioneve, kryesisht të dhënat hartografike. Kjo është baza për përparimin dhe zhvillimin e projekteve, duke u përqendruar në njohuritë globale dhe planifikimin më të mirë në Republikën e Shqipërisë.

Ndërtimi i SDI-s është një detyrë komplekse, jo vetëm për shkak të natyrës evolucionare të konceptit të SDI-së, por aq më shumë për shkak të kontekstit shoqëror, politik, kulturor dhe teknologjik, të cilit duhet t'i përgjigjet një zhvillim i tillë (Williamson *et al*, 2003).

E gjithë bota është e ndarë në kontinente dhe vende të ndryshme që menaxhohen nga institucione të ndryshme, ku zhvillohen të dhëna gjeohapësinore me standarde të njëjta ose të ndryshme. Të dhënat globale gjeohapësinore duhet të kenë standarde të njëjta, për t'u përdorur dhe për t'u shkëmbyer në mënyrë që të arrihet analiza e një problemi më lehtë dhe me një kosto të ulët.

Mbi bazën e të gjitha të përmendura më sipër, ekziston nevoja e qartë për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë, duke inicuar vendin jo vetëm që të përfshihet në projektin e Hartës Globale, por edhe të kontribuojë me të dhënat e veta në HB në zgjidhjen e çështjeve mjedisore dhe çështjeve të tjera në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

1.2 Objektivat e hulumtimit

Në ditët e sotme, Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore bëhet një temë për vendet në zhvillim, informacioni gjeografik prodhohet me metodologji të shtrenjta, shpesh duke mbivendosur të dhënat me saktësi të ulët.

Ndërtimi i një SDI-e fillestare në Republikën e Shqipërisë është sfiduese, si dhe premtuese. Nga njëra anë është sfiduese për shkak të koordinimit dhe përpjekjes që duhet të vihet në një zhvillim të tillë të SDI-së. Nga ana tjetër, është premtuese sepse standardet janë plotësuar dhe teknologjitë më të reja mund të përdoren. Prandaj, hapi i parë është analiza e SDI-ve të para – ekzistuese, që mundësojnë mësim prej tyre. Si hapi i dytë është analizimi i këtyre të dhënave. Hapi i fundit është nxjerrja e

kurtheve të mundshme nga njëra anë dhe avantazhet, përkatësisht idetë e mira në lidhje me zhvillimin e mëtutjeshëm të SDI-së në Shqipëri.

Një SDI bashkon shumë palë (autoritete, institucione etj), shumë të dhëna dhe metadata (të ruajtura në të ashtuquajturat nyje të infrastrukturës). Para fillimit të zhvillimit, të gjitha grupet e të dhënave dhe matadatave duhet të jenë të njohura për të parë se si dhe nëse ato mund të futen në infrastrukturë. Nëse të dhënat dhe metadatat nuk janë tashmë të disponueshme përmes shërbimeve ekzistuese, një hap i hershëm në zhvillimin e SDI-së është vendosja e shërbimeve në mënyrë që dosjet të mos transferohen dhe që versioni më i përditësuar i të dhënave dhe metadatave është në dispozicion nga një burim që palët e interesuara kanë qasje.

Pasi të dhënat bëhen të disponueshme lehtësisht për çdo palë të interesuar përmes shërbimeve në ueb, disponueshmëria e shërbimeve u mundëson palëve të përdorin të dhënat dhe të zbatojnë kërkesat e raportimit. Për këtë përdorim nga njëra anë aspektet si modelimi i të dhënave (d.m.th. si duhet të duken të dhënat) dhe kërkesat e tjera zyrtare në lidhje me të dhënat dhe metadatat janë të rëndësishme.

Objektivat e ndryshme të tezës pas studimit të nevojave të projektit janë:

- Të paraqitet një përmbledhje e plotë e organizimit infrastrukturor të të Dhënave Hapësinore në përgjithësi, duke marrë parasysh nivelet e ndryshme të hierarkisë së SDI-së. Në këtë kontekst duhet të shpjegohen edhe përbërësit kryesorë të një SDI-e.
- Të vlerësohet statusi aktual i zhvillimit të Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore (SDI) në Shqipëri në dekadën e fundit, si dhe zhvillimet e kërkuara duke përdorur arkitekturën INSPIRE si standard krahasimi dhe udhëzimi.
- Për të dhënë një përmbledhje të plotë të Infrastrukturës Globale të të Dhënave Hapësinore, zhvillimin e saj në dy dekadat e fundit si dhe organizimin e saj konceptual.
- Për të dhënë një përmbledhje të plotë të zhvillimit të projektit të Hartës Globale– GM dhe marrëdhënies së saj me Infrastrukturën Globale e të Dhënave Hapësinore GSDI.
- Për të dhënë një përmbledhje të plotë të situatës së përfshirjes së tokave shqiptare në projektin e Hartës Globale.
- Të shpjegojë përfundimin e projektit të Hartës Globale dhe transferimin e të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë në Sistemin e Informacionit Gjeografik të Kombeve të Bashkuara UNGIS.
- Të bëhet vlerësimi i cilësisë së të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë dhe përdorimi dhe qëndrueshmëria e të dhënave për përdorim në të ardhmen.

Qëllimi kryesor i këtij disertacioni të doktoratës është të vlerësojë statusin dhe momentet historike të zbatimit e zhvillimit të projektit të Hartës Globale të Republikës së Shqipërisë dhe të vlerësojë përdorueshmërinë e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë, si e dhënë që kontribuon për zgjidhjen e çështjeve të mjedisit jetësor në nivel botëror.

Hulumtimi do të udhëhiqet nga pyetjet e mëposhtme:

1. Cilët janë palët kryesore të interesit në zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë?
2. Çfarë marrëveshje institucionale është vendosur për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë?
3. Cilat janë problemet dhe sfidat me të cilat përballlet zhvillimi i të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë?
4. Çfarë mësimesh mund të mësohen nga të dhënat e Hartës Globale dhe përvojës në Shqipëri?

Qëllimi kryesor i projektit të Hartës Globale është mbledhja e të dhënave globale të të dhënave gjeohapësinore nga të gjitha shtetet dhe organizatat e interesuara për të zhvilluar dhe për të pasur qasje të lehtë në informacionin gjeografik dixhital në nivelin global të shkallës 1: 1.000.000 për vektor, si dhe rezolucionin hapësinor 30” për të dhënat rasteriale. Kjo është e dobishme për të realizuar zbatimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare / globale / për mbrojtjen e mjedisit, për mbikëqyrjen e fenomeneve kryesore të mjedisit dhe për të inkurajuar rritjen ekonomike (<http://www.iscgm.org/>).

Komiteti Drejtues Ndërkombëtar për Ndërtimin e Hartës Globale Botërore (ISCGM) është një institucion ndërkombëtar me qendër në Tsukuba, Japoni, të cilit, në një bazë vullnetare, shtetet, përkatësisht agjencitë shtetërore që merren me të dhëna gjeohapësinore, aplikojnë me të dhëna në përputhje me standardet e përcaktuara nga ISCGM.

Meqenëse bota në tërësi është e ndarë në kontinente dhe vende të ndryshme që ndiqen nga institucione të ndryshme që prodhojnë të dhëna gjeohapësinore me standarde të njëjta ose të ndryshme, mendohet që këto të dhëna gjeohapësinore të kenë standarde të njëjta, në mënyrë që ato të mund të përdoren, për t’u shkëmbyer dhe për të analizuar problemet më lehtë dhe me kosto të ulët.

Republika e Shqipërisë, në kuadër të projektit për përpilimin e hartës globale, përfaqësohet nga Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), si institucioni përgjegjës për hartografinë e Shqipërisë në nivel kombëtar (Lubishtani, 2016). Zhvillimi i të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë është bërë në nivelin akademik brenda Departamentit të Gjeodezisë të Universitetit Politeknik të Tiranës, me qëllim të mbështetjes, ndihmës dhe përmirësimit të hartografisë shqiptare nëpërmjet këtij disertacioni të doktoratës.

1.3 Qasja Metodologjike

Metodologjia e përdorur për të marrë informacione përkatëse nga institucionet vendore, konsiderohet si një pikë e rëndësishme për të marrë një njohuri të mirë e të

vërtetë për zonën. Prandaj, marrja e një informacioni të tillë nga institucionet vendase dhe shndërrimi i tij në format dixhital duke përdorur Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) është thelbësor për vendosjen e kufijve kadastrale, informacioneve socio-mjedisore dhe informacioneve të tjera të nevojshme për zhvillimin e SDI-së në vend dhe zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë. Ky hulumtim propozon zhvillimin e një metodologjie specifike për të përfshirë informacionin e marrë nga institucionet e ndryshme shtetërore në lidhje të dhënat e nevojshme, me qëllim të furnizimit të Infrastrukturës Globale të të Dhënave Hapësinore dhe të dhënave të Hartës Globale.

Sa i përket zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë, hulumtimi ndjek një metodë metodologjike, ku Informacionet Gjeografike sigurohen kryesisht nga ASIG-u, si dhe nga institucionet tjera shtetërore me bashkëpunim me Universitetin Politeknik në Tiranë.

Rezultati i pritshëm në këtë proces është zhvillimi dhe vizualizimi i grupeve të të dhënave në formatin raster dhe vektor nga burime të ndryshme, të cilat do të paraqesin rëndësinë dhe përdorshmërinë e grupeve të të dhënave për qëllimet e projektit të Hartës Globale.

Zhvillimi i të dhënave të Hartës Globale Shqiptare është realizuar në një bashkëpunim të ngushtë midis Autoritetit Shtetëror për Informimin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Departamentit të Gjeodezisë së Universitetit Politeknik të Tiranës në një fushë të krijimit të GSDI-së shqiptare me studim rasti mbi zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë.

1.4 Korniza Konceptuale e Tezës

Në përgjithësi, hulumtimi është i ndarë në nëntë kapituj që mund të përshkruhen shkurtimisht në skicën e tezës, ku tregohet se si lidhen kapitujt dhe pjesët me njëra-tjetrën. Paraqitja grafike e kornizës konceptuale të tezës është dhënë në më poshtë figurën 1.1.

Kapitulli i parë është një prezantim i përgjithshëm i zhvillimit të SDI-së dhe zhvillimit të veçantë të NSDI-së të Shqipërisë si pjesë kontribuese e GSDI-së, si dhe një përmbledhje e shkurtër e zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë. Në këtë kapitull është dhënë edhe motivimi kryesor për tezën, qasja metodologjike dhe korniza e shkurtër konceptuale e strukturës së tezës.


Kapitulli 2 mban titullin Organizimi Infrastrukturor i të Dhënave Hapësinore. Në nënseksionin e parë të këtij kapitulli është dhënë një përmbledhje e literaturës me disa përkufizime dhe koncepte kryesore të SDI-së. Këtu është dhënë edhe një përmbledhje e shkurtër e historikut të zhvillimit të SDI-së. Në nënseksionin tjetër janë sqaruar në më shumë detaje përbërësit e arkitekturës SDI me fokus në arkitekturën e INSPIRE - Infrastruktura e informacionit hapësinor në Evropë. Nënseksioni tjetër shpjegon disa ndryshime midis sistemit të informacionit gjeografik GIS dhe SDI-infrastrukturës së të dhënave hapësinore. Në nënseksionin vijues është dhënë një shpjegim i niveleve të ndryshëm të hierarkisë në SDI. Nënseksioni i fundit i këtij kapitulli jep një përshkrim të detajuar të çështjeve të organizimit infrastrukturor


dhe të të dhënave hapësinore të SDI-së me fokus studimin e organizimit të metadatës, standardizimin e të dhënave, harmonizimin e të dhënave dhe ndërveprimin e të dhënave.


Kapitulli 3 mban titullin Gjendja e Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore (SDI) në Shqipëri (Nikolli et al, 2020). Këtu shpjgohet pasqyra historike e procesit të zhvillimit të SDI-së në Republikën e Shqipërisë. Në nënkapitullin tjetër shpjgohet edhe situata aktuale në lidhje me zhvillimin e SDI-ve në Republikën e Shqipërisë.


Kapitulli 4 mban titullin Infrstruktura Globale e të Dhënave Hapësinore - GSDI. Ky kapitull është i ndarë në dy nënkapituj të tjerë. Në nënkapitullin e parë së pari është sqaruar pasqyra e historikut të zhvillimit të GSDI-së në botë. Këtu në detaje sqarohet organizimi konceptual i GSDI-së. Nënkapitulli i dytë merret me projektin e Hartës Globale në botë. Këtu është dhënë përmbledhja e përkufizimeve dhe organizimit konceptual të projektit të Hartës Globale-GM. Shpjgohet organizimi konceptual i të dhënave brenda projektit të Hartës Globale (GM), elementet matematikore të të dhënave në Hartën Globale, standardizimi i të dhënave në Hartën Globale, zhvillimi i Metadateve të Hartës Globale, si dhe disa kufizime dhe çështje kryesore të projektit të Hartës Globale. Është dhënë gjithashtu përdorimi dhe aplikimet e mundshme të të dhënave të Hartës Globale. Këtu është dhënë gjithashtu një përmbledhje e shkurtër e historikut të zhvillimit të projektit të Hartës Globale, dhe shpjgohet marrëdhënia midis Hartës Globale dhe Infrastrukturës Globale të të Dhënave Hapësinore - GSDI.

Kapitulli 5 mban titullin Trojet Shqiptare në Projektin e Hartës Globale. Në këtë kapitull është bërë një përmbledhje e përgjithshme e situatës në lidhje me përfshirjen e tokave shqiptare në projektin e Hartës Globale HB, si dhe gjendjen e situatës në lidhje me të dhënat e zhvilluara të GM-së në secilin vend.









Kapitulli 9
Rezultatet dhe përfundimet

Kapitulli 10
Literatura

Kapitulli 11
Shtojcat

Figura 1.1 Paraqitja grafike e strukturës së tezës

Kapitulli 6 mban titullin Zhvillimi i të dhënave hapësinore për Republikën e Shqipërisë në Hartën Globale. Në këtë kapitull është kryer një analizë e detajuar e të dhënave të nevojshme hyrëse për zhvillimin e të dhënave të hartës globale për Shqipërinë. Duke përdorur të dhënat e nevojshme hyrëse, shpjegohet procesi i zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale në formë vektoriale, përkatësisht: Shtresa e Transportit, Shtresa e Kufijve, Shtresa e Hidrografisë dhe Shtresa e Qendrave të Popullsisë në kuadër të projektit të Hartës Globale për Shqipërinë. Këtu është shpjeguar edhe procesi i përgatitjes së Metadatave të të dhënave vektoriale të Hartës Globale të Shqipërisë. Për më tepër, duke përdorur përsëri të dhënat e nevojshme hyrëse, shpjegohet procesi i zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale në formatin rasterial, gjegjësisht: Shtresa e Rasterit të Lartësive, Shtresa e Mbulimit të Tokës, Shtresa e Përdorimit të Tokës dhe Shtresa e Bimësisë në kuadër të projektit të Hartës Globale për Shqipërinë. Këtu është shpjeguar edhe procesi i përgatitjes së Metadatave të të dhënave rasteriale të Hartës Globale për Shqipërinë. Në këtë kapitull janë shpjeguar edhe elementet matematike të Hartës Globale, shkarkimet dhe të drejtat e autorit për përdorimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë, si dhe disa rezultate kryesore të të dhënave të hartës globale për Republikën e Shqipërisë.

Kapitulli 7 mban titullin Seksioni për informacionin gjeohapësinor i Kombeve të Bashkuara. Në këtë kapitull është dhënë një përmbledhje e shkurtër e organizimit të seksionit për informacionin gjeohapësinor në kuadrin e Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, janë shpjeguar standardet e bazës së të dhënave të seksionit të Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara që duhet të përmbushen. Po ashtu, shpjegohet shkurtimisht procesi i kalimit të të dhënave gjeohapësinoe nga Harta Globale në GIS të KB, si dhe është bërë gjithashtu një përmbledhje e përfshirjes së Republikës së Shqipërisë në GIS të Kombeve të Bashkuara.

Kapitulli 8 mban titullin Kontrolli i cilësisë dhe përdorimi i të dhënave gjeohapësinoe të Shqipërisë në Hartën Globale dhe në GIS të KB. Në këtë kapitull është realizuar një analizë e cilësisë, përdorshmërisë dhe qëndrueshmërisë së të dhënave hapësinoe në formatin vektor dhe raster të Shqipërisë në Hartën Globale GM dhe UNGIS. Është realizuar një analizë krahasuese e të dhënave në lidhje me saktësinë, përmbushjen e standardeve, harmonizimin, ndërveprimin dhe përdorimin e të dhënave. Gjithashtu konsiderohet edhe si domosdoshmëri për përditësimin dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave.

Kapitulli 9 mban titullin Rezultatet dhe Përfundimet. Në kapitullin e fundit janë analizuar rezultatet në lidhje me cilësinë dhe përdorshmërinë e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë. Ky kapitull gjithashtu ofron disa udhëzime në lidhje me mënyrën se si duhet të zhvillohen dhe përmirësohen më tej të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë në të ardhmen, brenda kornizës së UNGIS-it. Është analizuar gjithashtu se cilat karakteristika shtesë të të dhënave të HG-së mund të zbatohen dhe, si disa aspekte të kësaj teze mund të përmirësohen në studimet e ardhshme.

Në **Anekset** e tezës është dhënë një fjalor i shkurtër i disa termave specifike të përdorur në analizë me shpjegime të shkurtra. Në aneksin tjetër B janë renditur të dhënat e përdorura të hyrjes dhe të dhënat e fituara të hapësirës së Hartës Globale në formatin vektor dhe raster.

2 ORGANIZIMI INFRASTRUKTUROR I TË DHËNAVE HAPËSINORE (SDI)

2.1 Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore (SDI) – Koncepti dhe përkufizimi

Ne jemi duke jetuar në kohën ku më shumë se 80% e informacioneve kanë karakter gjeohapësinor.

Të dhënat gjeohapësinore të njohura edhe si Informacioni Gjeografik (GI), është informacioni që përshkruan fenomenet që lidhen direkt ose indirekt me një vend në lidhje me sipërfaqen e tokës. Në ditët e sotme, në dispozicion është një sasi e madhe e informacioneve gjeografike, që janë mbledhur (për dekada) për qëllime të ndryshme nga institucione dhe kompani të ndryshme. (Nogueras-Iso et al. 2005).

Sipas (Williamson et al, 2005) të dhënat hapësinore, të njohura edhe si të dhëna gjeohapësinore ose informacione gjeografike, përcaktohen si të dhëna që kanë të bëjnë me një lokacion specifik në tokë, veçanërisht informacion në lidhje me fenomenet natyrore dhe burimet kulturore dhe njerëzore.

Të dhënat hapësinore që kanë të bëjnë me sistemet e informacionit gjeografik përdoren për vizualizim dhe analizë. Të dhënat hapësinore kanë përdorime të gjera sepse çdo aktivitet njerëzor zhvillohet brenda një lokacioni ose një zone të veçantë, dhe për këtë arsye, ndikimet e veprimtarisë janë më kuptimplote dhe më praktike nga këndvështrimi hapësinor. Të dhënat hapësinore janë thelbësore për përmirësimin dhe zhvillimin e situatave ekonomike dhe financiare dhe për mbrojtjen e burimeve natyrore (Urdhri Ekzekutiv, 1994).

Një sistem i informacionit gjeografik është përshkruar në disa mënyra gjatë zhvillimit dhe shfaqjes së tij si një teknologji e veçantë. Dikush mund ta përcaktojë GIS-in si një sistem të pajisjeve dhe softuerëve, procedurave dhe punonjësve, i dizajnuar për të krijuar, për të ruajtur, për të manipuluar, për të analizuar dhe për të shfaqur informacione me referencë gjeografike (Lubishtani et al, 2020).

Informacioni i saktë Gjeografik mund të ndihmojë vendimmarrësin të krijojë një vendim strategjik i cili është shumë i rëndësishëm (Cahyawati 2010). Si shembull mund të paraqiten rastet e tërmeteve, zonave të përmytura, fatkeqësitë natyrore etj., kur nevojitet vendim i shpejtë për evakuim dhe rehabilitim.

Ka shumë çështje në lidhje me prodhimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore (Rajabifard, 2020). Disa prej tyre janë:

- shumë shpesh të dhënat janë me cilësi të dobët dhe dokumentacion përcjellës të dobët, dhe
- shpesh organizatat që prodhojnë të dhëna hapësinore janë të kufizuara për të shpërndarë të dhëna hapësinore me cilësi të lartë.

Sidoqoftë, çdo lloj informacioni, veçanërisht informacioni gjeografik, është një burim i shtrenjtë. Kjo është aryesja pse janë ndërrmarë shumë iniciativa për të përmirësuar qasjen dhe shkëmbimin e të dhënave në dispozicion, promovimin e ripërdorimit të tyre, si dhe minimizimin e dyfishimit të përpjekjeve për mbledhje dhe mirëmbajtje. Këto iniciativa kanë rezultuar në konceptimin e një kornize pune të njohur si SDI.

Koncepti i SDI-së është përdorur në përgjithësi për të shmangur boshllëqet brenda të dhënave hapësinore dhe dublikimin në prodhimin e të dhënave, përveç problemeve të tjera të njohura të të dhënave hapësinore (van Loenen and Kok, 2004). SDI është gjithashtu një mënyrë inovative që synon të hartojë një mjedis për bashkëpunim dhe kooperim.

Në mënyrë të veçantë, një SDI siguron një bashkëpunim dinamik të brendshëm dhe të jashtëm ndërmjet organizatave që iu përgjigjen nevojave të bashkëpunimit të ofruesve të të dhënave dhe përdoruesve fundorë.

Sipas një përkufizimi nga Rajabifard and Williamson (2004), Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore (SDI) është një koncept dinamik, hierarkik dhe multidisiplinor që përfshin dimensionet institucionale, politike, teknike, standarde dhe burimet njerëzore.

Sipas përkufizimit nga (Mulaku 2002a) Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore (SDI) është një ndërthurje e teknologjisë, proceseve institucionale, politikave dhe njerëzve që mundësojnë qasjen, vlerësimin, hyrjen dhe aplikimin e të dhënave gjeohapësinore nga të gjithë përdoruesit nga të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe qytetarët.

Sipas librit të SDI-së, Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore është kryesisht një koleksion i pesë komponentëve që janë të dhëna thelbësore hapësinore, politika, standarde, teknologji dhe procese institucionale që lehtësojnë qasjen në informacione të lidhura gjeografike (GSDI, 2004).

INSPIRE (2003) përcakton SDI-në si bazën përkatëse të teknologjive, politikave dhe proceseve institucionale që lehtësojnë disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat hapësinore i barasvlershëm me Infrastrukturën për Informacionin Hapësinor (Rajabifard, 2020).

Në faqen <https://www.giscourse.com/> ne mund të gjejmë një përkufizim të **SDI-së (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore)** si një sistem rrjeti kompjuterik i përbërë nga një grup burimesh (**katalogje, serverë, programe, të dhëna, aplikime, faqe të internetit, etj**) që menaxhojnë Informacionin Gjeografik siç janë **hartat, ortofotot, imazhet satelitore, toponimet etj**, të cilat janë të disponueshme për t'u shkarkuar në internet. Ky informacion siguron kushte të ndërveprimit (rregullat, specifikimet, protokollet, ndërfaqet etj) që lejojnë përdoruesin t'i shkarkojë dhe përdorë ato, vetëm me një shfletues të internetit.

Në (**DRAFT Publikimin C-17**) SDI është një term i përdorur për të përmbledhur një sërë aktivitete, procesesh, marrëdhëniesh dhe rregullash, të cilat së bashku sigurojnë një menaxhim të integruar të të dhënave hapësinore, informacionit dhe shërbimeve.

Si përmbledhje mund të themi se Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore merret me lehtësimin dhe kordinimin e shkëmbimit dhe shpërndarjes së të dhënave hapësinore ndërmjet palëve të interesuara në komunitetin e të dhënave hapësinore.

Si element kryesor i të gjitha përkufizimeve të mësipërme është një fushë e komponentëve të cilat mbulohen nga një SDI. Të dhënat hapësinore janë një element kryesor i çdo përkufizimi të SDI-së (Rajabifard, 2002). Sidoqoftë, SDI nuk ka të bëjë vetëm me të dhënat hapësinore, por edhe teknologjitë, politikat, standardet, burimet njerëzore dhe aktivitetet e lidhura të nevojshme për të përvetësuar, përpunuar, shpërndarë, përdorur dhe mirëmbajtur të dhënat hapësinore (Greg Scott and Abbas Rajabifard, 2016).

Në kuptim praktik, nëse ndonjë SDI është operacional, të dhënat hapësinore do të jenë të disponueshme në internet përmes një objekti të zbulimit të të dhënave hapësinore, për përdoruesit dhe prodhuesit. Për shembull, çdo pajisje (laptop ose kompjuter desktop) i lidhur me internet mund të hyjë në një kërkesë të klientit të GIS-it në një gjeoportali, i cili mund t'i lejojë përdoruesit të krijojë harta të personalizuar nga të dhëna të ndryshme që rrjedhin nga bazat e të dhënave të shpërndara. Duke lidhur bazat e veçanta të të dhënave hapësinore, SDI krijon një rrjet të integruar, i cili lejon qasje të lehtë, disponueshmëri dhe përdorim të të dhënave; gjë që nuk është e mundur përmes bazave jo të lidhura të të dhënave individuale.

Koncepti i SDI-së ka evoluar nga përpjekjet e mëparshme për shpërndarjen e të dhënave dhe koordinimin e programit në atë që përfshin burimet, sistemet dhe lidhjet e rrjetit, standardet dhe çështjet institucionale. SDI është një burim në rritje i të dhënave në të cilin prodhuesit e të dhënave mund të kontribuojnë, prandaj parashikohet që SDI do të vazhdojë të evoluojë dhe të përmirësohet.

Hapi për të filluar krijimin e infrastrukturës së të dhënave hapësinore është një projekt afatgjatë dhe kërkon shumë përpjekje dhe bashkëpunim ndërmjet të gjitha institucioneve. Qëllimi kryesor i SDI-së dhe informacionit gjeohapësinor është të jetë i arritshëm për organizata, institucione të ndryshme dhe publikun në përgjithësi për zgjidhjen e problemeve dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në botë.

Sipas (Siriba David Niangau 2001) objektivat specifike të SDI-së përfshijnë:

- Përmirësimin e planifikimit dhe vendimmarrjes duke siguruar disponueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore në kohën e duhur dhe me kosto të përballueshme.
- Sigurimi i të dhënave të përshtatshme, të plota dhe të qëndrueshme (MANISA 2007).
- Reduktimin e mbetjeve duke prodhuar të dhënat dhe duke e përdorur atë shumë here.

Qasja në të dhënat hapësinore dhe politikat që rregullojnë atë qasje, është thelbësore në formimin e politikave, programeve dhe projekteve (Lance (Ed), 2004).

Një SDI duhet të jetë më shumë se një grup i vetëm i të dhënave ose një bazë të dhënash; një SDI mban të dhëna gjeografike dhe attribute, dokumentacion të

mjaftueshëm (metadata), një mjet për të zbuluar, vizualizuar dhe vlerësuar të dhënat (katalogët dhe hartat në internet), dhe disa metoda për të siguruar qasje në të dhënat gjeografike. Për ta bërë një SDI funksionale, gjithashtu duhet të përfshijë marrëveshjet e nevojshme organizative për të koordinuar dhe administruar atë në një shkallë lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.

Katër konceptet kryesore mbështesin të gjitha nivelet e SDI-ve (Masser, 2005):

1. Objektivi kryesor i një SDI-e është të maksimizojë përdorimin e informacionit hapësinor (Lubishtani at al, 2020). Kjo kërkon qasje të gatshme në asetet e informacionit gjeografik të mbajtur nga një gamë e gjerë e palëve të interesuara si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.
2. SDI-të nuk mund të realizohen pa veprim të koordinuar nga ana e qeverive dhe partnerëve të agjencisë (Lubishtani at al, 2020).
3. SDI-të duhet të drejtohen nga përdoruesit. Qëllimi i tyre kryesor është të mbështesin vendimmarrjen për qëllime të ndryshme.
4. Këto përfshijnë jo vetëm çështje teknike siç janë të dhënat, teknologjitë, standardet dhe mekanizmat e shpërndarjes, por edhe çështjet institucionale që lidhen me përgjegjësitë organizative dhe politikat e përgjithshme të informacionit kombëtar, si dhe pyetjet që lidhen me disponueshmërinë e burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme për këtë detyrë (Lubishtani at al, 2020).

2.2 Historia e SDI-së

Përderisa të dhënat hartografike janë bërë gjithnjë e më dixhitale, si në aspektin e burimit ashtu edhe të manipulimit të tyre, fuqia e të dhënave hapësinore njihet gjithnjë e më shumë në tërë globin. Ardhja e fundit e burimeve gjeografike në vetëdijen kryesore përmes zhvillimit të Google Earth dhe të dhënave të tjera të vendosura në internet, gjithashtu ka krijuar një vetëdije të shtuar për fuqinë e hartës. Prandaj, një nga detyrat kryesore të ekspertëve të informacionit gjeografik është të menaxhojë dhe formojë këtë potencial dhe vetëdije në rritje, dhe një nga modelet kryesore globale të përdorura për të provuar dhe bërë këtë janë Infrastrukturat e të Dhënave Hapësinore (SDI).

Historia e Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore (SDI) është e gjatë, por SDI u bë e rëndësishme në vitet e 1980-ta për shkak të kërkesës së madhe për bashkëpunim dhe shpërndarje të të dhënave hapësinore. Diskutimet kombëtare të SDI-ve filluan midis akademikëve në SHBA. Tema u konfirmua zyrtarisht me komandën ekzekutive të Presidentit më 1994 (Urdhëri Ekzekutiv, 1994).

Termi infrastrukturë e të dhënave hapësinore u krijua në vitin 1993 nga Këshilli Kombëtar i Kërkimit i ShBA-ve për të treguar një kornizë të teknologjive,

politikave dhe proceseve institucionale që së bashku lehtësojnë krijimin, shkëmbimin dhe përdorimin e të dhënave gjeohapësinore dhe burimeve të informacionit të lidhur me gjithë komunitetin lidhur me shpërndarjen e informacioneve.

Mund të themi që **SDI-të** kanë lindur në vitin 1994, nga Urdhëri Ekzekutiv 12906, i Shteteve të Bashkuara. Që atëherë, të gjitha vendet anglisht-folëse e ndoqën këtë proces të zhvillimit dhe shfaqjes së Informacionit Gjeografik në Internet.

Në lidhje me NSDI-në (Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave Hapësinore) si dhe format e tjera të infrastrukturës së SDI-së ka histori zhvillimi, "me çdo vend në vazhdimësi të ndryshme zhvillimi", (Masser, 2003).

Këto mund të shihen si infrastrukturë informacioni të gjeneratës së parë (Masser, 1998) që jep një përmbledhje të gjendjes së artit. Këto sisteme janë të organizuar kryesisht në mënyrë eksplicite në nivel kombëtar, dhe merren vetëm me informacion hapësinor.

Kjo është për shkak të nevojës për një perspektivë rajonale të SDI-ve si pasojë e nevojës për të dhëna të qëndrueshme hapësinore përtej kufijve kombëtarë për të mbështetur vendimmarrjen në këtë nivel, dhe mungesën e një organi koordinues ndërmjet nismave të vazhdueshme shumëkombëshe dhe nën-rajonale. Krijimi i EUROGI u pasua me shpejtësi në Azi dhe Paqesor me krijimin e një Komiteti të Përhershëm mbi Infrastrukturën e GIS-it për Azinë dhe Paqesorin (PCGIAP) në vitin 1995 nën kujdesin e Konferencës Rajonale Hartografike të Kombeve të Bashkuara (Hjelmager 2008).

Një organizatë e ngjashme për Amerikën pasoi në vitin 2000, Komiteti i Përhershëm për Infrastrukturën e të Dhënave Hapësinore për Amerikën (PC IDEA), pas një procesi trevjeçar, me mbështetjen e 21 kombeve. Në fund të shekullit, Afrika dhe Lindja e Mesme ishin rajonet e vetme të botës pa një organizim të tillë. Sidoqoftë, lëvizjet aktualisht janë duke u zhvilluar brenda Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Afrikën (UN ECA), përmes Komitetit të tij për Informimin e Zhvillimit (CODI), i cili ka një Nën-Komitet për Gjeoinformim (CODI-Geo).

Nga **Direktiva INSPIRE**, e gjithë Evropa duhet të ketë SDI-të kombëtare (<https://www.esri.com/>). Në sferën ndërkombëtare, janë zhvilluar disa SDI si: Komiteti i Përhershëm për SDI-të e Azisë dhe Paqesorit, Komiteti i Përhershëm për SDI-të e

Gjatë Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Janeiro në vitin 1992 u pranua një rezolutë e madhe për të ndryshuar ndikimin e shkaktuar nga përkeqësimi i mjedisit p.sh: shpyllëzimi, ndotja, varfërimi i rezervave të peshkut, monitorimi dhe kontrolli i mbeturinave toksike etj., Gjithashtu Samiti i GATT-së në vitin 1999 në Vjenë theksoi mundësinë e përdorimit të informacionit në internet në të gjithë botën. Mbledhja e të dhënave hapësinore është e kushtueshme, duke detyruar ripërdorimin e të dhënave të njëjta disa herë për qëllime të ndryshme. Dhe kështu, shërbimi i komunitetit përmes një rrjeti i të dhënave hapësinore për të

zbuluar, eksploruar dhe shfrytëzuar të dhënat në dispozicion është zhvilluar, së pari në nivelin kombëtar, por pas Samitit në Rio, gjithashtu edhe në nivel global.

Disa ngjarje kryesore që kanë të bëjnë me zhvillimin e SDI-ve janë :

- FGDC: Krijuar në SHBA me Urdhërin Kombëtar Ekzekutiv (1994)
- Konsorciumi i Hapur Gjeohapësinor i krijuar nga projekti OpenGIS (1994)
- ISO/TC211 e formuar (1994): WMS (2000), WFS (2002), GML Karakteristika të thjeshta (2006) standardet e lëshuara
- Konsolidimi I SDI-ve kombëtare në SHBA, Evropë, Australi. Direktiva e BE-së INSPIRE (2007)
- SDI-të tematike dhe kombëtare që përparojnë në rajone të tjera

Në nivel global, koncepti i SDI-së filloi të formulohet në vitin 1996 me idenë e një kanali standard ndërkombëtar për shpërndarjen ose shkëmbimin e të dhënave hapësinore nga perspektiva globale, rajonale e kombëtare dhe anasjelltas.

Gjithashtu, është në interes të theksohet shkurtimisht zhvillimi i SDI-së (Fig. 2.1) (Julian Smit et all, 2009). Theksi në këtë (gjeneratën e parë të SDI-ve) u vendos në përmirësimin e disponueshmërisë së të dhënave dhe qasjen e të dhënave. “clearinghouse” doli si produkt kryesor i kësaj periudhe.




Figura 2.1 Zhvillimi I Infrsaturës së të Dhënave Hapësinore, përshtatur nga (Julian Smit et all, 2009)

Sipas (Julian Smit et all, 2009) kjo pikëpamje alternative për SDI-të nënkupton që vlera e të dhënave hapësinore zhbllkohet vetëm kur përdoret në aplikimet e vendimmarrjes. Për më tepër, ekzistonte nevoja për të nxjerrë potencialin e plotë të të dhënave duke përdorur ato për të ofruar shërbime gjeohapësinore, duke i bërë "SDI-të" e gjeneratës së dytë më shumë si proces të nxitur (figura 1.1). Një nga komponentët teknikë këtu ka të bëjë me konceptin e Gjeoportalit (Maguire & Longley, 2005).

2.3 Komponentët e SDI-së

Vlera e informacionit dhe efektiviteti i proceseve të vendimmarrjes / planifikimit janë shumë të lidhura me cilësinë dhe tërësinë e informacionit dhe mënyrën, në të cilën ato vihen në dispozicion. Në këtë aspekt, qasja në të dhëna, menaxhimi, integrimi, analiza dhe komunikimi janë përbërësit kryesorë (Publication C-17 Second Edition Version 2.0.0 - January 2017). Brenda të gjithë këtyre përbërësve nevoja për standarde është e rëndësishme (Shoqata Australiane e Pushtetit Lokal, 2004).

Komponentët kryesorë të SDI-së janë: politikat, rrjetet e hyrjes, standardet teknike, njerëzit dhe të dhënat hapësinore (Rajabfard and Williamson, 2001). **Qasja në rrjet** iu referohet lidhjeve të komunikimit që lidh palët dhe të dhënat me njëra tjetrën dhe lejon komunikimin dhe përdorimin e të dhënave/shërbimeve nga njerëzit ose shërbimet tjera. **Politikat e SDI-së** janë përgjithësisht mjete për të monitoruar dhe kontrolluar marrëdhëniet ndërmjet palëve të interesuara dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave/shërbimeve në kontekstin e SDI-së. Për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave hapësinore dhe jo-hapësinore në kontekstin e SDI-së, numri i **protokolleve dhe standardeve** janë zhvilluar dhe përdorur. Zhvillimi i këtyre standardeve është megjithatë një proces dinamik dhe ato mund të ndryshojnë bazuar në nevojat dinamike të njerëzve, kontekstin e vendit dhe strukturën e sistemeve të informacionit.




Figura 2.2 Komponentët e SDI-së: natyra dhe marrëdhëniet (Burimi: Williamson et al., 2003)

Duke parë komponentët kryesorë të SDI-ve, (Rajabifard 2002) sugjeroi që kategori të ndryshme të komponentëve mund të formohen duke u bazuar në natyrën e ndryshme të bashkëveprimeve të tyre brenda kornizës SDI. Natyra e të dy kategorive është shumë dinamike për shkak të ndryshimeve që ndodhin në komunitete (njerëz) dhe nevojave të tyre, si dhe kërkesës së tyre të vazhdueshme për grupe të ndryshme të të dhënave. Sipas kësaj pikëpamje, kushdo (përdoruesit e të dhënave përmes prodhuesve) që dëshiron të përdorë grupet e të dhënave, duhet të përdorë përbërësit teknologjikë. Ndikimi i nivelit të SDI-së dhe përqendrimi për përbërësit teknikë kanë

një ndikim të rëndësishëm në qasjen e marrë për përafrimin e komponentëve drejt zhvillimit të SDI-ve (Abbas Rajabifard, 2002).

Rrjedhur nga një hulumtim i kryer në vjeshtë 1999, sipas (**Crompvoets, 2000**) komponentët e më poshtëm të SDI-ve duhet të konsiderohen si shtylla kryesore të Infrastrukturave të të Dhënave Hapësinore:

- **Burimet e të Dhënave** (organizata të cilat gjenerojnë të dhëna hapësinore);
- **Përdoruesit** e të dhënave hapësinore (burimet njerëzore);
- **Rregulla të përcaktuara**, standarde (përkufizimi teknologjik dhe i të dhënave), protokollet, procedurat, instruksionet, udhëzimet;
- **Politika** (legjislacioni (e drejta e autorit), qasja, financat) ;
- **Korniza institucionale** (aranzhimet) që prekin bazat e të dhënave, politikat e metadave, standardet;
- (Rrjeti) grupet e të dhënave hapësinore (të dhëna themelore ((gjeodezike) sistemi i pozicionimit, kornizat digjitale topografike, regjistri i pasurive, kufijtë administrativë, modeli i lartësisë), të dhënat tematike (tokat, hidrologjia) , përdorimi i tokës), të dhënat historike dhe metadata);
- **“Clearinghouse”**;
- **Dispozitat ligjore dhe teknike** për lidhje univerzale ndërmjet bazave të të dhënave, informacionit drejtues dhe të drejtat ligjore për ndërlidhje;
- Meta-baza e të dhënave dhe drejtimet që përshkruajnë përmbajtjen dhe komponentët e bazës së të dhënave;
- **Teknologjitë** që lehtësojnë përdorimin dhe transferimin e të dhënave hapësinore (Rrjetet, Shkëmbimi Elektronik i të Dhënave, GIS i hapur, lehtësirat për trajtimin e të dhënave, transferimi i të dhënave);

Një pamje e ngjashme e komponentëve të SDI-ve mund të shihet në letrën e (Douglas, 2001), ku SDI përfshin komponentët e mëposhtëm:

1. Të Dhënat dhe Metadata
2. Teknologjitë
3. Kornizat Institucionale
4. Politikat
5. Njerëzit

Ne gjithashtu mund të nxjerrim komponentët thelbësorë të SDI-ve duke iu referuar nismave të hershme rajonale dhe kombëtare të SDI-ve siç janë Organizata Evropiane Ombrellë për Informacione Gjeografike (EUROGI), SDI-ja e Australisë dhe Zelandës së Re (ANZLIC, 2006), SDI-ja e Azisë dhe Paqësorit (PCGIAP, 2003), NSDI i Shteteve të Bashkuara (FGDC, 2006). Komponentët thelbësorë janë të dhënat hapësinore, njerëzit, politika, standardet, dhe aspektet teknike, siç përmblihen më poshtë.

1. Të Dhënat Hapësinore

Përkufizimi më i thjeshtë i "të dhënave hapësinore" është të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me vendndodhjen që mund të referohen në sipërfaqen e tokës (Bossler, 2002). Të dhënat hapësinore mund të referohen me anë të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike; rrjetit koordinativ kombëtar, kodit postar, fushatat elektorale ose administrative (Groot and McLaughlin, 2000). Ato mund të ndahen në 3 nën kategori, gjegjësisht:

(i) Grupet e të dhënave themelore:

Modelet e SDI-ve identifikojnë disa grupe të të dhënave që konsiderohen si themelore (Warnest, 2005). Të dhënat themelore gjeohapësinore janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të SDI-ve. Shprehje të tjera që përdoren në mënyrë të ndërsjellë për të përshkruar këto grupe të të dhënave, përfshijnë të dhënat e referencës, bërthamës, bazës, fondacionit ose kornizës (UNECA, 2004). Ato përdoren si bazë që i mundëson një personi të përfaqësojë hapësisht fenomene, objekte ose tema të rëndësishme për realizime të ndryshme dhe përdorues të shumtë, në nivel lokal, kombëtar, nën-rajonal ose rajonal.

(II) Saktësitë e grupeve të të dhënave themelore:

Paraqet sferat e saktësisë për katër nivele gjeografike kur përdorni hartat bazë të një shkalle të veçantë.

(III) Format i të dhënave hapësinore:

Nga këndvështrimi i SDI-së, të dhënat hapësinore mund të ekzistojnë në formate të ndryshme. Disa janë në formën e tyre të përfaqësimit të kompjuterit ose format i GIS-it të klasifikuar nga De By et al. (2004) si:

- **Të dhënat Vektoriale** ku tiparet gjeografike janë ruajtur si figura gjeometrike duke përdorur pikat, vijat, dhe poligonet ose rrjetet trekëndëshe të çrregullta.
- **Të dhënat Rasterike** me hapësirë gjeografike të ndarë në celula të rregullta ose të parregullta, të cilat së bashku përbëjnë hapësirën e plotë të studimit. Kjo kategori përfshin fotografinë dixhitale: të dhënat gjeografike kapen si imazhe fotografish dhe ruhen në qeliza, sikur që mund të jetë ortofotoja dixhitale.
- **Imazhet:** të dhënat hapësinore kapen nga sensorë me shumë breza dhe ruhen si qeliza, sikur që mund të jetë imazhi SPOT.
- **Rrjetet** janë të dhëna lartësie të mbledhura në një model katror ose drejtkëndor.
- Rrjete të çrregullta të trekëndësheve ose të dhëna të lartësisë të mbledhura në modele të parregullta, zakonisht në vendet ku ndodhin ndryshime të rëndësishme në vendndodhje.

Grupet e të dhënave mund të organizohen dhe mbahen në tabela dixhitale, të cilat nuk janë të nevojshme për formatin GIS, siç janë fletët e punës në Excel.

Metadata : Sipas (Onah 2009) **Metadata** zakonisht përcaktohet nga shumë si "të dhëna në lidhje me të dhënat". Metadata është një dokument i pëmbledhur në lidhje me të dhënat, përfshirë zonë gjeografike që përfshin të dhënat, i cili duhet të kontaktojë për të marrë një kopje të të dhënave dhe informacione të tjera të dobishme

që i ndihmon njerëzit të vendosin nëse të dhënat janë të dobishme apo jo për qëllimin e tyre të veçantë (Onah, 2009).

Njerëzit

Njerëzit përfshijnë përdoruesit, ofruesit, administratorët dhe kujdestarët e të dhënave hapësinore dhe gjithashtu riblerësit e vlerës së shtuar (Warnest 2005). Përdoruesit mund të jenë korporatë, biznese të vogla ose të mëdha ose individë publikë ose privatë.

2. Politikat dhe korniza institucionale

Meqenëse i gjithë qëllimi i SDI-së është të lehtësojë qasjen më të mirë dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet prodhuesve të ndryshëm dhe përdoruesve të të dhënave hapësinore, është e nevojshme një infrastrukturë e mirëorganizuar për bashkërendim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara. Korniza është të mbulojë çështje të tilla si marrëveshjet institucionale (leadershipin, kujdestarinë, financimin dhe ndërtimin e kapaciteteve), politikat e ndryshme dhe legjislacionin e një SDI-e.

3. Standardet

Standardizimi i të dhënave gjeografike është në përgjigje të nevojës së zhvillimit, përdorimit dhe shpërndarjes më të gjerë të të dhënave hapësinore (FGDC, 2006). Zhvillimi i standardeve është detyrë e organeve kombëtare të standardeve, si dhe organizatave ndërkombëtare të standardeve, në të cilat vendet e tjera mund të aderojnë si anëtare.

5. Teknologjia

Teknologjia përbëhet nga rrjetet e hyrjes dhe shpërndarjes, “*clearinghouse*” dhe mjetet e tjera për marrjen e të dhënave hapësinore ose grupet e të dhënave të përdoruesit.

Projekti i Hartografisë Globale është një përpjekje në të cilën Organizatat Kombëtare Hartografike (NMOs) nga më shumë se 180 vende dhe rajone të botës zhvillojnë Hartën Globale (GM) përmes bashkëpunimit ndërkombëtar (Maruyama et al, 2005). Hartat globale janë të dhëna gjeografike dixhitale të të gjithë globit e cila përbëhet nga tetë shtresa tematike: kufijtë, hidrografia, qendrat e banimit, rrjeti i transportit, lartësitë, përdorimi i tokës, mbulesa e tokës dhe vegjetacioni, dhe që duhet të përditësohet çdo pesë vjet.

Bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve në nivele të ndryshme është thelbësor për të marrë vendimarrje për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të shoqërisë dhe mjedisit. Kjo do të përdoret për zbatimin e konventave dhe marrëveshjeve globale / ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit, për të mbikëqyrur fenomene kryesore të mjedisit dhe për të inkurajuar rritjen ekonomike brenda një konteksti të qëndrueshëm.

Qëllimi kryesor i bashkëpunimit ndërkombëtar nga organizatat kombëtare hartografike nga vendet pjesëmarrëse është:

- **Të zhvillojë të dhëna të standardizuara të hartave globale**
- **Të shpërndajë të dhëna me kosto të ulëta të publiku**
- **Të ndihmojë kuptimin e ndryshimeve globale mjedisore dhe sfidat për të ardhmen**

Koncepti i Hartave Globale dhe themelimi i një organi ndërkombëtar për Hartografimin Global ishin propozuar për herë të parë nga Ministria e Ndërtimit të Japonisë në vitin 1992. Projekti i Hartës Globale është rritur në mënyrë të konsiderueshme për të përfshirë pjesëmarrjen e shumë vendeve të interesuara.

Objektivi kryesor i këtij projekti global është që të bashkojë të gjitha kombet dhe organizatat përkatëse së bashku për të zhvilluar dhe siguruar një qasje të lehtë dhe të hapur për informacionin gjeografik në të gjithë botën në shkallën 1: 1.000.000. Përdorimi i këtyre të dhënave do të lehtësojë zbatimin e marrëveshjeve dhe konventave globale për mbrojtjen e mjedisit; do të mbështesë monitorimin e fenomeneve kryesore mjedisore; dhe do të inkurajojë rritjen ekonomike brenda kontekstit të zhvillimit të qëndrueshëm (<http://www.iscgm.org/>).

Qëllimi kryesor i Hartës Globale është të përshkruajë statusin e mjedisit global për të ndihmuar në proceset e vendimmarrjes. Harta Globale siguron hartat dixhitale të sipërfaqes tokësore të tokës me një rezolucion hapësinor prej 1km me specifikime të qëndrueshme dhe të krahasueshme për çdo vend.

Verzioni 1 i Hartës Globale, e cila përfshin të dhënat e mbulesës së Tokës dhe vegjetacionit global (Mbulesa e përqindjes së bimësisë) u publikua në vitin 2008. Të dhënat e mbulesës së tokës dhe bimësisë globale janë zhvilluar me bashkëpunimin e Autoritetit të Informacionit Gjeohapësinor të Japonisë, Universitetit Chiba dhe bashkëpunimit të NMO-ve, që ofrojnë të dhëna të vërteta themelore dhe të dhëna të verifikuara. Të dhënat e Hartës Globale të zhvilluara në specifikime të qëndrueshme na lejojnë të krahasojmë statusin e mjedisit globalisht dhe kronologjikisht. Që nga publikimi i të dhënave globale të mbulesës së tokës dhe vegjetacionit, rastet e aplikimit të të dhënave të GM-së janë në rritje. Ky punim prezanton rastet kryesore të aplikimit të GM-së, veçanërisht të dhënat mbi mbulesën e Tokës dhe bimësinë globale në fazën e tanishme.

Në punimin e (Maruyama et All, 2005) është theksuar gjithashtu, që Harta Globale është menduar të përditësohet rregullisht çdo 5 vjet dhe duhet të vendoset një sistem i qëndrueshëm për ta përditësuar atë. Konsiderohen dy metoda. Metoda e mëparshme zbatohet në shtresat vektoriale, përkatësisht për shtresat e kufijve, komunikacionit, hidrografisë dhe qendrave të banimit. Imazhet satelitore janë të domosdoshme për përditësimin e mbulesës së tokës dhe dy shtresave të tjera të ndërlidhura me të. Përditësimi i këtyre shtresave është shumë i rëndësishëm sepse ato pasqyrojnë ndryshimin e mjedisit jetësor.

Disa nga qëllimet kryesore të projektit të Hartës Globale janë:

- Sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm për katastrofat natyrore;
- Monitorimi dhe administrimi i burimeve natyrore;
- Vlerësimi i tendencave të ndryshimeve në mjedis;
- Planifikimi i zhvillimit fizik lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Vendimmarrja e informuar e politikëbërësve me një bazë të dhënash strategjike.

Duke krahasuar të dhënat e Hartës Globale në vite të ndryshme, ndryshimet mjedisore të sipërfaqes së tokës si shpyllëzimi dhe shkretërimi mund të monitorohen në saktësi të mirë për të gjithë zonën tokësore të globit. Duke u kombinuar me të dhëna të tjera siç janë statistikat dhe indekset e mjedisit, Harta Globale mund të përdoret për parashikimin e ndryshimeve mjedisore globale. Ekzistojnë shembuj aktualë të hulumtimit në këtë fushë, siç janë kontrolli i burimeve natyrore dhe kontrolli i burimeve ujore. Gjatë zhvillimit të projektit të Hartografisë Globale ka edhe disa çështje që duhet të merren parasysh. Specifikimet e tanishme përcaktojnë VPF (formatin e produktit vektor) si formatin e shtresave vektoriale të Hartës Globale. Ky format është shumë kompleks dhe pak i vjetëruar në epokën e internetit nga ana tjetër.

Duhet të prezantohet një format i ri që harmonizohet me shërbimin e hartës në internet. Mund të themi se ky projekt ka pasur sukses vetëm nëse Harta Globale përdoret në mënyrë efektive nga shumë njerëz për aplikime të ndryshme, veçanërisht për zhvillimin e qëndrueshëm. Integrimi me të dhëna të tjera globale duhet të merret gjithashtu në konsideratë sepse Harta Globale ka vetëm tetë shtresa që përfshijnë përmbajtje të kufizuar.

Pas vitit 2007, Harta Globale duhet të mirëmbahet rregullisht.

Përkundër që hartat janë të përgatitura në standardet lokale / kombëtare, të dhënat e Hartës Globale do të mundësojnë:

- të gjitha të dhënat e Tokës të jenë në një vend (Idrizi , 2006),
- me të njëjtën strukturë (Idrizi , 2006),
- në të njëjtin format (Idrizi , 2006),
- në të njëjtin sistem koordinativ (Idrizi , 2006),
- në të njëjtën shkallë (Idrizi , 2006), dhe
- me saktësi të ngjashme (Idrizi , 2006).

Vendet kanë tre mundësi se si të marrin pjesë, të quajtura si nivele A, B dhe C (Beth E. Lachman at al, 2002). Vendet e nivelit A mund të japin të dhënat për vendin e tyre dhe të ofrojnë ekspertizë për vendet tjera, të tilla si ndihma për të dixhitalizuar hartat konvencionale dhe konvertimin e të dhënave. Vendet e nivelit B mund të japin të dhënat e vendit të tyre, por nuk mund t'i ndihmojnë të tjerët (Beth E. Lachman at al, 2002). Vendet që nuk kanë burime dhe / ose aftësi teknike për të gjeneruar të dhëna të Hartës Globale janë vendet e nivelit C dhe ato mund të marrin ndihmë nga vendet e nivelit A.

4.2.1.1 Organizimi konceptual i të dhënave në Hartën Globale

Karakteristikat hapësinore të të dhënave të hartës globale janë të organizuara në shresa tematike në formatet vektoriale dhe rasteriale me secilën shtresë që përmban informacion gjeografik të lidhur logjikisht (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Harta Globale përmban katër lloje të të dhënave:

- Harta Globale V.0 (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010);
- Harta Globale V.X (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010);
- Harta Globale V1/V2 (versioni kombëtar dhe rajonal) (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010) dhe
- Harta Globale V1 (versioni global) (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Dy të dhënat e para, V.0 and V.X nuk janë aq të dhëna të njohura dhe të kohës.

GM V.0 është e bazuar në të dhënat globale të nivelit 0 të hartës V, Karakterizimet globale të mbulimit të tokës (GLCC), dhe grupit i të dhënave për lartësi GTOPO 30 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Të gjitha grupet e të dhënave të shënuara janë të dhëna globale gjeografike ekzistuese, pa ndonjë vërtetim të asnjë NMO-je (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

GM V.X është e bazuar në të dhënat ekzistuese të të dhënave globale gjeografike, si e mëparshmeja (GM V0), që u zhvillua në mënyrë provuese që i parapriu versionit GM V1 / V2.

Versioni kombëtar dhe rajonal i GM V1/V2 është më i popullarizuar dhe më i përdorur te të dhënat e hartave globale, të prodhuara nga organizatat kombëtare hartografike të vendeve përkatëse nën përgjegjësinë e tyre, pa asnjë përgjegjësi të marrë përsipër të ISCGM-së për përmbajtjen e këtyre të dhënave (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Version global i GM V1 ishte zhvilluar si të dhëna shtesë për rasterin që synojnë të zëvendësojnë shtresat ekzistuese të rasterit (mbulesën e tokës, përdorimin e tokës dhe vegjetacionin) në GM V2 të ardhshme (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Harta globale V1/V2 versioni kombëtar dhe rajonal, është versioni më i përdorur dhe më i njohur i hartës globale, në të cilin të gjitha NMO-të pjesëmarrëse japin përpjekjet e tyre për zhvillimin e tij (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Kjo bazë e të dhënave globale përfshin të dy llojet e të dhënave, të dhënat vektoriale dhe ato rasteriale, të siguruara nga NMO-të bazuar në nivelin e tyre të pjesëmarrjes (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Tabela 4.1 Shtresat e grupit të të dhënave të Hartës Globale V1/V2 – version kombëtar/rajonale (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010)

<i>Shtresat Vektoriale</i>	<i>Shtresat Raster</i>
Rrjeti i komunikacionit	Lartësitë
Kufijtë	Mbulesa e Tokës
Hidrografia	Përdorimi i Tokës
Qendrat e banimit	Vegjetacioni (bimësia)

Paraqitja e diagramit grafik të vektorit të Hartes Globale dhe databazës së rasterit të versionit kombëtar dhe rajonal të Hartës Globale V1 / V2 është paraqitur më poshtë në figurën 4.1.




Figura 4.1 Grupi i të dhënave të Hartës Globale V1/V2 – version kombëtar/rajonale

Të dhënat vektoriale të Hartës Globale të ruajtura si linja dhe sipërfaqe janë të strukturuar individualisht, që do të thotë se të dhënat e vektorit të Hartës Globale janë strukturuar mënyrë të pjesshme topologjike. Intensiteti i të dhënave të vektorit të hartës globale është të ruajë konsistencën logjike të të dhënave, dhe veçoritë jo kopjuese (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Struktura e të dhënave vektoriale të hartës globale është përshtatur me standardet ISO / TC 211 (International Conference on Spatial Data Infrastructures ,2010).

Specifikimet e mëposhtme gjatë zhvillimit të projektit të Hartës Globale janë lëshuar:

- Versioni 1.1, më 16.03.2000 (Idrizi et al, 2011),
- Versioni 1.2 më 17.04.2005 (Idrizi et al, 2011),
- Versioni 1.2.1 më 11.11.2006 (Idrizi et al, 2011),
- Versioni 1.3 më 14.07.2007 (Idrizi et al, 2011),
- Versioni 2 më 25.10.2009 (Idrizi et al, 2011),
- Versioni 2.1 më 18.06.2011 (Idrizi et al, 2011) dhe
- Versioni 2.2 më 12.08.2012 (Idrizi et al, 2011).

Qelizat e rrjetit të të dhënave rasteriale organizohen dhe arrihen nga rreshtat dhe kolona me madhësinë e celulave (rezolucion hapësinor) 30"x30", me origjinë në skajin veriperëndimor të trapezitet të ndarjes së nomenklaturës(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Zona e saj e përfaqësuar nga një qelizë e rrjetit katror llogaritet nga gjatësia e anës së saj e quajtur rezolucion hapësinor. Atributi i secilës qelizë paraqet një karakteristikë që është mbizotëruese pranë pikës qendrore të qelizës. Karakteristikat e shtresave rasteriale të të dhënave të Hartës Globale shpjegohen në më shumë detaje në vazhdim.

Shtresa e lartësive – përmban disnivelelin midis sipërfaqes së tokës dhe nivelit mesatar të detit që shteti ka përcaktuar.

Shtresa e mbulesës së Tokës – Mbulesa e tokës është mbulesa fizike e vëzhguar (bio) në sipërfaqen e tokës(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Në specifikimin e Hartës Globale kodet e karakteristikave të mbulesës së Tokës së Hartës Globale V1/V2 versioni kombëtar/rajonal janë miratuar për Programin Ndërkombëtar të Gjeosferës-Biosferë (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Shtresa e përdorimit të Tokës – Përdorimi i tokës është një seri veprimesh në tokë, të kryera nga njerëzit, me qëllim të marrjes së produkteve dhe / ose përfitimeve përmes përdorimit të burimeve të tokës (de Bie 2000). Për legjendën e përdorimit të Tokës, miratohet GLLC i thjeshtuar me 9 klasa(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Ekziston një propozim për të hequr këtë shtresë nga versioni tjetër 2 kombëtar/rajonal i Hartës Globale, pasi që kjo rrjedh pothuajse nga të dhënat e mbulesës së Tokës (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Shtresa e vegjetacionit - Për shtresën e vegjetacionit, është miratuar një legjendë e modifikuar e bimësisë me 20 klasa. Ndryshimi i kësaj shtrese, bazuar në përqindjen e mbulesës së pemëve për versionin global të hartës globale V1, është propozuar gjithashtu(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të dhënat rasteriale të Hartës Globale janë në format të thjeshtë binar të rasterit – formati BIL, ku informacioni në qeliza ruan grupet nga grupi për secilën linjë, ose rresht, të imazhit(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Vegjetacioni, mbulesa e Tokës dhe përdorimi i Tokës janë të dhëna në 8 bit, ndërkaq të dhënat e lartësisë në 16 bit.

Harta Globale V1 – versioni global është zhvilluar duke përdorur imazhe satelitore në bashkëpunim ndërmjet NMO-ve pjesëmarrëse dhe palëve të interesuara mbështetëse, që mbulon vetëm shtresat e bimësisë dhe mbulesës së

tokës(International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010). Të dhënat e së vërtetës tokësore janë mbledhur nga Qendra për Ndjesinë në Distançë Mjedisore (CEReS), Universiteti Chiba në bashkëpunim me Organizatat Kombëtare Hartografike(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Madhësia e celulave për të dhënat e rasterit është e njëjtë me versionin kombëtar / rajonal, 30” me origjinë në skajin ver-perëndim të trapezit(International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Të dhënat MODIS të 2003 me trapez 1km^2 (10 shkallë nga 10 shkallë) nga Autoriteti Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (USGS) janë përdorur si të dhëna burimore satelitore për zhvillimin e mbulesës së Tokës - versioni global.

Të dhënat e versionit global të mbulesës së tokës përmbajnë 20 klasa të mbulesës së tokës, dhe një klasë tjetër shtesë me kod 255 që përfaqësojnë zonat pa të dhëna (tabela 6.5). Në tabelën 6.5 është paraqitur krahasimi midis klasave të mbulesës së tokës në versionin kombëtar / rajonal me 17 klasa dhe global me 20 klasa (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Njëra nga arsyet e krijimit të versionit global të mbulesës së tokës me 20 klasa është qëllimi për të hedhur shtresën e përdorimit të Tokës nga versioni tjetër 2 kombëtar / rajonal i Hartës Globale, pasi ajo mund të gjenerohet nga të dhënat e mbulesës së Tokës(International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Shtresa e bimësisë (përqindja e mbulesës së pemëve) e versionit global është zhvilluar duke përdorur të dhënat e MODIS-it të vitit 2003, të cilat janë përdorur për vlerësimin global të të dhënave të përqindjes së mbulesës së pemëve(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Metoda e pemës së vendimit u aplikua për vlerësimin e përqindjes së mbulesës së pemëve.Të dhënat brenda kësaj shtrese përmbajnë një vlerë të plotë nga 0 deri në 100, e cila përshkruan përqindjen e mbulimit me pemë, përveç qelizave me vlerë 254, të cilat paraqesin zonat ujore, dhe qelizat me vlerë 255, të cilat përfaqësojnë zonat pa të dhëna(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

4.2.1.2 Elementet matematike e të dhënave në Hartën Globale

Produkti i Hartës Globale përfshin tërë globin, në një shkallë të 1:1 000 000. Të gjitha grupet e të dhënave janë në përputhje me këtë shkallë dhe këto specifikime (Specifikimet Globale të Hartave Versioni 2.2., 2012):

Sistemi koordinativ referent: Sistemi kordinativ ITRF94 përdoret si sistemi koordinativ i referencës. Elipsoidi GRS80 përdoret për të përfaqësuar pozicionin e objekteve hapësinore në gjatësi dhe gjerësi gjeografike. Meqenëse diferenca midis këtyre koordinatave dhe koordinatave WGS84 është e papërfillshme në shkallën e këtij produkti, të dhënat në WGS84 do të merren të jenë në ITRF94 (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Preciziteti: Një palë e vlerave të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike përshkruan pozicionin e objekteve hapësinore. Të dhënat do të ruhen në shkallë dhjetore tre vlera pas presjes dhjetore, si koordinata gjeografike me hemisferat jugore dhe perëndimore që kanë një shenjë negative për gjerësinë dhe gjatësinë (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010)

Saktësia: Skatësia e pozicionit të të dhënave hapësinore është shkalla në të cilën koordinatat planimetricke dhe lartësitë e karakteristikave korrespondojnë me vlerat e tyre reale në botë.

Seria e Hartave Globale: Ekzistojnë dy seri të hartave globale. Njëra është versioni kombëtar dhe rajonal që secili NMO pjesëmarrës është në thelb përgjegjës për zhvillimin e hartës së vet globale. Tjetri është verzioni botëror I, i cili është zhvilluar duke përdorur imazhe satelitore në bashkëpunim ndërmjet NMO-ve pjesëmarrëse dhe palëve të interesuara mbështetëse (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Verzioni botëror mbulon vetëm shtresën e bimësisë dhe shtresën e mbulesës së tokës.

Topologjia: Të dhënat vektoriale në Hartën Globale janë pjesërisht të strukturuar topologjiksht (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Veçoritë e ruajtura si skaje dhe pamje strukturohen individualisht. Topologjia mbahet përtej kufijve të trapezëve. Fenomenet e botës reale që përshkojnë skajin e trapezave duhet të kenë saktësisht të njëjtat koordinata në nyjet e skajeve të trapezave në çdo trapez. Kjo do të mundësojë që baza e të dhënave të funksionojë si një njësi e lehtë për qëllime të analizës.

Cilësia e të dhënave: Konzistenca logjike duhet të arrihet. Veçoritë nuk mund të kopjohen ose hiqen kur plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

Harta Globale kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e një infrastrukture globale të të dhënave hapësinore (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010). Marrëdhëniet zyrtare ekzistojnë midis ISCGM dhe GSDI, GEOSS, dhe nismave Gjeologjike. Specifikimet e Hartës Globale janë shkruar për të qenë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të standardizimit, konkretisht rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) TC 211 për të dhënat gjeografike.

Të dhënat e Hartës Globale janë në përdorim të sistemit të emërimit të nomenklaturës GEOREF, i cili nuk lejon mbivendosje ose zbrazëtira midis trapezave, me referencë për këndin e tyre jugperëndimore (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010). Përdor dy palë shkronja. Pala e parë e shkronjave paraqet ndarjen më të lartë standarde me 15° me 15° të GEOREF dhe përfaqëson palën e parë koordinuese që identifikon emrin e trapezit (Idrizi et al, 2011). Pala e dytë e shkronjave paraqet ndarjet standarde 1° me 1° të GEOREF, dhe paraqet palën e dytë koordinative të emrit të trapezave (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

4.2.1.3 Standardizimi i të dhënave në Hartën Globale

Standardet e përcaktuara të dy versioneve (V1 dhe V2) ndryshojnë dukshëm në strukturën e të dhënave dhe në format.

E gjithë struktura e të dhënave në bazën e të dhënave të Hartës Globale bazohet në standardet ndërkombëtare ISO për të dhënat gjeografike ISO / TC 211 (Lubishtani et al, 2020). Për zhvillimin e Hartës Globale janë përdorur gjashtë standardet kryesore vijuese ISO:

- ISO19136 për të dhënat në formatin GML (Idrizi et al, 2011),
- ISO 3166 për kodet e kombit (Idrizi et al, 2011),
- ISO 19115 e metadatave të GM-V2 duke përdorur ISO 19139 për kodim (Idrizi et al, 2011),
- Standardi ISO 15046 i metadatave të V1 (Idrizi et al, 2011),
- ISO639 për kodin gjuhësor (Idrizi et al, 2011) dhe
- ISO8601 për kodin e datës (Idrizi et al, 2011).

Skema e standardeve për zhvillimin e të dhënave të përcaktuara në projektin e Hartografisë Globale është paraqitur në vijim (figura 4.2):




Figura 4.2 Skema e standardeve në projektin Global Hartografik (Rajabifard, 2020)

4.2.1.4 Metadata e Hartës Globale

Metadata është të dhëna në lidhje me përmbajtjen, cilësinë, gjendjen dhe karakteristikat e tjera të të dhënave, e cila gjithashtu përshkruan prejardhjen, procesin dhe saktësinë e grupit të të dhënave (Idrizi et al, 2010).

Një dosje të metadata-ve e të dhënave të Hartës Globale shoqëron secilën shtresë të të dhënave të vendosura veçmas, si dosje XML me utf8, të emërtuar sipas temës përkatëse dhe kanë formatin “*.met” në formën: `www_xxx.zzz` ku(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010):

- `www` – identifikon shkurtesat (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- `xxx` – identifikon vendin bazuar në Kodin e Kombit ISO 3166 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010) dhe
- `zzz` – është formati (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Këto të dhëna në parim janë vetëm për përdorim jo komercial! Nëse dikush synon të përdorë të dhënat e Hartës Globale për qëllime komerciale, është e nevojshme të marrë leje nga institucioni përgjegjës i vendit të tij, sipas politikave të të dhënave të përcaktuara nga secila NMO. Çdo përdorim i paautorizuar i këtyre të dhënave për çfarëdo qëllimi të biznesit është në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e autorit dhe rreptësisht është i ndaluar.

4.2.1.5 Disa kufizime dhe çështje të Hartës Globale

Përpjekjet tona për shfrytëzimin e të dhënave të Hartës Globale nga vende të ndryshme për hartografimin dhe analizat hapësinore rezultuan se në të dhënat e secilit vend brenda vetvetes ndjekin të gjitha standardet e vendosura në projektin e Hartografisë Globale, por në një rast të përgatitjes së një harte të dy vendeve fqinje, duke përdorur të dhënat e hartës globale, gjithashtu në një rast të analizës hapësinore të një rajoni më të gjerë gjeografik, që përbëhet nga dy ose më shumë vende, shfrytëzimi i të dhënave të Hartës Globale është mjaft i kufizuar (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010). Shembulli që vërteton dy mangësitë e mësipërme janë shpjeguar përgjatë vijës kufitare midis Bullgarisë dhe Rumanisë (Idrizi et al, 2010). Përveç mbivendosjeve dhe zbrazëtirave, midis dy bazave të të dhënave nuk ka vazhdimësi hapësinore të objekteve të rrjetit rrugor, hekurudhor, lumenjve, liqeneve, vijës bregdetare etj (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Mungesa e gjendjes së vazhdimësisë hapësinore dhe shfaqja e mbivendosjeve dhe zbrazëtirave pamundëson përdorimin e kësaj baze të të dhënave për analizën hapësinore të hidrografisë, rrjetit të komunikacionit, vijës bregdetare, kufirit shtetëror, etj. Situata e tillë është rezultat i disa faktorëve si(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010):

- Shfrytëzimi i të dhënave burimore me shkallë, saktësi dhe tërësi të ndryshme (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010);
- Shfrytëzimi i të dhënave burimore me periudha të ndryshme të grumbullimit dhe të dhënave jo të përditësuara (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- Shfrytëzimi i të dhënave tendencioze (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- Saktësia e transformimit të sistemit të koordinatave (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- Përgjithësimi i të dhënave (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- Mungesa e marrëveshjeve bilaterale midis shteteve fqinje për vijën kufitare ,
- Konfliktet të ndryshme midis vendeve fqinje për vijën kufitare,
- Mosnjohja e shteteve ndërmjet tyre etj.

Për shkak të rregullit të Hartës Globale të përcaktuar në specifikimin e Hartës Globale që të dhënat janë të strukturuar në mënyrë të pjesshme topologjike, marrëdhënia midis të dhënave të hartës globale që përmbajnë shtresa vektoriale janë shumë të dobëta, madje edhe të dhënat, të cilat duhet të analizohen për shkak të marrëdhënies natyrore midis tyre, për shembull (Idrizi et al, 2011):

- Lidhja midis vijës kufitare dhe rrugës, në një rast kur rruga paraqet kufirin midis dy rajoneve administrative;
- Lidhja midis lumit dhe vijës kufitare, në një rast kur lumi përfaqëson kufirin midis dy rajoneve administrative ose vendeve;
- Lidhja midis rrugës dhe liqenit-detit-oqeanit;
- Lidhja midis qendrave të banimit dhe rrugëve;
- Lidhja midis rrugëve dhe lumenjve etj.

4.2.1.6 Përdorimi dhe aplikimi i mundshëm i të dhënave të Hartës Globale

Çështjet e mjedisit janë të ndërlidhura ngushtë njëra duke çuar në tjetrën. Kjo nënkupton se një pikëpamje globale është thelbësore për të kuptuar problemet mjedisore që prekin mjedisin tonë dhe për të siguruar një zgjidhje gjithëpërfshirëse.

Si pasojë, shumica e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit ishin përqendruar në zonat e vogla dhe rezultatet e nxjerra shpesh përgjithësohen për zonat më të mëdha.

Harta Globale me cilësinë dhe standardet e të dhënave të qëndrueshme është një mjet i dobishëm për të monitoruar gjendjen e mjedisit në shkallë rajonale dhe globale. Të dhënat e Hartës Globale mund të ketë përdorime të kufizuara në shkallë kombëtare dhe lokale.

Më poshtë janë disa nga aplikacionet e mundshme të të dhënave të Hartës Globale :

- Sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm për katastrofat natyrore (Idrizi et al, 2011);
- Monitorimi dhe administrimi i burimeve natyrore (Idrizi et al, 2011);
- Vlerësimi i tendencave të ndryshimeve globale të mjedisit (Idrizi et al, 2011);
- Planifikimi i zhvillimit fizik lokal, kombëtar dhe shumëkombësh (Idrizi et al, 2011);
- Vendimmarrja e informuar e politikëbërësve me një bazë të dhënash strategjike (Idrizi et al, 2011);
- Perspektiva globale / rajonale / kombëtare dhe informacioni kontekstual (Idrizi et al, 2011);
- Zhvillimi i ekosistemit, kornizës së pellgjeve hidrografike për vlerësimin e mjedisit (Idrizi et al, 2011);
- Kuantifikimi i çështjeve ndërkufitare (Idrizi et al, 2011);

4.2.2 Historia e zhvillimit të Hartës Globale

Siç thuhet në (Specifikimet Globale të Hartave Versioni 2.2, 2012) që nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor të vitit 1972, njerëzit në mbarë botën kanë kuptuar që zgjidhja e problemeve mjedisore globale duhet të bëhet në një shkallë globale përmes komunikimit dhe bashkëpunimit. Një parim i deklaruar në këtë Konferencë ishte që “çështjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit duhet të trajtohen në një frymë bashkëpunuese nga të gjitha vendet e mëdha dhe të vogla, në një pozicion të barabartë. Bashkëpunimi përmes marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe ose mjeteve të tjera të përshtatshme është thelbësor për të kontrolluar në mënyrë efektive, parandaluar, zvogëluar dhe eliminuar efektet e pafavorshme mjedisore që vijnë nga aktivitetet e kryera në të gjitha sferat.” Por “Iniciativat dhe partneritetet për hartografinë globale "u inkurajuan fuqimisht në Planin e Johannesburg të Zbatimit pas Samitit Botëror për

Zhvillim të Qëndrueshëm në vitin 2002. Projekti i Hartës Globale u regjistrua më pas si një iniciativë pas këtij Samiti me qëllim të përfundimit të mbulimit global deri në vitin 2007(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Në vitin 1992, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedis dhe Zhvillim, të ashtuquajtur Samiti i Tokës, u mbajt në Rio de Janeiro, Brazil (<https://sdgs.un.org/un-system-sdg-implementation/united-nations-department-economic-and-social-affairs-undesa-24529>).

Në vitin 1994, në Izumo-Japoni u mbajt punëtorja e parë ndërkombëtare për hartografimin global, ku u vendos që zhvillimi i hartës globale duhet të vazhdojë me një qëllim përfundimi deri në vitin 2000 (Idrizi et al, 2011).

Procesi i zhvillimit të Hartës Globale është i mbështetur drejtpërdrejt nga Kombet e Bashkuara, nga e cila në vitin 1998 u lëshua letra drejtuar të gjitha organizatave kombëtare hartografike në të gjithë botën me ftesë për pjesëmarrje në projekt. “Iniciativat dhe partneritetet për hartografinë globale,” u inkurajuan fuqimisht në Planin e Implementimit të Johannesburgut pas Samitit Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm në vitin 2002, ku projekti i Hartës Globale u regjistrua më pas si një iniciativë pas këtij samiti me qëllim plotësimin e mbulimit global nga viti 2007 (International Conference on Spatial Data Infrastructures, 2010).

Që nga shkurti i vitit 2017, numri i vendeve pjesëmarrëse dhe rajoneve në Projekt ishte 184 (Sasagawa et al, 2017). Gjithashtu, numri i vendeve dhe rajoneve që publikuan të dhënat e Hartës Globale ishte 122 (duke përfaqësuar rreth 2/3 e sipërfaqes tokësore të planetit).

Nga vendet evropiane që marrin pjesë në projektin e Hartës Globale Evropiane të mundësuar nga Eurogeographics, 23 prej tyre marrin pjesë në Hartën Globale përmes Hartës Globale Evropiane dhe 12 të tjerë marrin pjesë direkt dhe përmes Hartës Globale Evropiane. Progresi i zhvillimit i të dhënave të Hartës Globale më 21-korrik-2016 është treguar më poshtë në figurën 4.3.

Progress of Global Mapping Project

As of 2016-07-21
International Steering Committee for Global Mapping




Figura 4.3 Progresi i projektit të Hartografisë Globale (21.07.2016, www.iscgm.org).

(Sasagawa et al, 2017) ndau periudhën historike të zhvillimit të Hartës Globale në periudhat vijuese:

1. Themelimi i ISCGM-së (1992-1996)

Në qeshor 1992, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (UNCED) në Rio de Janeiro, Brazil miratoi agjendën 21 si një program për adresimin e sidave globale mjedisore dhe përcaktimin e masave për t'u zbatuar (Sasagawa et al, 2017).

2. Aktivitetet deri në botimin e parë të të dhënave të Hartës Globale (1996-2000)

Në fillim të projektit, fokusi kryesor i ISCGM-së ishte zhvillimi i specifikimeve për të dhënat e Hartës Globale, ku përmes përpjekjeve të anëtarëve të ISCGM-së, një projekt i Programit Global të Veprimit Hartografik për përfundimin e versionit të parë të Hartës Globale deri në vitin 2000 u miratua në mbledhjen e tretë të ISCGM në vitin 1997 (Sasagawa et al, 2017).

3. Promovimi i Zhvillimit të të Dhënave (2001-2010)

Në gusht 2002, “Plani Implementues” i miratuar në Samitin Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm (Samiti i Johannesburg) i mbajtur në Johannesburg, Afrika e Jugut adresoi rëndësinë e Hartografisë Globale (Sasagawa et al, 2017).

4. Shfrytëzimi i Informacionit Gjeohapësinor (2011-2015)

Komiteti i Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për Menaxhimin e Informacionit Gjeohapësinor Global (UNGGIM) u themelua nën Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara në korrik 2011 (Rajabifard, 2020).

5. Drejt Përfundimit (2016-2017)

Gjatë periudhës 20- vjeçare aktive të ISCGM-së, mjedisi gjeohapësinor dhe projekti po ndryshonin pak nga pak (Sasagawa et al, 2017).

a) Në kohën kur u themelua ISCGM në mesin e viteve 1990, hartografia digjitale nuk ishte duke u përdorur shumë në të gjithë botën (Sasagawa et al, 2017).

b) Me rritjen e internetit, lloje të ndryshme të informacionit të hapur gjeohapësinor tani janë të disponueshme lirshëm dhe shumë njerëz mund t'i përdorin ato lehtësisht.

c) ISCGM dhe organizatat përkatëse kanë realizuar shumë programe për ndërtimin e kapaciteteve dhe kanë siguruar mjete të ndryshme për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për vendet dhe rajonet pjesëmarrëse (Sasagawa et al, 2017).

5 Trojet fqinje të Shqipërisë në projektin e Hartës Globale

5.1 Pasqyrë e përgjithshme

Para se të kalojmë në një analizë të hollësishme të zhvillimit të të dhënave hapësinore të Republikës së Shqipërisë në kuadër të projektit të Hartës Globale, në nënkapitujt e mëposhtëm, do të përshkruajmë shkurtimisht situatën e përfshirjes së tokave fqinje të Shqipërisë në projektin e Hartës Globale.

5.1.1 Republika e Kosovës në Hartën Globale

Republika e Kosovës në kuadër të projektit për përpilimin e hartës globale përfaqësohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), si institucioni përgjegjës për hartografinë e Kosovës në nivel kombëtar. Përgatitja e të dhënave të Kosovës për hartën globale është bërë në nivelin akademik brenda departamentit të gjeodezisë të Universitetit të Prishtinës, me qëllim të përkrahjes, ndihmës dhe përmirësimit të hartografisë në Kosovë (Idrizi et al, 2010). Hartat ekzistuese topografike në shkallë 1: 200.000, imazhe ortofoto nga viti 2004, si dhe të dhënat zyrtare nga institucionet qeveritare (Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria për Planifikim, Ministria për Transport dhe Zyra e Statistikave Shtetërore) janë përdorur si të dhëna burimore (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të drejtë për pjesëmarrje kanë vetëm organizatat kombëtare hartografike, të cilat janë institucionet përgjegjëse qeveritare për hartografinë dhe të dhënat hapësinore që zhvillohen në nivel kombëtar (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Siç është shpjeguar në kapitullin e mëparshëm, përfshirja e një organizate në projekt në përgjithësi është kategorizuar në tre nivele, d.m.th. si nivel A, B dhe C.

Republika e Kosovës merr pjesë në projektin e hartografisë botërore që nga 23.10.2003 në nivelin B, përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) si organizatë kombëtare hartografike (Figura 5.1) (IDRIZI, et al 2010).

Country	Organization	Status
Italy	*Italian Geographic Military Institute	Direct+Euro
Jamaica	*National Land Agency Surveys and Mapping Division	
Japan	*Geographical Survey Institute	Released
Jordan	*Royal Jordan Geographic Center	Released
Kazakhstan	*Scientific Technical Enterprise of Digital Cartography and GIS, The Committee for Management of Land Resources, Ministry of Agriculture STE "Kartinform"	Released
Kenya	*Survey of Kenya	Released
Kiribati	*Land Management Division	
Kosovo	*National Geographic Information Institute	
Kosovo / UNMK	*Kosova Cadastral Agency	
Kyrgyzstan	*State Service of Geodesy and Geodesy of Kyrgyz Republic	Released
Lao People's Democratic Republic	*National Geographic Department	Released
Latvia	*Geospatial Information Agency of Latvia	Released
Lebanon	*National Center for Remote Sensing *Lebanese Army Geographic Affairs (LAGA)	Released
Liberia	*Liberian Cartographic Service	
Libyan Arab Jamahiriya	*The Libyan Center for Remote Sensing and Space Science	
Liechtenstein		EuroGlobal/Map
Lithuania	*National Center of Remote Sensing and Geoinformatics "GIS Centras"	Direct+Euro
Luxembourg	*Administration du Cadastre et de la Topographie	EuroGlobal/Map
Madagascar	*National Institute of Cartography and Hydrography	
Malawi	*Survey Department, Ministry of Lands, Housing, Physical Planning and Surveys	
Malaysia	*Department of Survey and Mapping Malaysia	Released

Figura 4.4 Pjesë e listës së pjesëmarrësve në projektin e GM-s (www.iscgm.org)

Në rastin e të dhënave të Kosovës në Hartën Globale, për shkak të kushteve momentale në institucionet qeveritare në lidhje me të dhënat hapësinore, të gjitha të dhënat burimore janë furnizuar nga institucionet përgjegjëse qeveritare:

- Agjensia Kadastrale e Kosovës,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,
- Zyra e Statistikave të Kosovës, dhe
- Departamenti i Gjeografisë - Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Matematikore - Universiteti i Prishtinës - Prishtinë.

Institucionet e Kosovës që u zheksuan në listën e mësipërme kanë dhënë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të përditësuara për zhvillimin e të dhënave vektoriale të Hartës Globale për Kosovën, të cilat ishin në shkallë të ndryshme hartash dhe formate të ndryshme.


Çdo karakteristikë e hartës është ndarë në një numër kategorie që përdoret për të lidhur të dhënat gjeometrike me të dhënat etributeve përshkruese. Informacioni jolokalizues për një instancë tipike ruan sitribute, që mund të jenëtribute të detyrueshme ose opsionale.

Sa u përket shënimeve, nuk ka ndonjë rregull të përcaktuar të rreptë për t'i shndërruar ato nga gjuha lokale. Në rastin e Kosovës, për shkak se gjuha shqipe është zyrtare në Kosovë është në përdorim të shkronjave latine, tërë emrat janë bartur nga versioni zyrtar në nivel kombëtar.


Të dhënat e marra nga burimet gjatë procesit të zhvillimit të të dhënave vektoriale të Kosovës në GM janë analizuar në dy mënyra: dimensionet e formës gjeometrike dhe karakteristikat gjeografike (konceptuale). Kjo do të thotë se të gjitha

të dhënat e mundshme të burimit të pranuar janë kontrolluar për rëndësinë e tyre në krahasim me specifikimet e Hartës Globale. Kjo do të thotë që të gjitha të dhënat linjore me gjatësi më të vogël se 1km nuk mund të paraqiten në të dhënat vektoriale të Kosovës në Hartën Globale. I njëjti rregull vlen për të gjitha të dhënat e poligonit me sipërfaqe më të vogël se 1km². Në rastet kur analizat gjeografike tregojnë se çdo objekt edhe dimensionet e tij nuk plotësojnë kërkesat e specifikimit të GM-së, si element me rëndësi të konsiderueshme për tërësinë e bazës së të dhënave, elementet paraqiten duke ndryshuar formën e tyre gjeometrike.

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave të qendrave të popullsisë, brenda shtresës së qendrave të popullsisë së Kosovës në Hartën Globale në total janë përfshirë 58 qendra të popullsisë, d.m.th. 30 qytete dhe 28 vendbanime të tjera (rurale), figura 5.2 a). Sipas (Idrizi, et al 2010), në anën tjetër, të gjitha autostradat, hekurudhat, rrugët e rendit të parë dhe të dytë, disa rrugë lokale dhe aeroporti i Prishtinës janë përfshirë në shtresën e rrjetit të komunikacionit të të dhënave të Kosovës në Hartën Globale, treguar në figurën 5.2 b). Brenda shtresës së hidrografisë të të dhënave të Kosovës në Hartën Globale, bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat e hidrografisë së Kosovës, janë përfshirë 20 lumenj, 6 liqene dhe 4 diga, të cilat janë paraqitur në figurën 5.3 a). Në fund bazuar në rezultatet e dala nga analizat e kufijve të Kosovës në nivel kombëtar dhe lokal, brenda shtresës së kufijve janë paraqitur vija kufitare kombëtare dhe të gjitha kufijtë e komunave, të paraqitura në figurën 5.3 b).



a) b)
Figura 4.5 a) Qendrat e banimit dhe b) Komunikacioni brenda të dhënave të GM-së të Kosovës (Idrizi, et al 2010).



a)

b)

Figura 4.6 a) Hidrografia dhe b) Kufijtë brenda të dhënave të GM-së të Kosovës (Idrizi, et al 2010).

Më 19.08.2011 të gjitha shtresat vektoriale të të dhënave të Hartës Globale për Republikën e Kosovës janë publikuar në (<http://www.kca-ks.org>), si shtet i pavarur.

5.1.2 Republika e Maqedonisë së Veriut në Hartën Globale

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit “Studimet për zhvillimin e hartës bazë shtetërore në Republikën e Maqedonisë” (mars 2004 - nëntor 2006) dhe pas kësaj (nëntor 2006 - dhjetor 2010), shumë punë janë kryer nga AREC (Agjencia Kadastrale e Pasurive të Patundshme) dhe ekipi studimor JICA me ndihmën e organizatave të ndërlidhura për prodhimin e hartës kombëtare topografike në shkallë 1: 25000. Procesi filloi duke përcaktuar specifikimet e reja për infrastrukturën e të dhënave hapësinore, dhe punimet në terren për zbulimin e pikave të kontrollit të tokës dhe instalimin e sinjaleve për fotografitë ajrore. (Idrizi et al, 2011).

Para krijimit të portalit në internet, të dhënat e disponueshme për kyçje ishin:

- Të dhënat e Hartës Globale në formatin vektor në shkallët 1:1.000.000 që përbëheshin nga kufijtë kombëtar, komunat, modelet dixhitale të lartësisë (DEM), qendrat e banimit, lumenjtë, rrugët, aeroportet, dhe liqenet (Idrizi et al, 2011).
- Hartat topografike në format rasteri në shkallët 1: 200.000, 1: 100.000, 1: 50.000 dhe 1: 25.000 (si hartat e reja ashtu edhe ato të vjetra) dhe të tjerat (Idrizi et al, 2009).

Përpjekjet e përmendura kontribuan ndjeshëm në përfundimin me sukses të projektit të Hartës Globale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim të marrjes së aftësive për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale të Maqedonisë, në vitin 2005, z. Bashkim Idrizi si drejtues i departamentit të hartografisë mori pjesë në një trajnim profesional grupor për Hartografinë Globale, të organizuar nga ISCGM me mbështetje financiare të JICA-s, në Institutin Gjeografik Gjeodezik të Japonisë në Tsukuba. Në fillim (pas 15 tetorit 2005), u mbajt një trajnim lokal në AREC i organizuar për Hartografinë Globale, me qëllim për të shkëmbyer njohuritë që zoti Bashkim Idrizi ka marrë në Japoni me punonjësit tjerë në institucion.

- Të dhënat e Hartës Globale janë përfunduar në 21 shkurt 2006. Sipas specifikimeve të Hartës Globale, të dhënat e Hartës Globale për Maqedoninë e Veriut përbajnë 8 (tetë) shtresa, katër vektorë (figura 5.4) dhe katër shtresa rasteri (Idrizi et al, 2009).




Figura 4.7 Të dhënat vektoriale të Hartës Globale të Maqedonisë (Idrizi , 2006).

Pas kontrollit të cilësisë, të gjitha shtresat janë publikuar më 08 mars 2006 në faqen e internetit të ISCGM-së, të cilat mund të shkarkohen falas nga faqja e internetit e ISCGM-së (www.iscgm.org). (Idrizi B., 2006).

Të gjitha të dhënat janë ndërtuar në datumin gjeodezik WGS84 në shkallën 1: 1.000.000 që korrespondon me specifikimet e Hartës Globale të botës.

Institucioni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave të Hartës Globale për Republikën e Maqedonisë së Veriut është AREC (Agjencia Kadastrale e Pasurive të Paluajtshme). Aktualisht në faqen në internetit

(www.iscgm.org) mund të gjendet dhe shkarkohet versioni i dytë i përditësuar i të dhënave të Hartës Globale të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga viti 2011.(Figura 5.5.)




Figura 4.8 Të dhënat raster në Hartën Globale të Maqedonisë (Idrizi , 2006).

5.1.3 Mali i Zi në Hartën Globale

Republika e Malit të Zi nuk është e përfshirë në projektin e Hartës Globale.

5.1.4 Greqia në Hartën Globale

Greqia nuk është e përfshirë direkt në projektin e Hartës Globale. Është e përfshirë si anëtare në një projekt të ngjashëm të zhvilluar nga Bashkimi Evropian, i quajtur Harta Globale e Evropës (EGM). Prandaj shkurtimisht do të përshkruhet projekti i Hartës Globale të Evropës i udhëhequr nga Bashkimi Evropian.

EuroGeographics njihet si zëri i Hartografisë Kombëtare Evropiane, dhe Autoriteteve Kadastrale të Regjistrimit të Tokave (<https://eurogeographics.org/>).

Organizata ka origjinën e saj më shumë se 20 vjet me krijimin e Komitetit Evropian për Udhëheqjen e Hartografisë Zyrtare (CERCO) si një forum për shpërndarjen, diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve të zakonshme.

Harta Globale e Evropës është një përmbledhje e të dhënave topografike në shkallë 1:1 milion që mbulon 45 vende dhe territore në rajonin evropian. Harta Globale e Evropës është e përsosur për t'u përdorur si dokumentacion për shumë qëllime si planifikimi, monitorimi dhe analizimi i rrjetit deri te paraqitja e politikave mjedisore. (www.eurogeographics.org). EGM mundëson përdorimin e veçorive topografike si lumenjtë, rrjetin e transportit, vendbanimet në shkallë të vogël si dokumentacion për aplikime të tilla siç është planifikimi, monitorimi, analizimi i rrjetit dhe prezantimi i politikave mjedisore.

Duke marrë parasysh organizimin strukturor të modelit të gjeodatabazës së EGM-së ka mbledhur të gjitha klasat e tipareve në një set të dhënash unike. Temat nuk përcaktohen. Klasat e veçorive përcaktohen si klasa të thjeshta tiparesh: zona, rreshti, pika. Karakteristikat përcaktohen si nëntipa të klasës së tipareve. Fushat me vlerë të kodifikuar janë përcaktuar gjithashtu për atributet në nivelin e nënlojeve. Format e shpërndarjes në dispozicion janë: Geodatabazë Personale ESRI dhe Gjeo të Dhëna-bazë të dosjes në ArcGis 10.

Më poshtë në figurën 5.6 është dhënë harta e vendeve evropiane që janë përfshirë në EGM.



Figura 4.9 Harta e mbulimit të vendeve të përfshira në Hartën Globale Evropiane

Të dhënat përmbajnë pesë shtresa:

- Kufijtë administrativë
- Rrjetin ujqor
- Rrjetet e transportit
- Vendbanimet
- Emërtimet

Shtresa e **kufijve administrativë** përmban informacione mbi subjektet administrative deri në nivelin NUTS3 dhe hierarkinë e tyre administrative. Është përcaktuar një sistem kodimi për të gjitha nivelet e përfshira administrative.

Rrjeti ujqor përmban informacione rreth rrjedhave ujore, zonës së hapur të ujit, bregdetit dhe objekteve hidrologjike (digat).

Rrjeti i transportit përmban informacione për rrugët dhe hekurudhat, linjat e trageteve, aeroportet (<https://eurogeographics.org/>). Lidhjet midis stacioneve të trageteve dhe mënyrave të tjera të transportit janë shtuar (<https://www.nidirect.gov.uk/articles/eurogeographics-vector-mapping>).

Tema e vendbanimit përmban informacione për zonat e ndërtuara dhe vendet e banuara, kryesisht emrin e tyre dhe numrin e banorëve.

Emërtimet janë përshkrim tekstual që nuk kanë të bëjnë me të dhëna vektoriale por janë të nevojshme për qëllime hartografike (<https://eurogeographics.org/>).

Krahas pesë shtresave të sipërpërmendura të Hartës Globale të Evropës që janë në format vektori është përgatitur edhe një shtresë rasteriale EuroDEM (model dixhital i lartësisë), i cili përshkruan shpërndarjen e lartësive të terrenit ose 'tokës së zhveshur', duke mos përfshirë lartësitë e sipërfaqes së parë si bimësia dhe strukturat e bëra nga njeriu. Është ideale për hulumtime të ndryshimit mjedisor, modelim hidrologjik, monitorim të burimeve, monitorim hartografie dhe vizualizim.

Ka pasur tri periudha kryesore të evolucionit që lidhen me SDI-në Greqi:

1. Periudha para SDI-së që filloi në fillim të viteve 90 dhe zgjati deri në vitin 2000. Kjo është periudha gjatë së cilës teknologjia e spikatur për menaxhimin e të dhënave hapësinore ishin Sistemet e Informacionit Gjeografik (Panagiotis, 2013). Themelet për zhvillimet e SDI-së që pasuan u vendosën në këtë periudhë.

2. Periudha e përpjekjes së parë për zhvillimin e një NSDI-e Greke (2000-2008) që kryesisht u financua nga Korniza e tretë e Mbështetjes së Komunitetit - CSF (SIS, 2013).

3. Periudha e përpjekjes së dytë për një NSDI Greke që filloi në vitin 2008 e cila është Organizata Kombëtare Hartografike e Greqisë (NMO), që u bë organizata udhëheqëse koordinuese (Pediaditi et al, 2010) dhe do të publikojë NSDI-në greke mbi premisat e direktivës INSPIRE.

5.1.5 Serbia në Hartën Globale

Në Republikën e Serbisë në kuadër të projektit donator të Qeverisë së Japonisë, dhe me mbështetjen e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe ekspertëve japonezë, dhe në kuadër të projektit "Zhvillimi i aftësisë për të prodhuar një hartë dixhitale bazë shtetërore në Republikën e Serbisë", që nga marsi i

vitit 2011, u krijuan kushte për Autoritetin Gjeodezik të Republikës që të marrë pjesë në zbatimin e projektit ndërkombëtar të Hartografisë Globale.

Njoftimi ishte publikuar nga Komitetit Drejtues Ndërkombëtar për Hartografinë Globale (ISCGM) me datë 25 mars 2011.

Të dhënat e zhvilluara të Hartës Globale në format vektori përbëhen nga shtresat e mëposhtme: shtresat e transportit (aeropotet, stacionet hekurudhore, rrjetet rrugore, rrjetet hekurudhore); shtresat e kufijve (zona kufitare të poligonit dhe vijat kufitare të poligonit); shtresat e hidrografisë (pika të ndryshme, linja të ndryshme, rrjeti i linjave lumore, zonat ujore); shtresa e qendrave të banimit (zona të ndërtuara dhe pikat e vendbanimeve). Shtresat vektoriale të të dhënave të Hartës Globale tregohen në (figurën 5.7) më poshtë.




Figura 4.10 Shtresat vektoriale e të dhënave të Hartës Globale për Republikën e Serbisë

Pas përfundimit të trajnimeve, aktivitetet në RGZ (Autoriteti Gjeodezik i Republikës së Serbisë) vazhduan dhe shtresa për paraqitje të lartësive të terrenit dhe mbulesës së tokës u krijuan dhe u publikuan (figura 5.8).




Figura 4.11 Shtresat raster e të dhënave të Hartës Globale të Republikës së Serbisë, a) Shtresa e mbulimit të tokës dhe b) Shtresa e lartësisë .

Gjithashtu, në emër të Serbisë, RGZ (Institucioni Gjeodezik i Republikës së Serbisë) kontribuoi në zhvillimin e shtresave globale GLCNMO2 (mbulimit të tokës) dhe PTC2 (bimësisë) në (figurën 5.7).

Është e rëndësishme së veçantë të përmendet fakti se të dhënat e Hartës Globale të Republikës së Kosovës të punuara nga AKK-ja u publikuan në GM disa ditë para shpalljes së të dhënave nga RGZ-së për Republikën e Serbisë.

Fatkeqësisht, në bazën e të dhënave të Serbisë u përfshinë edhe të dhënat e Republikës së Kosovës. Krahasuar cilësinë e të dhënave të Hartës Globale të shpallura nga Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë për territorin e Republikës së Kosovës, mund të vërehet qartë se të dhënat e Hartës Globale të Republikës së Kosovës të zhvilluara nga AKK janë më të sakta dhe më të përditësuara në krahasim me ato të RGZ për Serbinë!

6 Zhvillimi i të dhënave hapësinore për Republikën e Shqipërisë në Hartën Globale.

Kuptohet se seksioni i hartografisë është një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit të planifikimit hapësinor. Ai përfshin dy grupe hartash: Hartat që pasqyrojnë statusin aktual dhe kushtet e përdorimit të zonës; Hartat që pasqyrojnë propozimet e projektit për zonimin e përdorimit të tokës, ndryshimet e kufijve dhe ndarjen e burimeve, projektet e kapitalit të vendndodhjes, etj.

Nga ana tjetër, në lidhje me përdorimin e GIS-it në çështjet e planifikimit hapësinor në Shqipëri mund të hasen çështje dhe kufizime të ndryshme. Këto janë renditur në punimin e (Nikolli et al, 2014):

- të dhënat në dispozicion të institucioneve, përveç topografisë, ende nuk janë të mjaftueshme,
- statistikat për komunat, qarqet dhe njësitë lokale në përgjithësi nuk janë të mjaftueshme,
- mungojnë të dhëna të sakta për shkallë të gjerë,
- mungon monitorimi i mjaftueshëm i të dhënave mjedisore,
- mungesë e madhe e attributeve të të dhënave,
- probleme madhore ligjore në lidhje me të drejtat e autorit për të dhëna të ndryshme hapësinore,
- më shumë të dhëna janë të bazuara në sisteme të ndryshme të referencës për këtë arsye duhet të bëjnë konvertimin e tyre,
- kufizimet kryesore të përdorimit të GIS-it në planifikim në Shqipëri, është që nuk merren me çështje teknike, por me disponueshmërinë e të dhënave, ndryshimet organizative dhe trajnimin e specialistëve.

Mbi bazën e fakteve të lartpërmendura ekziston një nevojë thelbësore për zhvillimin e një të dhëne të Hartës Globale për Shqipërinë sipas specifikimeve dhe standardeve të Hartës Globale. Kjo paraqet nevojën e përfshirjes së Republikës së Shqipërisë në projektin e Hartografisë Globale.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë vetëm organizatat kombëtare hartografike, të cilat janë institucionet përgjegjëse qeveritare për hartografin dhe të dhënat hapësinore që zhvillohen në nivel kombëtar (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Sipas (Lubishtani et al, 2020), Republika e Shqipërisë merr pjesë në projektin e Hartës Globale që nga 30.06.2016 në *nivelin B që do të thotë* që institucioni përgjegjës do të përgatisë grupin e të dhënave të vendit të vet. Institucioni përgjegjës për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) si institucion hartografik kombëtar dhe organizatë e infrastrukturës së të dhënave hapësinore (figura 6.1).

Republika e Shqipërisë është vendi i fundit që ka marrë pjesë në projektin e GM-së, para konvertimit të tij në UNGIS në gusht të vitit 2016!

Country or Region	Organization	Details
Africa		
		See more
Asia		
		See more
Europe		
Republic of Albania	State Authority for Geospatial Information	Released
Andorra	Minister of Urbanism and Government	EuroGlobalMap
Austria	Federal Office of Metrology and Surveying	EuroGlobalMap
Belarus	The State Committee on Property of the Republic of Belarus	Direct
Belgium	National Geographic Institute General Administration of Patrimonial Documentation	EuroGlobalMap
Bosnia and Herzegovina	Federal Administration for Geodetic and Real Property Affairs Republic Authority for Geodetic and Property Affairs of Republic of Srpska	
Bulgaria	Geodesy, Cartography and Cadastre Agency	Released
Croatia	State Geodetic Administration of the Republic of Croatia	EuroGlobalMap
Cyprus	Cyprus Department of Lands and Surveys	Direct+Euro
Czech Republic	Czech Office for Surveying, Mapping and Cadastre	EuroGlobalMap
Denmark	Danish Geodata Agency	EuroGlobalMap
Estonia	Estonian Land Board	Direct+Euro
Finland	National Land Survey of Finland Finnish Geodetic Institute	EuroGlobalMap
France	National Institute of Geographic and Forest Information	EuroGlobalMap
Georgia	The State Department of Geodesy and Cartography	Released
Germany	Federal Agency for Cartography and Geodesy Working Committee of the Surveying Authorities of the Laender of the Federal Republic of Germany	Direct+Euro
Greece	Hellenic Military Geographical Service National Cadastre and Mapping Agency S.A.	Direct+Euro

Figura 6.1 Lista e pjesëmarrësve në projektin e Hartës Globale (www.iscgm.org)

Zhvillimi i të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë është realizuar në një bashkëpunim të ngushtë midis Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeografik (ASIG) dhe Departamentit të Gjeodezisë së Universitetit Politeknik të Tiranës në një fushë të krijimit të GSDI-së të Shqipërisë (Infrastruktura Globale e të Dhënave Hapësinore) me një rast studimi për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë. Ekipi punues i ASIG-ut gjatë zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale është udhëhequr nga unë, autor i temës së disertacionit të doktoratës, nga ana e Universitetit, dhe i mbikëqyrur nga profesor Bashkim Idrizi (nga ana e Universitetit), së bashku me hartografinë dhe ekspertët e GIS-it të ASIG-ut, dhe me mbështetje teknike të drejtpërdrejtë nga ekipi i ekspertëve nga ISCGM-së nga Japonia.

Gjatë hulumtimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit me një ekip ekspertësh është bërë grupi i të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë V2.2, i cili përbëhet nga të dy grupet e të dhënave, shtresat vektoriale dhe rasteriale, gjithsej 8 shtresa të të dhënave, të cilat janë publikuar më 14 korrik të vitit 2016 në www.iscgm.org, si të shkarkueshëm falas për përdorim jokomercial (figura 6.2).

/index.html

Activity of Global Mapping Project

International Steering Committee for Global Mapping (ISCGM), in cooperation with relevant organizations of respective countries and regions around the world, has been working for the Global Mapping Project, an effort to develop, provide and promote the use of geospatial information necessary for addressing global challenges, including environmental problems and disaster prevention, and advancing sustainable development of the world.

What's New

2016-08-02: Twenty-third meeting of the ISCGM in NY was successfully concluded. >> [ISCGM23 Page](#)

2016-08-01: "A Twenty Year Journey in Global Mapping" is posted. >> [ISCGM23 Page](#)

2016-07-21: [Global Map Cote d'Ivoire Version 2 is Released](#)

2016-07-14: [Global Map Albania Version 2 is Released](#)

2016-07-12: [Global Map V.3 \(Global Version, GLCNMO\) is released](#)

2016-06-30: [Republic of Albania participated](#)

2016-06-01: Announcement and Registration Page of the 23rd Meeting of the ISCGM is Posted. >> [ISCGM23 Page](#)

2016-05-12: [Urban Hazard Maps Web Portal Renewal](#)

>> [More News](#)

2016

Fourth UN-GGIM High Level forum
Apr. 20-22, Addis Ababa, Ethiopia

FIG Working Week 2016
May. 2-6, Christchurch, New Zealand

23rd meeting of ISCGM
Aug. 2, New York, USA

Sixth Session of UN-GGIM
Aug., New York, USA

Fifth UN-GGIM-AP Plenary Meeting
Oct., Malaysia

WE MAPS
INTERNATIONAL MAP YEAR 2015-2016

Get Adobe Reader
Adobe Reader is FREE software that allows users to view and print PDF files.

FAQ

Figura 6.2 Ekstrakt i faqes në internet të ISCGM-së (www.iscgm.org, 30.08.2016)

6.1 Të dhëna burimore të Hartës Globale të Shqipërisë.

Institucionet përgjegjëse qeveritare për furnizimin e grupeve të të dhënave aktuale si dhe ato të përditësuara që janë përdorur në Republikën e Shqipërisë janë (Lubishtani M and Idrizi B, 2016):

- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (Lubishtani et al, 2020);
- Instituti i Transportit (Lubishtani et al, 2020);
- Instituti Shqiptar i Statistikave (Lubishtani et al, 2020);
- Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë (Lubishtani et al, 2020);
- Ministria e Zhvillimit Urban (Lubishtani et al, 2020).

Në fazën fillestare të përgatitjes për të harmonizuar të dhënat hyrëse me specifikimin e Hartës Globale V2.2, të gjitha të dhënat e marra janë shndërruar, konvertuar, harmonizuar dhe përgjithësuar, dhe në rastet e imazheve satelitore janë ripërpunuar (Lubishtani M and Idrizi B, 2016).

Për shtresat vektoriale të kufirit, transportit, hidrografisë dhe qendrave së popullsisë, burimi i të dhënave për krijimin e të dhënave të Hartës Globale ishte një hartë dixhitale në shkallë 1: 25000 dhe ortofoto, imazhi i hartës i bërë në vitin 1985 dhe ortofoto i bërë në vitin 2008.

Sa u përket shtresave të rasterit, shtresa e lartësisë së Hartës Globale të Shqipërisë versioni 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale të

versionit 2.2. Burimet e të dhënave u zhvilluan duke përdorur imazhet satelitore nga viti 2000.

Shtresa e bimësisë së Hartës Globale të Shqipërisë versioni 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale të versionit 2.2. Burimet e të dhënave u zhvilluan duke përdorur imazhet satelitore nga viti 2012.

Shtresa e mbulesës së tokës së Hartës Globale të Shqipërisë versioni 2 u zhvillua bazuar në specifikimet e Hartës Globale të versionit 2.2. Për të bërë mbulesën e tokës janë përdorur imazhet satelitore IRS, SPOT dhe RapidEye, mbulim i dyfishtë si dhe harta topografike.

6.2 Zhvillimi i të dhënave vektoriale të Hartës Globale të Shqipërisë

Specifikimet e Hartës Globale të versionit 2.2 janë përdorur për të krijuar të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë për të dhëna vektoriale dhe rasteriale.

Sistemi kordinativ ITRF94 është përshtatur si sistem koordinativ referent për Hartën Globale për Shqipërinë. Elipsoidi GRS80 është përshtatur për të përfaqësuar pozicionin e objekteve hapësinore në gjatësi dhe gjerësi gjeografike.

Plani i punës gjatë zhvillimit të të dhënave të Hartës Globale është i ndarë në 3 faza:

- Ndërtimi i një baze të hartave burimore,
- Kontrolli i cilësisë së hartave dhe
- Korrigjimi i gabimeve eventuale.

Siç u shpjegua në nënkapitullin 4.2.2.1 në figurën 4.1, tiparet e të dhënave vektoriale përfaqësohen nga tre objektet themelore hapësinore: pikat, linjat (vijat) dhe sipërfaqet (poligonet), të ndara në një numër kategorie për lidhjen e gjeometrisë me të dhënat etributeve.

Lista e shtresave të zhvilluara të vektorit, emrat e tipareve, llojet gjeometrike, përfshirja (opsionale ose e detyrueshme) dhe shkurtesat e emrave të shtresave janë dhënë më poshtë në tabelën 6.1 (Idrizi et al, 2010).

Tabela 6.1 Llojet e tipareve, emri, lloji dhe përfshirja e shtresave vektoriale (Idrizi et al,2010).

Layer	Feature Name	Feature Type	Inclusion	Abbreviation
Transportation	Airport	point	optional	airp
	Railroad Station	point	optional	rstatp
	Port	point	optional	portp
	Railroad	edge	mandatory	raill
	Road	edge	mandatory	roadl
	Trails and Tracks Line	edge	mandatory	traill
	Ferry route	edge	optional	ferryl
Boundaries	Political Boundary	point	mandatory	polbndp
	Coast Line	edge	mandatory	coastl
	Political Boundary Line	edge	mandatory	polbndl
	Political Boundary Area	face	mandatory	polbnda
Drainage (Hydrography)	Miscellaneous (Dam/Weir/Island/Spring /Water-Hole)	point	optional	miscp
	Miscellaneous (Dam/Weir)	edge	optional	miscl
	Aqueduct/Canal/Flume/ Penstock	edge	optional	aquel
	Water Course	edge	mandatory	riverl
	Inland Water	face	mandatory	inwatera
Population Centres	Built-up area	point	optional	builtupp
	Built-up area	face	optional	builtupa

Shtresat e detyrueshme të treguara më lartë në tabelën 6.1 do të përpunohen vetëm kur tiparet janë të pranishme dhe janë domethënëse në shkallën e të dhënave.

Kufijtë ndërkombëtarë për hartën globale do të jenë siç përcaktohen nga kombet që furnizojnë të dhëna. Kur kombet fqinje ofrojnë përfaqësime të ndryshme të kufirit, të dy do të përfshihen në produkt.

Karakteristikat e ruajtura si skaj dhe pamje do të jenë të strukturuar individualisht. Topologjia do të mbahet përtej kufijve të trapezëve. Fenomenet e botës reale që përshkojnë skajin e trapezëve do të kenë saktësisht të njëjtat koordinata në nyjet në skaje të trapezëve të çdo trapezi. Kjo do të lejojë që baza e të dhënave të funksionojë si një njësi ndihmuese për qëllime të analizës. Për shembull, më poshtë në figurën 6.3, skajet e rrugës në të dy trapezët do të përpunohen në skajin e të dy trapezëve.




Figura 6.3 Topologjia në të gjithë skajin e trapezëve (Specifikimet e Hartës Globale versioni 2.2 , 2012)

Lidhur me cilësinë e të dhënave të shtresave vektoriale:

- Qëndrueshmëria logjike duhet të mbahet.
- Tiparet nuk duhet të kopjohen ose hiqen kur plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

Për ndërveprimin e përdorimit të Hartës Globale, formatet për përdoruesit përcaktohen në mënyrë të pavarur nga formatet zyrtare.

Emrat e dosjeve e të dhënave Shape and GML janë ndryshe (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Emrat e dosjeve Shape përbëhen nga shkronjat identifikuese të shtresës, dhe në fund të shkronjës së emrit të llojit gjeometrik të të dhënave (**p** për pikë, **l** për linjë dhe **a** për poligone), të shafqura në tabelën 6.2. Emrat e shtresave vektoriale të ruajtura në format GML kanë një emër të dosjes në form të `www_XXX_y.zzz` or `www_XXX.zzz` ku:

- `www` – identifikon shkurtesën e llojit të treguar në tabelën 6.1 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- `xxx` – identifikon kodin e vendit nga Kodi Kombëtar ISO 3166 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- `y` – tregon ID unike nëse një territor është i ndarë në dy ose më shumë trapezë (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010), dhe
- `zzz` - është shtesa që identifikon të dhënat (gml) (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Tabela 6.2 Emrat e dosjeve SHAPE të Hartës Globale V1/V2 (version kombëtar dhe rajonal) (Idrizi et al, 2010)

Dosja Shape	Llojet
transp.shp	Aeroporti , Stacioni hekurudhor
transl.shp	Linja hekurudhore, rrugë, linjat e binarëve, strukturat (ura, tunel, rrugë trageti)
bndp.shp	Kufiri politik
bndl.shp	Vija kufitare politike, Vija bregdetare
bnda.shp	Kufiri politik, Oqeani / Deti
hydrop.shp	Të ndryshme (shtrati i lumenjve, ujëdhese, puse të ujit)
hydrol.shp	Ujsjedhë/kanal/port uji, rrjedhja e ujit
hydroa.shp	Ujërat e brendshëm
popp.shp	Zonat e ndërtuara, popullsi të ndryshme
popa.shp	Zonat e ndërtuara

Në tabelën tjetër 6.3 është dhënë një shembull i emrave të dosjeve GML të Hartës Globale V1/V2 (version kombëtar dhe rajonal).

Tabela 6.3 Shembull i emrave të dosjeve GML të Hartës Globale V1/V2 (version kombëtar dhe rajonal) (Idrizi et al, 2010)

Emrat e dosjeve GML	Përshkrimi
builtupa_al_1.gml	Kur vendi është i ndarë në dy ose në më shumë trapezë
builtupa_al.gml	Kur i gjithë vendi është brenda një trapezi

6.2.1 Shtresat e transportit të të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Ekzistojnë shtatë shtresa të transportit kombëtar të zhvilluar në Hartën Globale të të dhënave shqiptare (Lubishtani M and Idrizi B, 2016):

- **Aeroportet**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për aeroportet e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si pika (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);
- **Portet**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për portet kryesore të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si pika (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);

- **Rrugët e traqeteve**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për traqetet e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si linja (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);
- **Hekurudhat**, stacionet që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për stacionet hekurudhore të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si pika (Lubishtani M dhe Idrizi B, 2016);
- **Hekurudhat**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për hekurudhat e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si linja (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);
- **Pikat e stacioneve të trenave**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për stacionet e trenave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si pika (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);
- **Rrugët**, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për rrugët e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuara si linja (Lubishtani M and Idrizi B, 2016).

Bazuar në rezultatet, të nxjerra nga analizat dhe përpunimi i rrjetit të transportit në Shqipëri; të gjitha autostradat, hekurudhat, rrugët e rendit të parë dhe të dytë, disa rrugë lokale dhe aeroporti i Tiranës, janë përfshirë në shtresën e rrjetit të transportit të Hartës Globale për Shqipërinë (Lubishtani M and Idrizi B, 2016).

Në total janë përfshirë 302 km autostradë, 421 km rrugë kryesore, 3362 km rrugë dytësore, 11583 km rrugë të tjera dhe 483 km rrugë hekurudhore, të paraqitura në figurën 6.4.




Figura 6.4 Shtresat e transportit në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë

Shtresa e zhvilluar e transportit në formë table është paraqitur më poshtë në tabelën 6.4:

Tabela 6.4 Shtresa e transportit e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë

Emri	Gjeometri	Lloji	Përshkrimi
Aeroport	Pikë	Aeroporti civil ndërkombëtar, ushtarak	
Portet	Pikë	Emri	
Rruga e targeteve	Linjë	Emri	
Hekurudhat	Pikë	Emri	
Hekurudhat	Linjë	Funksionale, në ndërtim e sipër, e pa përdorur	Një linjë ose dy linja

Stacionet e trenit	Pikë	Emrat e stacioneve	
Rrugët	Linjë	Autostradat, parësore, dytësore	Drejtime të ndara ose jo, me sipërfaqe të gjelbërta midis ose jo, rrugët që përshkojnë tunelet, rrugët që përshkojnë rrugët ujore, përdorimi në të gjitha stinët ose jo, saktësia e linjës së rrugës, kategoria e rrugës.

6.2.2 Shtresa e kufijve e të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Ekzistojnë tri shtresa kombëtare të zhvilluara në Hartën Globale të të dhënave Shqiptare (Lubishtani M and Idrizi B, 2016) :

- **Linja bregdetare**, e cila përfshin të dhëna dixhitale hartografike me attribute për vijën bregdetare të deteve të Shqipërisë, të përfaqësuara si linja (Lubishtani, Idrizi, 2016);
- **Linja e kufirit politik**, e cila përfshin të dhënat dixhitale hartografike me attribute për kufijtë kombëtarë dhe administrativë (në dy nivele, si distrikte dhe komuna) të Shqipërisë, të përfaqësuara si linja (Lubishtani, Idrizi, 2016);
- **Zona kufitare politike**, të cilat përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për zonat (poligonet) e qarqeve dhe bashkive (bazuar në legjislacionin aktual) të Shqipërisë, të përfaqësuar si poligone (Lubishtani, Idrizi, 2016).

Në fund, duke u bazuar në rezultatet e dala nga analizat e kufijve të Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar dhe lokal, brenda shtresës së kufijve janë shtuar edhe vija kufitare kombëtare, vija e qarqeve dhe të gjitha kufijtë e bashkive, të paraqitur në figurën 6.5.




Figura 6.5 Shtresa e kufijve në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë

Shtresa e zhvilluar e kufijve në formatin e tabelës është paraqitur më poshtë në tabelën 6.5:

Tabela 6.5 Shtresa e kufijve e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë

Emri	Gjeometri	Lloji	Përshkrimi
<i>Linja bregdetare</i>	Linjë	Vija bregdetare e detit dhe liqeneve	
<i>Kufiri politik</i>	Linjë	Komuna	
<i>Kufiri politik</i>	Poligon	Komuna	Numri i popullsisë dhe viti i regjistrimit

Sipas (Lubishtani, Idrizi, 2016), këto shtresa janë pjesë e koleksionit tonë të të dhënave themelore dixhitale hartografike në format vektori në shkallën 1: 1.000.000. Për sa i përket gjeometrisë vektoriale (linjat, pikat dhe poligonet) në këto shtresa janë identike me shtresat e hartave të kufijve të Hartës Kombëtare. Dallimi është në atributet e caktuara në veçoritë e kufijve. Botimi i Hartës Globale përfshin vetëm fushat e të dhënave dhe vlerat e attributeve sipas specifikimeve të Hartës Globale të versionit 2.2.

6.2.3 Shtresa e Hidrografisë së të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Ekzistojnë katër shtresa kombëtare të zhvilluara në Hartën Globale të të dhënave Shqiptare (Lubishtani, Idrizi, 2016):

- ***Të ndryshme***, që përfshijnë të dhënat dixhitale hartografike me attribute për digat, shtretërit e ujërave, ujdhesat, burimet dhe pusët e ujit të Shqipërisë, të përfaqësuar si pika (Lubishtani, Idrizi, 2016);
- ***Kanalet***, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për ujësjellësit, kanalet, portat e ujërave, rrjedhjeve të ujërave të Shqipërisë, të përfaqësuar si linja (Lubishtani, Idrizi, 2016);
- ***Lumenjtë***, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për rrjetin ujqor të Shqipërisë, të përfaqësuar si linja (Lubishtani, Idrizi, 2016);
- ***Ujërat e brendshme***, që përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për liqenet e Shqipërisë, të përfaqësuar si poligone (Lubishtani, Idrizi, 2016).

Brenda shtresës së hidrografisë së të dhënave të Hartës Globale, në bazë të rezultateve të nxjerra nga analizat e hidrografisë së Shqipërisë, janë përfshirë 41 lumenj, 477 liqene dhe 896 rezervuare, të paraqitur në figurën 6.6.




Figura 6.6 Shtresa e hidrografisë në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë (Lubishtani M and Idrizi B, 2016)

Shtresa e zhvilluar hidrografike në format tabelle është paraqitur më poshtë në tabelën 6.6:

Tabela 6.6 Shtresa e kullimit e të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë (Lubishtani M and Idrizi B,2016)

Emri	Gjeometri	Lloji	Përshkrimi
<i>Të ndryshme</i>	Pika	Emri, burimet kryesore	
<i>Kanalet</i>	Linja	Emri (nëse ka ndonjë)	
<i>Lumenjtë</i>	Linja	Emri	Lloji i rrjedhave të lumenjve
<i>Ujërat brendshme</i>	Poligon	Emri	Lloji (liqene etj.)

6.2.4 Shtresa e qendrave të popullsisë së të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Ekzistojnë dy shtresa kombëtare të zhvilluara të Hartës Globale të të dhënave Shqiptare (Lubishtani M and Idrizi B,2016):

- **Zona të ndërtuara**, të cilat përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për qytetet kryesore të Shqipërisë, të paraqitura si sipërfaqe (Lubishtani M and Idrizi B,2016).
- **Zona të ndërtuara**, të cilat përfshijnë të dhëna dixhitale hartografike me attribute për qytetet më të vogla dhe vendbanimet kryesore të Shqipërisë, të paraqitura si pika (Lubishtani M and Idrizi B,2016).

Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave të qendrave të popullsisë në Republikën e Shqipërisë brenda shtresës së qendrave të popullsisë së Hartës Globale të Shqipërisë, në total janë përfshirë 208 qendra të popullsisë, respektivisht 61 qytete dhe 147 vendbanime, treguar në figurën 6.7.




Figura 6.7 Shtresa e qendrave të popullsisë në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë

Shtresat e zhvilluara të qendrave të popullsisë në formatin e tabelës është paraqitur më poshtë në tabelën 6.7.

Tabela 6.7 Shtresa e qendrave të popullsisë në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë

Emri	Gjeometri	Lloji	Përshkrimi
Vendbanimet - jo më të vogla se 1 km ²	Pika	Emri, numri i popullsisë, viti i regjistrimit	
Vendbanimet e mëdha kryesore	Poligoni	Emri, numri i popullsisë, viti i regjistrimit	

Të dhënat e shpjeguara më lartë në format vektorial mund të shkarkohen falas nga faqja në internet të ISCGM: <https://www.iscgm.org/gmd> me zgjedhjen e zonës kontinentale dhe zgjedhjen e vendit për të cilin do të dëshironi të shkarkoni të dhënat - në rastin tonë: Evropë dhe në listën e vendeve: Shqipëria (figura 6.8).




Figura 6.8 Faqja e internetit për shkarkim falas (<https://www.iscgm.org/gmd>)

6.2.5 Përgatitja e Metadatave e të dhënave vektor të Hartës Globale për Shqipërinë.

Në përgjithësi, ekzistojnë tre tipe të dallueshme të metadatave:

- Metadatat strukturore (Lubishtani M and Idrizi B, 2016);
- Metadatat përshkruese (Lubishtani M and Idrizi B, 2016) dhe
- Metadatat administrative (Lubishtani M and Idrizi B, 2016).

Profili i metadatave të Hartave Globale është i bazuar në standardin ISO 19115 për elementet thelbësore të metadatave dhe profile të tjera për të siguruar informacione mbi të dhënat e Hartës Global.

Më poshtë në tabelën tjetër 10, është dhënë një ekstrakt nga Metadatat Shqiptare e Hartës Globale e të dhënave vektoriale (Lubishtani M and Idrizi B, 2016):

Tabela 6.8 Ekstrakt nga METADATA Shqiptare V2.2. e Hartës Globale (Lubishtani M and Idrizi B., 2016)

	Kufiri	Hidrografia	Qendrat e popullsisë	Rrjeti i transportit
Vendi	Albania	Albania	Albania	Albania
Versioni	2.2	2.2	2.2	2.2
Metadata	Kufiri	Kullimi	Qendra e popullsisë	Transporti
Emri i organizatës	ASIG (Autorieti Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore)	ASIG (Autorieti Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore)	ASIG (Autorieti Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore)	ASIG (Autorieti Shtetëror për Informacione Gjeohapësinore)
Thirrja	+355672138519	+355672138519	+355672138519	+355672138519
Pika shpërndarëse	Str."Papa Gjon Pali II",Godina e Inovacionit, kati III- te	Str."Papa Gjon Pali II",Godina e Inovacionit, kati III- te	Str."Papa Gjon Pali II",Godina e Inovacionit, kati III- te	Str."Papa Gjon Pali II",Godina e Inovacionit, kati III- te
Qyteti	Tirana	Tirana	Tirana	Tirana
Zona administrative	Tirana	Tirana	Tirana	Tirana
Vendi	Albania	Albania	Albania	Albania
Adresa elektronike	dcm@bnetd.ci	dcm@bnetd.ci	dcm@bnetd.ci	dcm@bnetd.ci
Burimi online	www.bnetd.ci	www.bnetd.ci	www.bnetd.ci	www.bnetd.ci
Lloji i datës	001	001	001	001
Abstrakti	Harta Globale Shqipëria - Kufiri është një nga shtresat e Hartës Globale të Shqipërisë.Përbëhet nga kufiri politik, vijës	Harta Globale Shqipëria - Hidrografia është një nga shtresat e Hartës Globale të Shqipërisë.	Harta Globale Shqipëria - Qendra e popullsisë është një nga shtresat e Hartës Globale të Shqipërisë.	Harta Globale Shqipëria - Rrjeti i transportit është një nga shtresat e Hartës Globale të Shqipërisë.

	kufitare politike, tipareve të zonave dhe vijave kufitare.	Përbëhet nga rrjedhjet ujore, veçoritë e ujërave të brendshme, të ndryshme dhe kanaleve.	Përbëhet nga pika e ndërtimeve dhe karakteristikat e zonave të ndërtuara	Përbëhet nga aeroporti, porti, hekurudha, karakteristikat e stacionit hekurudhor dhe rrugor.
Qëllimi	Harta Global është një bazë e të dhënave themelore kornizë e krijuar për të mbështetur aplikacionet e sistemeve të informacionit gjeografik, veçanërisht për ekzaminimin e çështjeve globale mjedisore.	Harta Global është një bazë e të dhënave themelore kornizë e krijuar për të mbështetur aplikacionet e sistemeve të informacionit gjeografik, veçanërisht për ekzaminimin e çështjeve globale mjedisore.	Harta Global është një bazë e të dhënave themelore kornizë e krijuar për të mbështetur aplikacionet e sistemeve të informacionit gjeografik, veçanërisht për ekzaminimin e çështjeve globale mjedisore.	Harta Global është një bazë e të dhënave themelore kornizë e krijuar për të mbështetur aplikacionet e sistemeve të informacionit gjeografik, veçanërisht për ekzaminimin e çështjeve globale mjedisore.
Kreditet	©ASIG	©ASIG	©ASIG	©ASIG
Kufizimi i përdorimit	Referojuni politikës së të dhënave	Referojuni politikës së të dhënave	Referojuni politikës së të dhënave	
Deklarimi	Shtresa e kufirit e Hartës Globale të Shqipërisë version 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale versionit 2.2 Burimi i të dhënave ishte një hartë dixhitale 1: 25000 dhe ortofoto, hartë topografike e bërë në 1985 dhe ortofoto e bërë në	Shtresa e hidrografisë së Hartës Globale të Shqipërisë version 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale versionit 2.2 Burimi i të dhënave ishte një hartë dixhitale 1: 25000 dhe	Shtresa e qendrave të popullsisë së Hartës Globale të Shqipërisë version 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale versionit 2.2 Burimi i të dhënave ishte një hartë dixhitale 1: 25000 dhe ortofoto, hartë	Shtresa e rrjetit të transportit të Hartës Globale të Shqipërisë version 2 u zhvillua duke u bazuar në specifikimet e Hartës Globale versionit 2.2 Burimi i të dhënave ishte një hartë dixhitale 1: 25000 dhe ortofoto, hartë

	2008.	ortofoto, hartë topografike e bërë në 1985 dhe ortofoto e bërë në 2008.	topografike e bërë në 1985 dhe ortofoto e bërë në 2008.	topografike e bërë në 1985 dhe ortofoto e bërë në 2008.
--	-------	---	---	---

6.2.6 Zhvillimi i të dhënave hapësinore në formatin raster për Republikën e Shqipërisë në Hartën Globale.

Meqenëse bota në tërësi është e ndarë në kontinente dhe vende të ndryshme prodhojnë të dhëna gjeohapësinore me standarde të njëjta ose të ndryshme, tentohet që këto të dhëna gjeohapësinore të kenë standarde të njëjta, në mënyrë që ato të mund të përdoren, të shkëmbehen për të bërë analizën e problemeve më lehtë dhe me kosto më të ulët (Lubishtani M and Idrizi B,2016).

Njëra është versioni kombëtar dhe rajonal që secili NMO pjesëmarrës është në thelb përgjegjës për zhvillimin e hartës së tyre globale.

Si burime të të dhënave në zhvillimin e të dhënave raster të Hartës Globale për Shqipërinë janë përdorur:

- Imazhe ortofoto të vitit 2012.
- Hartat ekzistuese topografike në shkallën 1: 25000, dhe
- Imazhe satelitore IRS, SPOT dhe RapidEye.

Standardet që janë përdorur në zhvillimin e të dhënave rasteriale të Hartës Globale për Shqipërinë është specifikimi i Hartës Globale; versioni2.2, nga 12.08.2012.

Sipas (Specifikimit të Hartës Globale; *versioni2.2*) qelizat e rrjetit të rasterit do të sistemohen në një sistem koordinativ horizontal në shkallë të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike të referuar në ITRF94 dhe GRS80. Ishujt e vegjël më pak se afërsisht 1 kilometër katror mund të mos përfaqësohen me qeliza. Madhësia e qelizave për të dhënat rasteriale do të jetë 30 sekonda me 30 sekonda me origjinë në pikën veriperëndimore të hapësirës që hartografohet (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Të dhënat me rezolucion më të lartë mund të zhvillohen siç janë 3 ose 15 sekonda për të mundësuar harmonizim të të dhënave me bazat ekzistuese me rezolucion hapësinor 30 sekonda.

Formati BIL (grup i ndërlidhur në rresht); një format i thjeshtë binar raster pa titullin e përfshirë përdoret si format zyrtar i shpërndarjes së të dhënave rasteriale. Ky lloj i të dhënave ruan grupin e informacionit në piksel sipas grupit për secilën linjë, ose rresht, të imazhit. Për shembull, duke pasur parasysh një imazh të një grupi siç janë ato për Hartën Globale, të dhënat shkruhen për rreshtin 1, të dhënat shkruhen për rreshtin 2, e kështu me radhë, derisa të arrihet numri i përgjithshëm i rreshtave në imazh.

Shtresat e vegjetacionit, mbulesës së tokës dhe përdorimit të tokës janë të dhëna 8-bitëshe, ndërkaq të dhënat e lartësive janë 16-bitëshe (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Një dosje e titulluar shoqëron çdo dosje rasteriale. Të dhënat ruhen në renditje të rreshtave kryesore (të gjitha të dhënat për rreshtin 1, të ndjekura nga të gjitha të dhënat për rreshtin 2 etj.

Një dosje e titulluar do të shoqërojë çdo dosje raster. Artikujt që do të përfshihen në dosjen e titulluar janë si më poshtë.

Të dhënat do të plotësojnë vlerat e paracaktuara, kur specifikohen në kllapa dhe italicized.

Biteorder	Renditja e bajtit në të cilin ruhen vlerat e pikselit të imazhit (https://desktop.arcgis.com/en/arcmap/latest/manage-data/raster-and-images/bil-bip-and-bsq-raster-files.htm). Big endian (<i>M</i>).
Layout	Organizimi i grupeve në dosje (BIL = grup i ndërlidhur në rresht) (shënim: të gjitha dosjet janë imazhe të një grupi)
NROWS	Numri i rreshtave (qelizave) në drejtimin gjatësor të imazhit
NCOLS	Numri i kolonave (qelizave) në drejtim të gjerësisë së imazhit
NBANDS	Numri i grupeve spektrale në imazh (<i>I</i>)
NBITS	Numri i bajtëve për qelizë (<i>8 për mbulesën e tokës, përdorimin e tokës dhe shtresat e vegjetacionit, dhe 16 për lartësi</i>)
BANDROWBYTES	Numri i bajtëve i të dhënave për rresht
TOTALROWBYTES	Numri total i bajtëve të të dhënave për rresht
BANDGAPBYTES	Numri i bajtëve midis grupeve në një imazh të formatit BSQ
NODATA	Vlera e përdorur për qëllime përfshirje të sipërfaqeve (Për më të larta, 9998 për lartësi, 255 për bimësi, mbulesë toke dhe përdorim të tokës. Për detin -9999 për lartësi, 0 për bimësi, mbulesë toke dhe përdorim të tokës.)
ULXMAP	Gjatësia e qendrës së qelizës të sipërm të majtë
ULYMAP	Gjerësia e qendrës së qelizës të sipërm të majtë
XDIM	Gjerësia e një qelize në drejtim të gjatësisë
YDIM	Gjerësia e një qelize në drejtim të gjerësisë

Qasja dhe e drejta e autorit:

Të dhënat rasteriale të Hartës Globale të Shqipërisë janë të hapura për të shkarkuar vetëm për përdorim jokomercial, përmes <https://iscgm.org/gmd>.

Qelizat e rrjetit të të dhënave raster në rastin e Hartës Globale të Republikës së Shqipërisë janë organizuar në rreshta dhe kolona me madhësinë e qelizave (rezolucion hapësinor) 3"x3", si rezolucion maksimal të lejuar në specifikimin teknik 2.2, me origjinë në cepin veri-perëndim të trapezit. Celulat e rrjetës raster janë vendosur në një sistem koordinativ horizontal në shkallë të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike duke u referuar në ITRF94 dhe GRS80 (Lubishtani et al, 2020). Zona e saj e përfaqësuar nga një qelizë të rrjetit katror llogaritet nga gjatësia e anës së saj e quajtur rezolucion hapësinor. Atributi i secilës celulë paraqet një karakteristikë që është mbizotëruese pranë pikës qendrore të celulës.

Karakteristikat e shtresave raster të të dhënave të Hartës Globale janë si më poshtë:

Shtresa e lartësive – përmban distancën vertikale midis sipërfaqes së tokës dhe nivelit mesatar të detit që vendi ka përcaktuar. Shtresa e lartësisë është në një format të grupit të ndërlidhur në rreshta (BIL) me vlerë lartësie 16-bit dhe ndarje horizontale të rrjetit 3". Vlerat e lartësisë përfaqësohen në metra, në të cilat kodet - 9999 janë zona të sipërfaqeve me det (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Shtresa e mbulesës së tokës - Mbulesa e tokës është mbulesa e vëzhguar (bio) fizike në sipërfaqen e tokës (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Në specifikimin e Hartës Globale kodet e karakteristikave të mbulimit të tokës së Hartës Globale V1V2 versioni kombëtar/rajonal është miratuar për Programin Ndërkombëtar të Gjeosferës-Biosferë(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Shtresa e përdorimit të tokës - Përdorimi i tokës është një seri operacionesh në tokë, të kryera nga njerëzit, me qëllim të marrjes së produkteve dhe / ose përfitimeve përmes përdorimit të burimeve të tokës(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Legjenda e shtresës së përdorimit të tokës përbëhet nga 9 klasa (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Shtresa e vegjetacionit - Për shtresën e vegjetacionit, është miratuar një legjendë e modifikuar e ujit me 20 klasa (Lubishtani et al, 2020). Për shtresën e bimësisë, është miratuar një legjendë e modifikuar e ujit me 20 klasa, siç tregohet më poshtë në tabelën 6.9 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Tabela 6.9 Llojet e të dhënave raster V1/V2 versioni kombëtar/rajonat të Hartës Globale (Idrizi, 2010)

Land Cover		Land Use		Vegetation	
Description	Code	Description	Code	Description	Code
Evergreen Needleleaf Forest	1	Forest	10	Tropical rainforest	10
Evergreen Broadleaf Forest	2	Mixture	20	Hydrotropic forest	20
Deciduous Needleleaf Forest	3	Grassland/shrub	30	Grassland in tropical or sub-tropical zone	30
Deciduous Broadleaf Forest	4	Agricultural area	40	Semi desert in tropical or sub-tropical zone	40
Mixed Forest	5	Wetland	50	Desert in tropical or sub-tropical zone	50
Closed Shrublands	6	Barren area	60	Evergreen thick-leaved forest	60
Open Shrublands	7	Built-up area	70	Evergreen broad-leaved forest	70
Woody Savannas	8	Drainage/water	80	Deciduous broad-leaved forest	80
Savannas	9	Ocean	90	Grassland in temperate zone	90
Grasslands	10			Semi-desert in temperate zone	100
Permanent Wetlands	11			Desert in temperate zone	110
Croplands	12			Northern coniferous forest	120
Urban and Built-Up	13			Tundra	130
Cropland/Natural Vegetation Mosaic	14			Water body	140
Snow and Ice	15			Ice and snow	150
Barren or Sparsely Vegetated	16			Wetland	210
Water Bodies	17			Mixed forest	220
				Mixed land	230
				Non natural	240
				Unclassified	250

Të gjitha shtresat janë identifikuar me dy shkronja, të cilat shpjegojnë emrin e shtresës (tabela 6.10).

Tabela 6.10 Identifikuesit e shtresave raster V1/V2 (version kombëtar/rajonat) në Hartën Globale

Identifikuesi	Tema
el	Lartësia
ve	Vegjetacioni
lc	Mbulesa e tokës
lu	Përdorimi i tokës

Emrat e dosjeve kanë formularin ww_XXX.ZZZ ku (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010):

- ww identifikon temën (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),

- XXX identifikon kodin e vendit i cili përcaktohet në Kodin e Kombit ISO 3166 (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010) dhe

- zzz është shtrirje që identifikon të dhënat (bil ose tiff) ose titullin (hdr) (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të dhënat e së vërtetës tokësore janë mbledhur nga Qendra për Ndjesinë në Distançë Mjedisore në (CEReS), Universiteti Chiba në bashkëpunim me Organizatat Kombëtare Hartografike (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Madhësia e celulave për të dhënat raster në versionin global është e njëjtë me versionin kombëtar / rajonal, 3" nga 3" duke qenë me origjinë të këndit veri-perëndim të trapezave (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Të dhënat e versionit global përfshijnë edhe territorin e Republikës së Shqipërisë me rezolucion hapësinor 3".

Emrat e dosjeve të versionit global të të dhënave në raster kanë një formë wwy.zzz, ku (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010):

- ww - identifikon temën (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),

- yy - identifikon numrin e dosjes (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010) dhe

- zzz - është shtrirja që identifikon të dhënat (bil) ose titullin (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

6.2.7 Zhvillimi i të dhënave raster të lartësive në të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë

Për krijimin e të dhënave për lartësitë e Shqipërisë janë përdorur imazhet satelitore shtresë rasteriale me rezolucion hapësinor 1" nga burimi SRTM – version 3 (2013) dhe nga hartat topografike në shkallë 1:25 000. Intervalet e lartësisë dhe zona e secilit interval të lartësisë është treguar më poshtë në tabelën 6.11.

Tabela 6.11 Zona e Shqipërisë ndërmjet lartësisë.

Lartësia [m]	Numërimi	Zona [km²]
0-100	730235	4778
101-200	312268	2043
201-300	180074	1178
301-400	299275	1958
401-500	282245	1847

501-600	260960	1708
601-700	248671	1627
701-800	230532	1508
801-900	266031	1741
901-1000	247577	1620
1001-1100	226168	1480
1101-1200	211187	1382
1201-1300	188625	1234
1301-1400	164729	1078
1401-1500	135296	885
1501-1600	109197	715
1601-1700	86368	565
1701-1800	68050	445
1801-1900	50835	333
1901-2000	37290	244
2001-2100	25254	165
2101-2200	16063	105
2201-2300	9075	59
2301-2400	4533	30
2401-2500	1877	12
2501-2600	570	4
2601-2700	165	1
2701-2749	16	1

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave për lartësinë e Hartës Globale për Shqipërinë, një Hartë Globale me vlera të përfshira lartësie në të gjithë territorin e Shqipërisë është marrë ashtu siç tregohet më poshtë në figurën 6.9.




Figura 6.9 Lartësia e Hartës Globale për Shqipërinë.

6.2.8 Zhvillimi i të dhënave rasteriale të mbulesës së tokës në të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë.

Për shtresën rasteriale të mbulesës së tokës i të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë është përdorur ortofoto nga viti 2012. Imazhet satelitore IRS, SPOT dhe RapidEye, mbulimi i dyfishtë, ortofotot, hartat topografike me shkallë 1:25 000 përdoren gjithashtu për të bërë mbulimin e tokës për Hartën Globale të Shqipërisë (Lubishtani et al, 2020).

Në përgjithësi, shtresat globale të mbulesës së tokës janë produkt i një bashkëpunimi midis USGS (Vëzhgimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara) dhe Universitetit të Maryland, Departamenti i Shkencave Gjeografike.

Këto shtresa hartash janë pjesë e koleksionit tonë të të dhënave themelore hartografike dixhitale në formatin raster në shkallë 1: 1.000.000. Edicioni Global Map përfshin vetëm fushat e të dhënave dhe vlerat e attributeve në versionin 2.2 të

specifikimeve të Hartës Globale. Këto të dhëna mund të shkarkohen falas (<https://www.iscgm.org/gmd/>).

Klasifikimi i të dhënave për mbulesën e tokës u bë në dy mënyra: njëra ishte klasifikimi global dhe tjetra ishte klasifikimi kombëtar / rajonal (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të dhënat e versionit global të mbulimit të tokës përmbajnë 20 klasa të mbulesës së tokës, dhe një klasë tjetër shtesë me kod 255 që përfaqësojnë zonat pa të dhëna (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Në tabelën 6.12 janë paraqitur krahasimi midis klasave të mbulimit të tokës në klasifikimin kombëtar / rajonal me 17 klasa dhe versionin global me 20 klasa (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Tabela 6.12 Krahasimi midis klasave të mbulimit të tokës versioneve globale dhe kombëtare / rajonale (Idrizi, 2010).

Land cover global version	Land cover – national and regional version
1. Broadleaf Evergreen Forest	2. Evergreen Broadleaf Forests
2. Broadleaf Deciduous Forest	4. Deciduous Broadleaf Forests
3. Needleleaf Evergreen Forest	1. Evergreen Needleleaf Forests
4. Needleleaf Deciduous Forest	3. Deciduous Needleleaf Forests
5. Mixed Forest	5. Mixed Forests
6. Tree Open	8. Woody Savannas 9. Savanna
7. Shrub	6. Closed Shrublands 7. Open Shrublands
8. Herbaceous, single layer	10. Grasslands
9. Herbaceous with Sparse and Tree/Shrub	
10. Sparse Herbaceous/Shrub	16. Barren
11. Cropland (herbaceous crops except rice)	12. Croplands
12. Rice, paddy	
13. Cropland/Natural Vegetation Mosaic	14. Cropland/Natural Vegetation Mosaics
14. Tree-Water (Brackish to Saline)	11. Permanent Wetlands
15. Wetland	
16. Bare area, consolidated (gravel, rock)	16. Barren
17. Bare area, unconsolidated (sand)	
18. Urban	13. Urban and Built-up
19. Snow/Ice	15. Snow and Ice
20. Water Bodies	17. Water Bodies

Sa i përket versionit global, të dhënat e MODIS-it të vitit 2003 me trapez 1 km (10° x 10°.) Nga Vëzhgimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (USGS) janë përdorur si të dhëna satelitore burimore për zhvillimin e mbulesës së tokës - version global (IDRIZI 1, et al 2010). Klasifikimi i të dhënave për mbulesën e tokës u bë në dy mënyra: njëra ishte klasifikim global dhe tjetra ishte klasifikimi kombëtar / rajonal

Të dhënat e versionit global të mbulimit të tokës përmbajnë 20 klasa të mbulesës së tokës, dhe një klasë tjetër shtesë me kod 255 që përfaqësojnë zonat pa të dhëna (tabela 6.5).

Një nga arsyet e krijimit të versionit global të mbulimit të tokës me 20 klasa është qëllimi për të hequr shtresën e përdorimit të tokës nga versioni tjetër

kombëtar/rajonat 2 i Hartës Globale, pasi që pothuajse rrjedh nga të dhënat e mbulimit të tokës (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të dhënat e zhvilluara rasteriale përmbajnë një atlas dixhital për të gjithë territorin e Shqipërisë në një shkallë nominale 1:1 milionë. Klasat që përfshihen për mbulesën e tokës janë: 2,3,5,6,7,8,9,10,11,13,15,16,17,18,20, 255, dhe janë paraqitur më poshtë në tabelën 6.13.

Klasat që nuk janë përfshirë për mbulesë tokësore janë: 1,4,12,14,19 (Lubishtani et al, 2020).

Tabela 6.13 Zona e Shqipërisë midis klasave të mbulimit të tokës

Vlera	Numërimi	Zona [km ²]
2	967749	6332
3	139143	910
5	65632	429
6	91671	600
7	556290	3640
8	521750	3414
9	427294	2496
10	228933	1498
11	722383	4727
13	432418	2830
15	12537	82
16	27441	180
17	32167	210
18	113523	743
20	54343	356
255	61	1

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i mbulesës së tokës në Shqipëri, përfshijnë barin, asfaltin, pemët, tokën e zhveshur, ujin, kaçubën, pemën e hapur, pyllin e përzier, pyllin gjetherënës me gjethe të gjera, pyllin me gjelbërim të përherëshëm, bimët e lashta, ligatinat, bimësinë e rrallë etj.paraqitur në figurën 6.10.




Figura 6.10 Mbulesa e tokës në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë (Lubishtani and Idrizi 2016)

6.2.9 Zhvillimi i të dhënave rasteriale të përdorimit të tokës në të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë.

Për shtresën rasteriale të përdorimit të tokës i të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë është përdorur ortofoto nga viti 2012, imazhe satelitore nga Landsat dhe Corine dhe harta topografike me shkallë 1: 25 000.

Sipas (Lubishtani, et al 2020), klasat që janë përfshirë për përdorimin e tokës janë: 10, 30, 40, 50, 60, 70, 80, 255. (tabela 6.14).

Klasat që nuk janë përfshirë për përdorimin e tokës janë: 20, 90 Sipas (Lubishtani, et al 2020).

Tabela 6.14 Zona e Shqipërisë midis klasave të përdorimit të tokës

Vlera	Numërimi	Zona [km2]
10	1264195	8272
30	1734267	11348
40	1154801	7556
50	12537	82
60	59608	390
70	113523	743
80	54343	356
255	61	1

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i përdorimit të tokës së Hartës Globale për Shqipërinë, kanë qenë të përfshira pyje, kullota, zona bujqësore, ligatina, zona shterpë, kullimi etj., paraqitur më poshtë në figurën 6.11.




Figura 6.11 Përdorimi i tokës në të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë (Lubishtani M and Idrizi B, 2016)

6.2.10 Zhvillimi i të dhënave raster të vegjetacionit në të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë.

Për shtresën rasteriale të vegjetacionit të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë është përdorur ortofoto nga viti 2012, imazhe satelitore nga Landsat dhe Corine dhe harta topografike me shkallë 1: 25 000. Përqindja nga 1 në 100 me vlera të llogaritjes dhe zonave janë paraqitur në tabelën 6.15.

Tabela 6.15 Zona e Shqipërisë midis dendësisë së mbulesës të vegjetacionit.

Vlera	Numërimi	Zona [km2]	Vlera	Numërimi	Zona [km2]
1	710	5	51	18973	124
2	1471	10	52	22143	145
3	2268	15	53	18120	119
4	964	6	54	15236	100
5	587	4	55	19454	127
6	3143	21	56	17943	117
7	2030	13	57	15282	100
8	1416	9	58	14508	95
9	3559	23	59	18467	121
10	3840	25	60	25519	167
11	2782	18	61	22452	147
12	1904	12	62	17767	116
13	1314	9	63	24617	161
14	1426	9	64	34639	227
15	2974	19	65	42349	277
16	2901	19	66	45375	297
17	2711	18	67	45926	301
18	1759	12	68	44559	292
19	1475	10	69	43663	286
20	2045	13	70	38053	249
21	3027	20	71	30884	202
22	4651	30	72	37892	248
23	7761	51	73	53247	348
24	6606	43	74	50257	329
25	6999	46	75	53798	352
26	5057	33	76	47448	310

27	3012	20	77	47513	311
28	2317	15	78	34341	225
29	2635	17	79	31759	208
30	3209	21	80	47174	309
31	3851	25	81	54030	354
32	4571	30	82	45190	296
33	5995	39	83	38140	250
34	4988	33	84	38006	249
35	6234	41	85	35801	234
36	8731	57	86	29234	191
37	11475	75	87	32376	212
38	10125	66	88	32163	210
39	9156	60	89	28933	189
40	9143	60	90	34453	225
41	9373	61	91	53468	350
42	11509	75	92	47557	311
43	14314	94	93	40501	265
44	14078	92	94	31879	209
45	10292	67	95	19630	128
46	8254	54	96	17510	115
47	10925	71	97	22347	146
48	12504	82	98	24926	163
49	15347	100	99	14493	95
50	18690	122	100	1976	13

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i vegjetacionit të Hartës Globale për Shqipërinë, është përfshirë dendësia e mbulesës së pemëve, paraqitur në figurën 6.12.




Figura 6.12 Vegetacioni i Hartës Globale për Shqipërinë

Sa i përket versionit global, shtresa e vegetacionit (përqindja e mbulesës së pemëve) të versionit global është zhvilluar duke përdorur të dhënat e MODIS-it të vitit 2003, që janë përdorur për vlerësimin global të të dhënave për përqindjen e mbulesës së pemëve (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Metoda e pemës u aplikua për vlerësimin e përqindjes së mbulesës së pemëve.

Të dhënat brenda kësaj shtrese përmbajnë një vlerë të plotë nga 0 në 100 që përshkruan përqindjen e mbulimit me pemë. Qelizat me vlerën 254 paraqesin zonat e maskuara si trup ujor, dhe celulat me vlerë 255 paraqesin zonat pa të dhëna.

Të dhënat për përqindjen e mbulesës së pemëve mund të përdoren në mënyrë efektive për të analizuar pyjet dhe "pemët e hapura" gjatë procesit të klasifikimit të mbulesës së tokës (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

6.2.11 Përgatitja e metadatave e të dhënave raster të Hartës Globale të Shqipërisë.

Një dosje të metadatave të të dhënave të Hartës Globale shoqëron secilën shtresë të të dhënave të vendosura veçmas, si dosje XML me utf8, të emërtuar sipas temës përkatëse dhe kanë shtrirjen "*" .met" në formën: `www_xxx.zzz` ku(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010):

- `www` - identifikon shkurtimin(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- `xxx` - identifikon vendin bazuar në Kodin e Kombit ISO 3166(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010) dhe
- `zzz` - është zgjatja "met"(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

6.3 Elementet matematikore të Hartës Globale të Shqipërisë.

Sipas (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010), sistemi i koordinatave të referencës i Hartës Globale të Shqipërisë është ITRF94, ku gjatësia dhe gjerësia gjeografike përcaktohen në Ellipsoid GRS80, të ruajtura në shkallë decimale në minimumin e tre decimaleve(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë janë në përdorim të sistemit të emërtimit të trapezëve GEOREF, i cili nuk lejon mbivendosje ose zbrazëtira midis trapezëve, me referencë në skajin jugperëndimor(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010). Përdor dy palë shkronja. Pala e parë e shkronjave paraqet ndarjen më të përgjithësuar - standarde 15 ° me 15 ° GEOREF dhe përfaqëson palën e parë të nomenklaturës që identifikon emrin e trapezëve. Pala e dytë e shkronjave paraqet ndarjen standarde 1 ° me 1 ° GEOREF dhe paraqet palën e dytë të nomenklaturës së emrit të trapezëve (International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Në anën tjetër, sistemi i trapezëve të versionit global V1 të Hartës Globale përdor sistemin ndarës prej 30 ° x 30 ° duke filluar nga ekuatori dhe meridiani i Greenwich-it(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

6.4 Shkarkimi dhe e drejta e autorit për përdorimin e të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Shkarkimi i të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë është në dispozicion për përdorim jokomercial, përmes internetit dhe falas, për të gjithë përdoruesit e regjistruar. Të dhënat e Hartës Globale mund të shkarkohen përmes faqes së internetit www.iscgm.org si:

- të gjithë versionin kombëtar dhe rajonal në formatet VPF dhe BIL(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- të gjithë versionin kombëtar dhe rajonal në formatet SHAPE dhe TIFF(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- të dhëna për mbulimin e tokës të versionit global në formatin BIL(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010),
- të dhëna për përqindjen e mbulimit të pemëve të versionit global në formatin BIL(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010) dhe
- vetëm një shtresë e zgjedhur e versionit kombëtar dhe rajonal në formatin VPF ose BIL(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Këto të dhëna në thelb janë vetëm për përdorim jokomercial! Nëse dikush synon të përdorë të dhënat e Hartës Globale të Shqipërisë për qëllime komerciale, është e nevojshme të merret leje nga institucioni përgjegjës i vendit, pikërisht nga ASIG-u. Çdo përdorim i paautorizuar i këtyre të dhënave për çfarëdo qëllimi të biznesit është në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e autorit dhe ndalohet rreptësisht.

6.5 Rezultatet kryesore të të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë

Të dhënat e Hartës Globale për Shqipërinë përmbajnë si më poshtë:

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave të lartësive në Hartën Globale për Shqipërinë, janë përfshirë vlerat e lartësive për gjithë territorin e Shqipërisë.

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura të mbulesës së tokës në Shqipëri, përfshijnë: bar, asfalt, pemë, tokë të zhveshur, ujë, kaçubë, pemë të hapur, pyll të përzier, pyll gjethegjërë, pyje me gjelbërim të gjelbërta dhe pa gjelbërim, bimë të lashta, ligatina, bimësi të rrallë.

Bazuar në rezultatet e nxjerra nga analizat dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura të përdorimit të tokës në Shqipëri, përfshijnë: pyje, kullota, zona bujqësore, ligatina, zona shterpë, kullime.

Bazuar në rezultatet e marra nga analizat dhe përpunimi në të dhënat e bimësisë së Hartës Globale për Shqipërinë është përfshirë densiteti i mbulesës së pemëve.

Rezultatet dhe përfitimet kryesore të të dhënave të zhvilluara të Hartës Globale të Shqipërisë në formatin vektor dhe raster mund të përmbliken si më poshtë:

- Përfshirja e NMO-së Shqiptare (ASIG-ut) në projektin e Hartografisë Globale,
- Zhvillimin dhe publikimin e të dhënave të Hartës Globale për Shqipërinë, dhe
- Inkuadrimi i të dhënave shqiptare në bazën e të dhënave të Seksionit të Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara (UNGIS)

7 Seksioni për informacione Gjeohapësinore i Kombeve të Bashkuara

Në fillim të vitit 2014, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara bëri thirrje për një revolucion të të dhënave në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe kjo thirrje u bë duke pasur parasysh agjendën e zhvillimit pas vitit 2015 dhe në pritje që në rrjedhën e qëndrueshme e të dhënave me cilësi të lartë, me kohë, autoritare dhe të arritshme do të jetë e nevojshme për matjen e vazhdueshme të progresit drejt qëllimeve dhe synimeve të reja në nivel kombëtar dhe në atë global (Greg Scott and Abbas Rajabifard, 2016).

Argumentet që kanë të bëjnë me informacionet hapësinore përfshijnë (UN-GGIM 2016a):

- Përmirësimi real i të dhënave ndodh kur përmbushen kërkesat dhe mbështetja e politikave;
- Përkundër përmirësimit, të dhënat kritike për hartimin e politikave të zhvillimit ende mungojnë;
- Të dhënat në kohë reale janë të nevojshme për të dhënë vendime më të mira dhe më shpejtë;
- Të dhënat gjeohapësinore mund të mbështesin monitorimin në shumë aspekte të zhvillimit, nga kujdesi shëndetësor deri te menaxhimi i burimeve natyrore;
- Teknologjia e re po ndryshon mënyrën e mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave;
- Standardet globale dhe një sistem i integruar i statistikave janë elementet kryesore për monitorimin efektiv; dhe
- Të dhënat duhet të jenë të hapura, lehtësisht të arritshme dhe efektive për vendimmarrjen e zhvillimit.

Për të realizuar potencialin e plotë të këtyre burimeve të të dhënave, është rënë dakord që të dhënat duhet të jenë të arritshme, ndërvepruese dhe të standardizuara.

(Greg Scott & Abbas Rajabifard,2017) deklaroi se roli i infrastrukturave kombëtare të të dhënave hapësinore do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Tani është e njohur që këto të dhëna nuk janë më vetëm për hartografim dhe shpërndarje, por për integrim, analizë, modelim dhe grumbullim - të afta për të siguruar vendimmarrje më të informuar.

Në figurën 7.1 janë paraqitur rezultatet kryesore globale dhe progresi i raportimit përmes indikatorëve, etiketave dhe qëllimeve.




Figura 7.1 Rezultatet globale dhe progresi i raportimit përmes indikatorëve, synimeve dhe qëllimeve; dhe fushat kryesore të inputeve të të dhënave kombëtare drejt prodhimit të kornizës globale të indikatorëve.(Greg Scott & Abbas Rajabifard,2017)

Një agjendë e re zhvillimi pas vitit 2015 është duke u themeluar nga Kombet e Bashkuara, duke përfshirë 17 **Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs)** dhe 169 objektiva të lidhura. SDG-të do të miratohen dhe publikohen nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shtator të vitit 2015, dhe do të kornizojnë agjendën globale të zhvillimit deri në vitin 2030 (Greg Scott and Abbas Rajabifard, 2016). Në mënyrë që qëllimet dhe synimet të zbatohen dhe të jenë të arritshme, forcimi i prodhimit të të dhënave dhe përdorimi i të dhënave më të mira në krijimin e politikave dhe monitorimin janë konsideruar si kritike (Greg Scott & Abbas Rajabifard,2017).

Më 1 janar 2016 bota filloi zyrtarisht zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, dhe raporti inaugurues “Raporti i SDGs 2016” (Kombet e Bashkuara 2016c) u botua në korrik 2016 në Forumin Politik të Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm nga Sekretari i Përgjithshëm.

(Greg Scott & Abbas Rajabifard,2017) shpjegoi që pritshmëritë e Agjendës së vitit 2030 është që deri në vitin 2020 të rritet ndjeshëm disponueshmëria e të dhënave kombëtare me cilësi të lartë, në kohë dhe të besueshme, të cilat ndahen nga një numër karakteristikash, duke përfshirë informacionet gjeohapësinore.

Në raportin e (Komitetit të Kombeve të Bashkuara të Ekspertëve për Menaxhimin Global të Informacionit Gjeohapësinor, 2015) theksohet se aplikimi i përhapur dhe efektiv i standardeve në shumë fusha të informacionit dixhital është thelbësor jo vetëm për përdorimin e vazhdueshëm efektiv të produkteve dhe shërbimeve të bazuara në internet, por edhe bashkëpunimet midis organizatave të ndryshme të të dhënave. Ekzistojnë një numër i organizatave, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e standardeve për përdorim në marrjen, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor.

Standardet duhet të zhvillohen dhe adaptohen në nivel kombëtar ose rajonal të një vendi; dështimi për ta bërë këtë mund të çojë në pamundësinë e përdorimit të të

dhënave nga burime të shumta për vendime të veçanta dhe të parandalojë që të dhënat të përdoren në mënyrë të operueshme në mënyrë rajonale ose globale.

7.1. Struktura organizative e të dhënave të Seksionit për Informacione Gjeohapësinore i Kombeve të Bashkuara

Informacioni gjeografik, i njohur ndryshe si të dhëna gjeohapësinore, gjeodata, ose gjeoinformacion është jetik për ekzekutimin e shumë aktiviteteve të Kombeve të Bashkuara.

Historikisht, prodhimi dhe përdorimi i të dhënave gjeohapësinore është realizuar brenda Kombeve të Bashkuara nga organizatat përbërëse të tij, në përputhje me nevojat dhe ekspertizën e tyre individuale.

Një nga grupet më të rëndësishme në lidhje me informacionin gjeografik në KB është **Grupi i Punës i Kombeve të Bashkuara për Informimin Gjeografik (UN-GIWG)** themeluar në mars 2000.

Infrastruktura e të dhënave hapësinore siguron një bazë institucionale dhe teknike të politikave, standardeve dhe procedurave ndërvepruese që lejojnë organizatat dhe teknologjitë të bashkëveprojnë në një mënyrë që lehtëson zbulimin, vlerësimin dhe aplikimet e të dhënave hapësinore (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Në thelb të saj, UNSDI duhet të kontribuojë në mënyrë thelbësore në misionin e Kombeve të Bashkuara dhe realizimin e qëllimeve të zhvillimit të mijëvjeçarit të KB-së

Një SDI gjithashtu lehtëson shumë përdorimin dhe potencialin për ripërdorimin e të dhënave gjeohapësinore, subjekt i politikave mbizotëruese të të dhënave.

Influence of Standards on Data Exchange




Figura 7.2 Skematika e ndikimit të mundshëm të zbatimit të SDI-së dhe standardeve të të dhënave të shoqëruara në aksesin e të dhënave hapësinore në nivele dhe shkallë të shumëfishta (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Komuniteti Global i Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore (GSDI) është duke u përpjekur në përgjithësi të zhvillojë një infrastrukturë globale të të dhënave hapësinore të mbështetur nga standarde, udhëzime dhe politika ndërkombëtare për të përmirësuar menaxhimin dhe aksesin e të dhënave, duke mbështetur rritjen ekonomike globale, dhe objektivat që lidhen me shoqërinë dhe mjedisin (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Sipas (Infrastrukturës së të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara 2007) një UNSDI do të ndikohet thellësisht nga zhvillimet bashkëpunuese që po ndodhin në GSDI. Qeveria e Japonisë kryeson këtë iniciativë dhe Instituti Gjeografik Gjeodezik (GSI) i Japonisë ka punuar si sekretari e Komitetit Drejtues Ndërkombëtar për Hartografinë Globale (ISCGM, <http://www.iscgm.org/>) që nga fillimi i saj më 1996 (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Në njohje të kontributit të mundshëm të ISCGM-s në KB, Drejtori i Divizionit të Statistikave inkurajoi zyrtarisht Organizatat Kombëtare Hartografike në vitin 1998 për të marrë pjesë në projektin e Hartës Globale, dhe në shkurt 2005 ISCGM-së iu dha statusi konsultativ Roster nga (ECOSOC) i Kombeve të Bashkuara (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Projekti i Hartës Globale do të rezultojë në disponueshmërinë e një të dhëne të rëndësishme kornizë të informacionit dixhital hartografik që përputhet me hartografinë ndërkombëtare dhe standardet e të dhënave që mbështesin shpërndarjen dhe përdorimin e saj të gjerë në të ardhmen.

Pra, të dhënat e hartave globale të zhvilluara të KB duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, ISO (Organizata Ndërkombëtare për

Standardizim) është zhvilluesi më i madh i standardeve në botë(International Conference on Spatial Data Infrastructures 2010).

Edhe pse veprimtaria kryesore e ISO-s është zhvillimi i standardeve teknike, standardet ISO gjithashtu kanë pasoja të rëndësishme ekonomike dhe sociale (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Elementet përkatëse të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, agjencie, fondeve dhe programeve njohin kërkesën thelbësore për të miratuar ose zvuilluara standarde të pranuar gjerësisht (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007), të cilat përshkruajnë të dhëna gjeohapësinore, metadata dhe përbërës të tjerë të një SDI (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

ISO, në bashkëpunimin me anëtarët e komunitetit gjeohapësinor të KB në të kaluarën për të ndihmuar në arritjen e këtyre qëllimeve, ka dhe do të vazhdojë të jetë, një partner i rëndësishëm në zhvillimin dhe rafinimin e një UNSDI të ardhshëm (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Nga ana tjetër, komuniteti me burim të hapur GIS vitet e fundit ka pasur gjithnjë e më shumë një ndikim të madh në zhvillimin teknik të infrastrukturave të të dhënave hapësinore në të gjithë globin.

Në një nivel strategjik, OGC synon të:

- Sigurojë standarde të lira dhe të hapura në treg, vlera të prekshme për anëtarët e tij dhe përfitime të matshme për përdoruesit (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).
- Avancimin e standardeve në mbështetje të formimit të tregjeve dhe aplikacioneve të reja dhe inovative për teknologjitë gjeohapësinore (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).
- Përshpejton asimilimin e tregut të hulumtimit të ndërveprimit përmes proceseve bashkëpunuese të konsorciumit (Infrastruktura e të Dhënave Hapësinore të Kombeve të Bashkuara, 2007).

Është identifikuar një nevojë për të forcuar kapacitetin kombëtar dhe për të përmirësuar disponueshmërinë globale të të dhënave zyrtare, të besuara, të ruajtura, përfundimtare të hartave dhe koordinimit dhe shpërndarjes së saj të përshtatshme.

UNGEEN (Grupi i Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për Emrat Gjeografikë) — jep rekomandime teknike për standardizimin e emërtimeve gjeografike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithashtu përfshihet në divizionin e statistikave të KB-së (United Nations Committee of experts on Global Geospatial Information management, 2016).

Disa fusha të punës të GGIM-të KB-së janë:

1. Zhvillimi i kornizës globale të referencës gjeodezike (Idrizi et al, 2011),
2. Zhvillimi i një harte globale për zhvillimin e qëndrueshëm (Idrizi et al, 2011),

3. Miratimin dhe zbatimin e standardeve nga komuniteti global i informacionit gjeohapësinor (Rajabifard, 2020),
4. Kornizën ligjore dhe të politikave, përfshirë çështjet kritike që lidhen me të dhënat zyrtare (Rajabifard, 2020),
5. Zhvillimin e deklaratave të përbashkëta të parimeve për menaxhimin e informacionit gjeohapësinor (Rajabifard, 2020),
6. Përcaktimin e grupeve themelore të të dhënave (Rajabifard, 2020).

Synimi i GGIM-së së KB-së të Evropës është që të ndërtojë kornizat ekzistuese në Evropë duke:

- shmangur përpjekjet për dublikim;
- përmiresuar përgjigjet e përbashkëta ndaj nevojave dhe kërkesave të përdoruesit;
- inkurajuar ndërveprimin e të dhënave gjeohapësinore, harmonizimin dhe ndarjen;
- optimizuar menaxhimin e përgjithshëm të informacionit gjeohapësinor në Evropë.

Ndërveprueshmëria dhe standardizimi në informacionin gjeografik janë elementë thelbësorë për zhvillimin e informacionit global gjeohapësinor (Rajabifard, 2020). Qasja dhe ripërdorimi i një informacioni të tillë mund të shpejtojë krijimin e informacionit global gjeohapësinor.

7.2 Migrimi i të dhënave nga GM në UNGIS dhe Shqipëria në UNGIS

Kombet e Bashkuara kanë prodhuar dhe përdorur harta që nga viti 1945 për të mbështetur nevojat e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara. Gjatë shtatë dekadave të kaluara, nevoja për harta ka vazhduar, por meqë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit janë zhvilluar, zyra e mbështetjes së informacionit gjeohapësinor është zgjeruar në zyrë duke aplikuar sistemet e informacionit gjeografik, sisteme ajrore me sensorë të largët dhe pa pilot për të ofruar mbështetje provuese dhe zgjidhje për vendimmarrësit (Ayako Kagawa, Guillaume Le Sourd, 2017). Me zhvillimin e teknologjive përfshirë internetin, telekomandimin, sistemet ajrore pa pilot (**Ayako Kagawa and Guillaume Le Sourd, 2018**), menaxhimin e marrëdhënieve të bazës së të dhënave dhe sistemet e informacionit, informacioni gjeohapësinor ofron një mundësi gjithnjë e në rritje për të mbështetur punën e organizatës për planifikimin e operacioneve, vendimmarrjen dhe monitorimin e krizave.

Kjo nevojë urgjente u përforcua në seancën e saj të pestë në 2015, ku Komiteti miratoi vendimin 5/103, duke theksuar se ekziston "një nevojë urgjente për një **grup temash globale themelore të të dhënave gjeohapësinore** që mund të harmonizohen

në mënyrë që të mundësojnë matjen, monitorimin dhe menaxhimin e zhvillimit të qëndrueshëm në një mënyrë të qëndrueshme me kalimin e kohës dhe për të lehtësuar vendimmarrjen dhe hartimin e politikave të bazuara në prova ”.



Ceremony of GM data transfer to UNGIS





Ceremony of GM data transfer to UNGIS







Figura 7.3 Ceromonia e nënshkrimit të dokumentit për transferim të të dhënave nga Harta Globale në UNGIS (SASAGAWA et al 2017).

Tani, në vitin 2019, 14 temat globale themelore të të dhënave gjeohapësinore janë një themel për të mbështetur menaxhimin global të informacionit gjeohapësinor (Rajabifard, 2020), veçanërisht i përdorur për të mbështetur kornizën e integruar të informacionit gjeohapësinor, ndër nismat e tjera globale për forcimin e informacionit gjeohapësinor. Temat globale e të dhënave gjeohapësinore janë paraqitur në më poshtë tabelën 7.1:

Tabela 7.1 Temat Globale e të dhënave gjeohapësinore

Nr	Logo	Tema	Përshkrim i shkurtër
1		Korniza e referencës Korniza Globale e Referencës Geodezike (GCRF)	Korniza Globale e Referencës Gjeodezike është korniza e cila lejon përdoruesit të përcaktojnë dhe të shprehin saktësisht lokacionin në Tokë, si dhe për t'u matur ndryshimet e Tokës në hapësirë dhe kohë. Nuk është një temë e të dhënave në kuptimin e temave të tjera, por është parakusht për mbledhjen e saktë, integrimin dhe përdorimin e të gjitha të dhënave të tjera gjeohapësinore.
2		Adresat	Një adresë është një etiketë e strukturuar, që zakonisht përmban një numër prone, një rrugë dhe një lokalitet. Përdoret për të identifikuar një truall, një ndërtesë ose pjesë të një ndërtese, ose ndonjë ndërtim tjetër, së bashku me koordinatat që tregojnë pozicionin e tyre gjeografik. Adresat shpesh përdoren si zëvendësues i të dhënave të

			tjera si numri i parcelës.
3		Ndërtesat dhe vendbanimet	Një ndërtesë i referohet çdo strukturë të mbuluar të ndërtuar ose ngritur në mënyrë të përhershme në anën e saj, ose mbrojtjes së njerëzve, kafshëve, gjërave, ose prodhimin e mallrave ekonomike. Vendbanimet janë koleksione të ndërtesave dhe tipareve shoqëruese ku një komunitet kryen veprimtari socio-ekonomike.
4		Lartësia dhe thellësia	Tema e Lartësisë dhe Thellësisë përshkruan sipërfaqen e Tokës si në tokë ashtu dhe nën një trup uji, në lidhje me një të dhënë vertikale.
5		Zonat funksionale	Zonat funksionale janë shtrirja gjeografike e fushave administrative, legislative, rregullatore, zgjedhore, statistikore, qeverisjes, ofrimit të shërbimeve dhe menaxhimit të aktiviteteve (Korniza Globale e Statistikave Gjeohapësinore, 2019).
6		Emërtimet gjeografike	Emërtimet gjeografikë ofrojnë orientim dhe identitet në vendet. Ata janë identifikues të vendndodhjes për tipare kulturore dhe fizike të botës reale, të tilla si rajone, vendbanime, ose ndonjë tipar i interesit publik ose historik. Ata shpesh përdoren si një përfaqësues për temat e tjera të të dhënave siç janë ndërtesat dhe vendbanimet.
7		Gjeologjia dhe dherërat	Gjeologjia është përbërja dhe vetitë e materialeve gjeologjike (shkëmbinj dhe sedimente) nëntokësore dhe dalje në sipërfaqen e Tokës. Ajo përfshin shtratin, akuiferët, gjeomorfologjinë për mjediset tokësore dhe detare, burimet minerale dhe dherat mbingarkuese.
8		Mbulesa e tokës dhe Përdorimi i tokës	Mbulesa e Tokës përfaqëson mbulesën fizike dhe biologjike të sipërfaqes së Tokës. Përdorimi i tokës është menaxhimi i planifikuar aktual dhe i ardhshëm, dhe modifikimi i mjedisit natyror për qëllime të ndryshme njerëzore ose aktivitete ekonomike.

9		Parcelat e tokës	Parcelat e tokës janë zona të tokës ose më përgjithësisht të sipërfaqes së Tokës (tokës dhe / ose ujit) nën të drejtat e përbashkëta (siç janë pronësia ose lehtësimet), pretendimet (siç janë mineralet ose toka indigjene) ose përdorimi (Korniza Globale e Statistikave Gjeohapësinore, 2019). Kjo temë mund të përfshijë fusha individuale dhe parcela kadastrale.
10		Ortoimazhet	Ortoimazhet janë të dhëna të imazheve të gjeoreferencuara të sipërfaqes së Tokës, të marra nga sensorë satelitorë ose të ajrit.
11		Infrastrukturat fizike	Tema e Infrastrukturës fizike përfshin objektet industriale dhe të shërbimeve, si dhe lehtësitë e ofrimit të shërbimeve të lidhura me shërbime qeveritare administrative dhe sociale, siç janë administratat publike, shërbimet komunale, transporti, mbrojtja civile, shkolla dhe spitale.
12		Shpërndarja e popullsisë	Tema e Shpërndarjes së popullsisë përfshin shpërndarjen gjeografike të njerëzve, përfshirë karakteristikat e popullsisë.
13		Rrjetet e transportues	Rrjetet e transportit janë grupi i rrugëve, hekurudhave, ajrore, kablllove dhe rrugëve të transportit ujor dhe lidhjes së tyre.
14		Ujërat	Tema e Ujit përfshin shtrirjen dhe kushtet e të gjitha tipareve të ujit, përfshirë lumenjtë, liqenet dhe karakteristikat detare.

Siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, janë përmbledhur 14 tema të të dhënave. Në anën tjetër, të dhënat e Hartës Globale përbëhen nga gjithsej 8 shtresa, përkatësisht 4 vektorë dhe 4 shtresa rasteri. Nga të dhënat e vektorit të GM-së, shtresa e qendrave të popullsisë me informacione thelbësore është përfshirë në informacionin në temën e 12-të të të dhënave (Shpërndarja e popullsisë), shtresa e hidrografisë në temën e 14-të të të dhënave (Uji), shtresa rrjeti i komunikacionit në temën e 13-të të të

dhënave (Transporti) dhe shtresa e kufijve politikë nuk përfshihen në një temë të veçantë të të dhënave, por disa informacione të kësaj shtrese mund të përfshihen në temën e 12-të të të dhënave (Shpërndarja e popullsisë). Nga të dhënat e rasteve të GM-së, shtresa DEM e të dhënave të GM-së është e përfshirë me temën e 4-të të të dhënave (Lartësia dhe thellësia) dhe të dhënat tjera të rasterit të GM-së në lidhje me mbulesën e Tokës, përdorimin e tokës dhe vegjetacionin janë të përfshira me informacione në temën e të dhënave 8-të.

Është një burim thelbësor informacioni kombëtar me vlerë të provuar shoqërore, ekonomike dhe mjedisore që mundëson sistemet dhe shërbimet qeveritare dhe nismat kombëtare të zhvillimit, të integrohen duke përdorur "vendndodhjen" si një kornizë e zakonshme dhe themelore e referimit.

Informacioni gjeohapësinor përshkruan vendndodhjen fizike të veçorive gjeografike dhe lidhjen e tyre me veçoritë tjera dhe informacionin statistikor shoqëruar.

Informacioni gjeohapësinor është mbledhur në mënyrë tipike në silosat organizative; duke rezultuar në dublikim të të dhënave dhe përdorimin e standardeve, formateve dhe klasifikimeve të ndryshme. Kjo e ka bërë problematike harmonizimin, mirëmbajtjen dhe integrimin e të dhënave.

Korniza e Integruar e Informacionit Gjeohapësinor I GGI-së së KB-së është e ancoruar nga nëntë (9) rrugë strategjike në tre (3) fusha kryesore të ndikimit: qeverisje; teknologji dhe njerëz (Rajabifard, 2020).




Figura 7.4 Korniza e Integruar Gjeohapësinore është e ancoruar nga nëntë rrugë strategjike dhe tri fusha kryesore të ndikimit (Rajabifard, 2020).

Përfitimet kryesore të zhvillimit të Kornizës së Integruar Gjeohapësinore (Korniza e Integruar e Informacionit Gjeohapësinor, 2015) janë :

- Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit, veçanërisht i burimeve ujore dhe liqeneve, pylltarisë, zonave bregdetare, parqeve kombëtare dhe parashikimi i rendimentit të të korrave, mbështetet nga informacioni gjeohapësinor (Integrated Geospatial Information Framework, 2018).
- Informacioni gjeohapësinor sjell matje më të mirë të situatës aktuale, monitorimin e ndryshimit, zbutjen e planifikimit, vendimmarrjen e bazuar në prova, dhe pastaj ofrimin e projekteve zbutëse (Korniza e Integruar e Informacionit Gjeohapësinor, 2015).

Për të shfrytëzuar në mënyrë efektive vlerën e informacionit gjeohapësinor, informacioni duhet të jetë i lehtë për t'u hyrë dhe përdorur. Duke pasur parasysh se informacioni gjeohapësinor vjen nga shumë burime të ndryshme, dhe menaxhohet nga një numër shumë i madh i ofruesve të ndryshëm - nga agjensitë hartografike deri tek ofruesit e të dhënave biznesore deri te informacioni gjeografik vullnetar - ekziston një kërkesë e madhe për të zbuluar dhe shpërndarë me lehtësi këtë informacion.

Nga shtatori 2016, bazuar në letrën e aprovimit nga ASIG-u, grupi i të dhënave të GM-së të Shqipërisë është integruar në Seksionin e Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara (UNGIS), bazuar në vendimin për transferimin e të dhënave të GM-së në bazën e të dhënave të UNGIS-it, që është zyrtarizuar në gusht të vitit 2016, në New York, gjatë takimit përfundimtar (23-të) të ISCGM-së (Lubishtani M and Idrizi B.,2016).

Harta Globale siguron një kontribut konkret dhe të vazhdueshëm, por rruga përpara qëndron në një bashkëpunim më të madh institucional midis organizatave të ndryshme të përfshira në shkencat gjeohapësinore dhe përpjekjet e rritura teknike për të bërë të dhëna të ndryshme gjeohapësinore të shërbimeve për zvogëlimin dhe menaxhimin e katastrofave shumë më të ndërveprueshme (Taylor 2010).

Gjatë periudhës 20-vjeçare aktive të ISCGM-së, mjedisi gjeohapësinor si dhe Projekti po ndryshonin pak nga pak, siç përshkruhet në (Sasagawa et al, 2017).

- Në kohën kur u krijua ISCGM-ja në mesin e viteve 1990, hartografia dixhitale nuk po përdorej gjerësisht në të gjithë botën (Sasagawa et al, 2017). Sidoqoftë, që atëherë është bërë e zakonshme.
- Me rritjen e internetit, llojet e ndryshme të informacionit të hapur gjeohapësinor tani janë të disponueshme lirshëm dhe shumë njerëz mund t'i përdorin ato lehtësisht.
- Në vitin 2011, UNCE-GGIM u krijua nën Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara për të luajtur një rol kryesor në caktimin e rendit të ditës për zhvillimin e informacionit global gjeohapësinor dhe për të promovuar përdorimin e tij për të adresuar sfidat kryesore globale (Sasagawa et al, 2017). Si rezultat i secilës NGIA u pajis me një vend tjetër, përveç ISCGM-së, për të diskutuar tema të ndryshme që lidhen me informacionin gjeohapësinor (Sasagawa et al, 2017).
- Që nga shkurti i vitit 2017, numri i vendeve pjesëmarrëse dhe rajoneve në Projekt ishte 184 (Sasagawa et al, 2017). Gjithashtu, numri i vendeve dhe

rajoneve që publikuan të dhëna për Hartën Globale ishte 122 (Sasagawa et al, 2017).

- ISCGM-ja dhe organizatat përkatëse kanë realizuar shumë programe për ndërtimin e kapaciteteve dhe kanë siguruar mjete të ndryshme për zhvillimin e të dhënave të Hartës Globale për vendet pjesëmarrëse dhe rajoneve (Sasagawa et al, 2017). Si rezultat i këtyre aktiviteteve, shumë vende në zhvillim ishin në gjendje të zhvillojnë dhe publikojnë të dhënat e tyre për Hartën Globale.

Në vitin 2016, të gjithë anëtarët e ISCGM-së, si dhe vendet dhe rajonet pjesëmarrëse të projektit, mund të ndajnë vëzhgimet e tyre për ndryshimet mjedisore në informacionin gjeohapësinor, duke pranuar se objektivat e projektit ishin arritur kryesisht (Sasagawa et al, 2017). Prandaj, si përfundim, kryetari i ISCGM, profesori Cheung, propozoi transferimin e të dhënave të Hartës Globale në Kombet e Bashkuara për të dhënë kontribute të HG-së në punën e mëtejshme të KB-së (Sasagawa et al, 2017).

Implementimi i transferimit të të dhënave të Hartës Global në UNGIS duhej të bëhej sipas hapave të skemës së mëposhtme (Nagayama Toru, 2016) :

Hapi 1. Rezoluta e takimit të 23-të të ISCGM-së (i referohet përfundimit të Planit të transferimit të Hartës Globale)

Hapi 2. Plani i transferimit të Hartës Globale (nga ISCGM): i referohet marrëveshjes për një afat të detajuar të përdorimit.

Hapi 3. Marrëveshja midis ISCGM-së dhe UNGIS-it

- Në thelb nuk ka kufizim në operacionet e KB-së (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016);

- Nuk ka atribut në produktet që rrjedhin nga ose përdorin të dhëna të Hartës Globale (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016).

- Të dhënat e Hartës Globale nuk mund të lëshohen jashtë kontrollit fizik të personelit të KB-së.

- UNGIS-i mund të pasurojë bazat e të dhënave të saj me të dhënat e Hartës Globale ose të bashkojë të dhënat e Hartës Globale me bazat e të dhënave të veta (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016).

Në mbledhjen e fundit të 23-të u vendos gjithashtu, që Sekretariati i ISCGM-së të funksionojë deri në mars 2017 për kryerjen e Planit të transferimit të Hartës Globale.

a) Përditësimin e faqes në internet përveç çështjeve që lidhen me raportin e takimit të 23-të.

b) Administrimin e punëve që lidhen me pjesëmarrjen në Projekt, zhvillimin dhe përditësimin e të dhënave të Hartës Globale, etj.

Plani i transferimit parashikon si më poshtë (Nagayama Toru, 2016):

1. Sekretariati i ISCGM-së i dërgon të dhënat e Hartës Globale tek UNGIS në emër të organizatës.
2. Të dhënat e Hartës Globale mund të përdoren brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara pa ndonjë kufizim, përfshirë edhe atriboimin e detyrueshëm (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016).

Ky plan zbatohet sipas marrëveshjes nga organizatat pjesëmarrëse përkatëse. Përndryshe, të dhënat e Hartës Globale të organizatës mbeten të vetat.

Sipas (Nagayama Toru, 2016) me marrëveshjen midis ISCGM-së dhe UNGIS-it sigurohet si vijon:

1. Komiteti Drejtues Ndërkombëtar për Hartografinë Globale (ISCGM), që përfaqëson të gjithë anëtarët e tij pjesëmarrës, siguron një kopje të të dhënave të Hartës Globale të tij për Seksionin e Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara (UNGIS), falas, dhe autorizon përgjithmonë përdorimin e tij në mbështetje të operacioneve të Kombeve të Bashkuara pa asnjë kufizim përveç atyre të renditura më poshtë.
2. Shefi i Seksionit të Informacionit Gjeohapësinor, Departamenti i Mbështetjes në Fushë, Kombet e Bashkuara (UNGIS) do të veprojë si depo qendrore dhe pikë shpërndarëse për të gjitha të dhënat e Hartës Globale për përdorimin e tij në mbështetje të operacioneve të Kombeve të Bashkuara dhe do të sigurojë që përdoruesit të jenë plotësisht të vetëdijshëm për shpërndarjen, trajtimin dhe gjendjen e përdorimit të të dhënave të Hartës Globale.
3. Të dhënat e Hartës Globale do të përdoren vetëm për qëllimin zyrtar të mbështetjes së operacioneve të

Kombeve të Bashkuara. Çdo përdorim tjetër përtej qëllimit të këtij qëllimi zyrtar nuk është i autorizuar (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016).

4. Të dhënat e Hartës Globale nuk mund të lëshohen jashtë kontrollit fizik të personelit të Kombeve të Bashkuara të përfshira drejtpërdrejt në mbështetjen e operacioneve të Kombeve të Bashkuara.
5. Të dhënat e Hartës Globale nuk do të shfaqen, ruhen ose shpërndahen në rrjete ose sisteme të aksesueshme publikisht, as nuk do të postohen ose transmetohen përmes sistemit të internetit.
6. Produktet hartografike, duke përdorur të dhënat e Hartës Globale, mund të shpërndahen nga Kombet e Bashkuara pa asnjë kufizim siç është e dobishme për të mbështetur operacionet e saj sipas mendimit të vetëm të Kombeve të Bashkuara.
7. UNGIS-i mund të pasurojë bazat e të dhënave të saj me të dhëna të Hartës Globale ose të bashkojë të dhënat e Hartës Globale me bazat e të dhënave të saj dhe të përdorë rezultatit pa asnjë kufizim siç është e dobishme për të mbështetur operacionet e tij sipas mendimit të vetëm të Kombeve të Bashkuara (Udhëtim njëzetvjeçar në hartën globale, 2016).

Të gjitha produktet që rrjedhin nga ose përdorin të dhënat e Hartës Globale përjashtohen nga nevoja për të dhënë atribuum te Projekti i Hartografisë Globale.

Letra në lidhje me transferimin e të dhënave të Hartës Globale nga ISCGM-ja në UN-GIS është dërguar në Kombet e Bashkuara më 15 shkurt të vitit 2016. Kryetari i ISCGM profesor Paul Cheung ka theksuar, që ISCGM ka udhëhequr Projektin e Hartografisë Globale për mbi 20 vjet, duke kontribuar në zhvillimin e informacionit gjeohapësinor global së bashku me organizatat kombëtare hartografike dhe duke siguruar qasje në të dhëna të tilla zyrtare përmes internetit.

Në lidhje me të dhënat e Hartës Globale të zhvilluara në bashkëpunim me organizatat kombëtare hartografike, propozohet që të dhënat do të transferohen në Seksionin e Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara (UNGIS). Kuptimi është se UNGIS-i do të përmirësojë dobinë e të dhënave të Hartës Globale në mbështetje të operacioneve globale të Kombeve të Bashkuara dhe për të përmbushur nevojat e komunitetit ndërkombëtar, përfshirë Grupet e Punës të GGIM-së së Kombeve të Bashkuara. Kryetari i ISCGM profesor Paul Cheung ka kërkuar gjithashtu përgjigjen e transferimit të propozuar deri më 15 mars 2016.

Vlen të përmendet gjithashtu, që në 8 shtator 2016 Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor të Shqipërisë Z. Lorenc Cala ka dërguar një Letër Miratimi në lidhje me transferimin e propozuar të të dhënave të Hartës Globale të Shqipërisë nga Sekretariati ISCGM të Seksionit të Informacionit Gjeohapësinor të Kombeve të Bashkuara - UNGIS.

Në fund, takimi i 23-të i ISCGM u mbajt në gusht 2016 (Sasagawa et al, 2017). Sipas (LUBISHTANI and Idrizi 2016), propozimi i kryetarit, që është shpërndarja e ISCGM-së dhe transferimi i të dhënave në Seksionin e Informacionit Gjeohapësinor të KB (UNGIS), u diskutua dhe u miratua në mbledhje. Sekretariati bëri një prezantim mbi aktivitetet e kaluara të Projektit të Hartografisë Globale. Kryetari, profesor Cheung, përfundoi takimin duke renditur tri pika si të rëndësishme të ISCGM-së. Ato janë: **Platformë e rëndësishme** për të ndihmuar aktivitetet e informacionit gjeohapësinor të vendeve të ndryshme; **politika e saj e të dhënave të vendosura** në kohën kur edhe Kombet e Bashkuara nuk hapën të dhënat globale për shkak të arsyeve të saj politike; dhe **një tryezë ndihme** për vendet pjesëmarrëse në hartimin global për t'iu përgjigjur pyetjeve teknike. Transferimi i të dhënave në UNGIS pritet të zgjerojë përdorimin e saj (International Steering Committee for Global Mapping ISCGM, 2016).

Sipas (International Steering Committee for Global Mapping), shefi i UNGIS-it, sqaroi se të dhënat e Hartës Globale që do të transferohen deri në fund të marsit 2017 do të përdoren në aktivitetet e ndryshme të Kombeve të Bashkuara (Hartografia Globale-Letër e Njoftimit 2016).

Me kërkesë të Kombeve të Bashkuara, të gjitha të dhënat e Hartës Globale që ekzistojnë që nga dhjetori i vitit 2016 tashmë janë lëshuar nga "Arkivat e të dhënave të Hartës Globale për të ruajtur mundësinë e përdorimit të përdoruesve të përgjithshëm (Sasagawa et al, 2017).

Mandati i ri i GGIM-së së Kombeve të Bashkuara është i lidhur me forcimin e marrëveshjeve institucionale mbi menaxhimin e informacionit gjeohapësinor (E / 2016 / L.28) të miratuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara në korrik të vitit 2016, i cili bën thirrje për kontribut të vazhdueshëm nga bota e komunitetit gjeohapësinor në zbatimin e Agjendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë, Marrëveshjen e Parisit për Ndryshimin e Klimës dhe Modalitetet e Përsheptuara të Rrugëve të Veprimit (SAMOA (Hartografia Globale-Letër e Njoftimit,2016). Pritet që në të ardhmen, të dhënat e transferuara të Hartës Globale të përdoren në projekte të ndryshme të Kombeve të Bashkuara!

8 Kontrolli i cilësisë dhe përdorimi i të dhënave të Shqipërisë në GM dhe UNGIS

Cilësia e të dhënave hapësinore të Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në kuadër të Hartës Globale Botërore (HGB) duhet t'i përmbushin kriteret teknike dhe përmbajtësore të përcaktuara në specifikimin teknik të HGB-së 2.2 (ISCGM 2012) dhe karakteristikave fiziko-gjeografike dhe socio-ekonomike të Republikës së Shqipërisë që lidhen me tetë shtresat tematike të përmbajtjes së HGB-së. Lidhshmëria e standardeve të HGB-së me të dhënat e zhvilluara është kushti themelor i cilësisë që duhet të plotësojnë të dhënat e një shteti, në mesin e të cilëve edhe të dhënat hapësinore të Republikës së Shqipërisë, për t'u publikuar baza me tetë shtresa tematike si pjesë e HGB-së.

Kushtet teknike janë plotësuar tërësisht, me vetë faktin që baza e Shqipërisë është pranuar teknikisht dhe është publikuar si pjesë e HGB-së, pikërisht e një infrastrukture globale e të dhënave hapësinore të zhvilluara nga autoritetet kombëtare për hartografi. Mirëpo, që të kemi pasqyrë të plotë mbi cilësinë e të dhënave të zhvilluara dhe të publikuara, në këtë kapitull do të paraqiten analizat e realizuara në fazën e zhvillimit, pikërisht para dorëzimit për verifikim teknik të të dhënave në autoritetin ndërkombëtar që menaxhonte me HGB-në.

Analizat e realizuara përfshijnë më shumë kriterë në krahasim me kërkesat teknike të HGB-së në specifikim teknik 2.2, me qëllim që të sigurohet pasqyrë e plotë mbi të dhënat e publikuara në më shumë aspekte, duke përfshirë garancën shtetërore që duhet ta sigurojë ASIG-u si autoritet shtetëror dhe pronar zyrtar i të dhënave të publikuara, relevancën shkencore të procesit teknologjik dhe metodologjik të përdorur për zhvillimin dhe verifikimin e të dhënave, si dhe zbatimin e standardeve të infrastrukturës globale të të dhënave hapësinore në praktikën gjeodezike në hapësirat shqiptare. Me këtë, arrihet ekuivalenca e të dhënave hapësinore të Republikës së Shqipërisë me të dhënat e shteteve të zhvilluara në kuadër të bazës unike të Botës nën përfaqësimin e Kombeve të Bashkuara (UNGIS).

Gjatë zhvillimit të bazës së të dhënave dhe kontrollit të cilësisë së tyre, hasëm në disa probleme teknike për të cilat nuk arritëm të gjejmë zgjidhje në specifikimet teknike, të cilat gjithashtu do të paraqiten në këtë kapitull.

Kontrolli i cilësisë i të dhënave nënkupton procesin e verifikimit të të dhënave duke krahasuar të dhënat e zhvilluara me realitetin objektiv në natyrë dhe standardet tekniko-juridike që duhet t'i përmbushin të dhënat e zhvilluara. Realizimi i kontrollit të cilësisë në këtë disertacion është realizuar duke u bazuar në standardin ISO 19157:2013 (<https://www.iso.org/standard/32575.html>), standard që ishte në fuqi në vitin 2016 gjatë periudhës së zhvillimit të bazës së të dhënave. Standardi i përdorur është publikuar në dhjetor të vitit 2013, duke zëvendësuar tre standardet e vjetra ISO 19113:2002, ISO 19114:2003 dhe ISO/TS 19138:2006, që në vitin 2018 është publikuar si version i korrigjuar ISO 19157:2013/AMD1:2018 si rezultat i përditësimit të rregullt pesëvjeçar.

Bazuar në kriteret e mësipërme, verifikimi i cilësisë i të dhënave të Shqipërisë në HGB është realizuar në shtatë pika (Idrizi 2010), si testime të veçanta gjatë fazave të zhvillimit të të dhënave:

- burimi i të dhënave,
- saktësia gjeometrike,
- saktësia e attributeve (të dhënave alfanumerike),
- tërësia,
- konzistenca logjike (lidhja e ndërsjellë e objekteve mes vete),
- saktësia semantike (cilësia e përshkrimit e të dhënave), dhe
- informacioni mbi kohën e të dhënave burimore.

8.1 Burimi i të dhënave

Burimi i të dhënave është tregues i parë për cilësinë e të dhënave të cilat mund të përdoren si të dhëna hyrëse për zhvillimin e bazës së të dhënave, respektivisht për përpilimin e hartës së re.

Besueshmëria ndaj të dhënave hyrëse varet nga institucioni/organizata që i ka krijuar ato, si dhe baza juridike e përdorur për krijimin e tyre.

Baza juridike e cila përfshin aktet ligjore dhe nënligjore, bashkë me specifikat teknike për bazën e të dhënave hyrëse, është tregues i cilësisë së të dhënave hyrëse, pasi të dhënat e ofruara nga institucionet/organizatat janë krijuar duke u bazuar në standardet e përfshira në aktet e përdorura juridike.

Niveli i zbatimit të akteve juridike në të dhënat e zhvilluara paraqitet si kriter që kategorizon besueshmërinë ndaj institucioneve dhe organizatave. Edhe pse respektimi i akteve normative shtetërore është detyrim për çdo institucion dhe organizatë, jo të gjithë i respektojnë dhe të dhënat e krijuara i posedojnë standardet e parapara në aktin normativ. Varësisht nga niveli i institucionit ose organizatës, që paraqitet si pronar i të dhënave hyrëse, bëhet filtrimi i parë i përgjithshëm për të dhënat potenciale ekzistuese. Jo çdo institucion ose organizatë gëzon autoritet të njëjtë, të cilët dallohen për nga cilësia e punëve që kryejnë dhe nga përvoja e tyre në punën konkrete. Gjithashtu, jo gjithmonë pronari (institucioni/organizata) i të dhënave gjeohapësinore është zhvillues i të dhënave. Vlerësimi i besueshmërisë në bazë të institucionit prej ku janë siguruar të dhënat hyrëse për zhvillimin e bazës së të dhënave të HGB-së për territorin e Republikës së Shqipërisë, është realizuar duke u dhënë përparësi institucioneve shtetërore të cilat janë autoritete zyrtare për zhvillimin e të dhënave zyrtare, kundrejt organizatave private dhe të dhënave të hapura dhe falas nga interneti. Në tabelat e mëposhtme, janë paraqitur burimet e të dhënave hyrëse që janë përdorur për ndërtimin e HGB-së, të cilat konform kompetencave institucionale paraqesin burim relevant dhe të besueshëm që mund të përdoren si të dhëna zyrtare për ndërtimin e të dhënave të Republikës së Shqipërisë.

Saktësia e të dhënave burimore lidhet me aktin juridik në bazë të cilit janë ndërtuar të dhënat dhe meta të dhënat që jepen si informacion nga pronari i të dhënave. Akti juridik është standardi normativ në të cilin përcaktohen kriteret minimale të saktësisë që duhet t'i plotësojnë të dhënat, ndërkaq informacioni në formë të meta të dhënave paraqet saktësinë që garanton pronari/zhvilluesi i të dhënave. Gjatë përzgjedhjes së burimeve të të dhënave për ndërtimin e të dhënave të Republikës së Shqipërisë, saktësia e të dhënave burimore që ishin në dispozicion nga institucionet

dhe organizatat në Republikën e Shqipërisë që paraqiten si prodhues i të dhënave gjeohapësinore, si dhe bazat e të dhënave të hapura dhe të lira nga interneti, u krahasuan me standardin e paraparë në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së, pikërisht në pikat 2.3 “Precision” dhe 2.4 “Accuracy”. Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur vetëm të dhënat e përdorura burimore, të cilat tërësisht i plotësonin kushtet teknike të HGB-së.

Tabela 8.1 Burimi i të dhënave për shtresën e rrjetit të transportit për Hartën Globale të Shqipërisë.

Emri	Gjeometri	Lloji	Burimi
Aeroport	Pikë	Aeroporti civil ndërkombëtar, ushtarak	ASIG, ortofoto
Portet	Pikë	Emri/kodi	ASIG, ortofoto
Hekurudhat	Linjë	Funksionale, në ndërtim e sipër, e pa përdorur	IUGJ, Harta topografike 1:25000
Stacionet e trenit	Pikë	Emrat e stacioneve	IUGJ, Harta topografike 1:25000
Rrugët	Linjë	Autostradat, rrugët shtetërore, regjionale dhe të tjera	Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)

Tabela 8.2 Burimi i të dhënave për shtresën e kufijve për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016)

Emri	Gjeometri	Lloji	Burimi
<i>Linja bregdetare</i>	Linjë	Vija bregdetare e detit dhe liqeneve	IGJU, Harta topografike 1:25 000 dhe 1:10 000
<i>Kufiri politik</i>	Linjë	Komuna	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)
<i>Kufiri politik</i>	Poligon	Komuna	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)

Tabela 8.3 Burimi i të dhënave për shtresën e hidrografisë për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Emri	Gjeometri	Lloji	Burimi
<i>Burime</i>	Pika	Burime hidrografike	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto
<i>Kanalet</i>	Linja	Kanalet me rrjedhje të përhershme	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto
<i>Lumenjtë</i>	Linja	Lumenjtë	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto
<i>Ujërat e brendshme</i>	Poligon	Liqenet dhe ujërat e qeta	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto

Tabela 8.4 Burimi i të dhënave për shtresën e vendbanimeve për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Emri	Gjeometri	Lloji	Burimi
Vendbanimet	Pika	Vendbanimet - jo më të vogla se 1 km	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto
Vendbanimet	Poligon	Vendbanimet e mëdha kryesore	IGJU, Harta topografike 1:25 000, 1:10 000 dhe ASIG, ortofoto

Tabela 8.5 Burimi i të dhënave për shtresën e lartësive për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Lloji i të dhënave	Burimi
Shtresë rasteriale me rezolucion hapësinor 1’’	SRTM – version 3 (2013)
Kuota për përpunim dhe adaptim të SRTM-it	IGJU, Harta topografike 1:25 000

Tabela 8.6 Burimi i të dhënave për shtresën e mbulesës së tokës për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Lloji i të dhënave	Burimi
Ortofoto harta	ASIG
Imazhe satelitore	IRS, SPOT, Landsat dhe RapidEye
Harta topografike 1:25000	IGJU

Tabela 8.7 Burimi i të dhënave për shtresën e përdorimit të tokës për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Lloji i të dhënave	Burimi
Ortofoto harta	ASIG
Imazhe satelitore	LANDSAT dhe CORINE
Harta topografike 1:25000	IGJU

Tabela 8.8 Burimi i të dhënave për shtresën e vegjetacionit për Hartën Globale të Shqipërisë (LUBISHTANI and Idrizi, 2016).

Lloji i të dhënave	Burimi
Ortofoto harta	ASIG
Imazhe satelitore	LandsatTM / NDVI
Harta topografike 1:25000	IGJU

Të gjitha të dhënat e shënuara në tetë tabelat e mësipërme, i plotësojnë të gjitha kriteret përmbajtësore dhe cilësore konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së.

8.2 Saktësia gjeometrike

Saktësia gjeometrike nënkupton paraqitje numerike të saktësisë hapësinore të elementeve të paraqitura në hartë, që tregon shkallën e dallimit të objekteve nga pozicioni i tyre në natyrë. Vlerësimi i saj për të dhënat hapësinore të paraqitura në hartë bëhet duke analizuar pikat identike në dy sisteme të dhënash, respektivisht koordinatat dhe/ose lartësitë mbidetare të pikave nga harta që analizohet, të cilat kanë statusin e vlerave të matura me koordinatat dhe/ose lartësitë mbidetare të pikave të njëjta në sistem tjetër, që kanë status të vlerave të “sakta”. Si burim i sistemit të dytë të vlerave të “sakta” mund të jetë ndonjë hartë e shkallës më të madhe, ku kërkesa e saktësisë është më e lartë, ose vlerat hyrëse të cilat kanë shërbyer për përpilimin e hartës nëse ata kanë kaluar procesin e përgjithësimit hartografik që nënkupton se shkalla e tyre para përgjithësimit është më e madhe se shkalla e hartës së përpiluar.

Vlerësimi i saktësisë gjeometrike mund të realizohet me njehsimin e gabimit mesatar kuadratik, gabimit mesatar absolut, gabimit probabël dhe devijimit standard.

Saktësia gjeometrike shprehet nëpërmjet përcaktimit të gabimit mesatar kuadratik, që llogaritet në bazë të diferencave të koordinatave të pikave identike në hartë dhe ato në terren, me ç’rast koordinatat e marra nga harta trajtohen si vlera të matura, ndërsa ata nga terreni si vlera kushtimisht të sakta, respektivisht me formulën e mëposhtme:

$$m = \sqrt{\frac{[\Delta_i^2]}{n}}$$

Sipas metodologjisë statistikore, analiza e tërësishme e vlerave mund të bëhet nëse ekziston numër i mjaftueshëm i të dhënave, të cilët duhet të jenë prej 10^3 deri 10^5 . Në praktikë zakonisht numri i të dhënave merret të jetë më i madh se 100, numër i mjaftueshëm i të dhënave i cili ndihmon që gabimi mesatar kuadratik (GMK) të mund të identifikohet me devijimin standard. Sipas (Idrizi 2009), devijimi standard paraqet vlerë konstante që objektivisht e karakterizon saktësinë e të dhënave dhe në mënyrë më adekuate i pasqyron të gjitha gabimet reale, që njehsohet me formulën në vazhdim:

$$\sigma = \sqrt{\frac{\sum_{i=1}^n (x_i - \bar{x})^2}{n - 1}}$$

Vlerat e njehsuara nga analiza gjeometrike e të dhënave duhet të kenë vlera më të vogla se gabimet e lejuara në HGB, të përcaktuara në pikën 2 paragrafi 2.4 i specifikimit teknik 2.2 të HGB-së, që paraqet kushtin kryesor të inkuadrimit të të dhënave në kuadër të HGB-së. Testimi i tyre është realizuar në fazën e përgatitjes së të dhënave, para dërgimit të tyre për verifikim në Këshillin Ndërkombëtar të HGB-së.

Analiza e saktësisë gjeometrike e të dhënave vektoriale është realizuar duke krahasuar 1555 pikat e njëjta nga baza e Shqipërisë e përgatitur për HGB-në dhe të marra nga hartat topografike, ortofoto hartat, të dhënat nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Analiza rezultoi me vlerat e njehsuara si më poshtë:

Tabela 8.9 Devijimi standard i të dhënave vektoriale në Hartën Globale të Shqipërisë

σ_y	σ_x	σ_{yx}
18.69m	59.35m	62.23m

Bazuar në shkallën e HGB-së 1:1.000.000, vlera e njehsuar për devijimin standard për të katër shtresat vektoriale në pozicion është 0,06mm, me të cilën vërtetohet që saktësi gjeometrike e të dhënave të zhvilluara për katër shtresat vektoriale për Republikën e Shqipërisë në kuadër të HGB-së i plotësojnë kriteret e larta hartografike të sigurimit të saktësisë gjeometrike prej $0.1_{mm} * F$ dhe kriteret e shënuara në pikën 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik 2.2 të HGB-së për saktësinë planimetricë.

Analiza e saktësisë gjeometrike për të dhënat rasterike është realizuar duke krahasuar përmbajtjen e pikave të identifikuara nga ortofoto harta ose hartat topografike me kodet e qelizave në shtresat rasteriale. Për shkak të karakterit të ndryshëm të përmbajtjes së shtresës së lartësive kundrejt tri shtresave të tjera të të dhënave rasteriale, kriteri i përzgjedhjes së pikave për analizë është realizuar ndaras.

Si të dhëna krahasuese (“të sakta”) për analizën e shtresës së lartësive janë përdorur kuotat nga hartat topografike 1:25000, të cilat në bazë të diferencës me vlerat e lartësisë mbidetare të qelizave rasteriale shprehin cilësinë e shtresës rasterike të lartësive, që duhet të jetë në kuadër të saktësisë së projektuar për lartësitë e HGB-së në pikën 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik 2.2.

Pikat e identifikuara në hartë topografike ose në imazh ortofoto për shtresat e vegjetacionit, përdorimit të tokës dhe mbulesës së tokës janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë pikën qendrore të hapësirës me sipërfaqe më të madhe se 0.5ha. Vlera e përvetësuar e sipërfaqes 0.5ha vjen si rrjedhojë e pikës 3 paragrafi 3.2.2 i specifikimit teknik 2.2 të HGB-së, ku të dhënat rasteriale parashihet të zhvillohen me rezolucion hapësinor 30", 15" ose 3", që në rastin e territorit të Shqipërisë, meqë rezolucioni hapësinor është 3", vlera e harkut 3" paraqet brinjën e qelizës me gjatësi ≈70m. Në bazë të vlerës së rezolucionit hapësinor prej 70m, pikërisht në bazë të sipërfaqes së një qelize në shtresat rasteriale prej ≈0.49ha, është vendosur kushti i sipërfaqes 0.5ha për analizën e të dhënave rasteriale.

Analiza e të dhënave hapësinore për lartësitë në kuadër të Hartës Globale Botërore për Shqipërinë në shkallë 1:1 000 000

Analiza është realizuar mbi bazën e 560 kuotave të marra si test pika në hartën topografike 1:25.000 duke njehsuar diferencën e tyre me lartësitë mbidetare të qelizave brenda shtresës rasterike "Lartësitë", ku devijimi standard rezultoi: $\sigma_h = 25.64m$

Vlera e njehsuar e devijimit standard vërteton që saktësia gjeometrike e të dhënave të zhvilluara për shtresën rasteriale të lartësive për Republikën e Shqipërisë në kuadër të HGB-së i plotëson kriteret e larta hartografike të sigurimit të saktësisë naltimetrike në hartën me shkallë 1:1.000.000 dhe kriteret e shënuara në pikën 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik 2.2 të HGB-së për saktësinë naltimetrike.

Shpërndarja e pikave është paraqitur në figurën 8.1, ndërkaq lista e pikave të testuara me koordinata dhe lartësi janë paraqitur në shtojcë të disertacionit.

Analiza e të dhënave hapësinore mbi përdorimin e tokës në kuadër të Hartës Globale Botërore për Shqipërinë në shkallë 1:1 000 000

Analiza është realizuar mbi bazën e 240 pikave të marra si test pika për përdorimin e tokës nga imazhet ortofoto të vitit 2015 duke krahasuar ata me kodin e llojit të përdorimit të tokës së qelizave brenda shtresës rasterike "përdorimi i tokës". Në bazë të 240 pikave është llogaritur përqindja e përputhjes për secilin lloj të përdorimit të tokës ndaras, konform standardeve të parapara në specifikacionin teknik 2.2.

Vlerat e njehsuara të përqindjes së përputhjes së llojit të përdorimit të tokës janë paraqitur në tabelën 8.10, ku vlera e përgjithshme e përputhjes ka rezultuar të jetë rreth 80%. Duke pasur parasysh që vlerësimi i përputhshmërisë është realizuar me mbivendosje të pikave të veçanta me qelizat e shtresës rasteriale me sipërfaqe 4900m², si dhe duke iu referuar pikës 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik të HGB-së, saktësia gjeometrike e të dhënave të zhvilluara për shtresën rasteriale të përdorimit të tokës për Republikën e Shqipërisë në kuadër të HGB-së është në kuadër të saktësisë së projektuar në specifikimin teknik 2.2 për saktësinë planimetrike të të dhënave të publikuara në kuadër të HGB-së.

Shpërndarja e pikave është paraqitur në figurën 8.2, ndërkaq lista e pikave të testuara me koordinata është paraqitur në shtojcë të disertacionit.

Tabela 8.10 Saktësia sipas test pikave për klasat e përdorimit të tokës

Nr / ID	Vlera e klasës	Mal	Djerrinë/Shkurre	Sipërfaqe bujqësore	Tokë e lagur	Sipërfaqe e papunuar	Sipërfaqe e ndërtuar	Kullim/Ujë	Pa të dhëna	Gjithsej	Saktësia %
1	Mal	49	7	1	0	0	0	1	0	58	84.48%
2	Djerrinë/Shkurre	3	74	2	0	0	0	0	0	79	93.67%
3	Sipërfaqe bujqësore	2	9	39	1	0	2	0	0	53	73.58%
4	Tokë e lagur	0	4	0	6	0	0	0	0	10	60%
5	Sipërfaqe e papunuar	0	1	1	0	7	0	1	0	10	70%
6	Sipërfaqe e ndërtuar	0	0	4	0	0	6	0	0	10	60%
7	Kullim/Ujë	0	0	0	0	0	0	10	0	10	100%
8	Pa të dhëna	0	5	0	0	2	1	2	0	10	0
9	Gjithsej	54	100	47	7	9	9	14	0	240	0
10	Saktësia %	90.74 %	74.00%	82.98%	85.71 %	77.78%	66.67%	71.43%	0%	0%	79.58%




Figura 8.1 Harta me test pika për lartësitë



Figura 8.2 Harta me test pika për përdorimin e tokës

Analiza e të dhënave hapësinore mbi mbulueshmërinë e tokës në kuadër të Hartës Globale Botërore për Shqipërinë në shkallë 1:1 000 000

Analiza është realizuar mbi bazën e 265 pikave të marra si test pika për mbulesën e tokës nga imazhet ortofoto të vitit 2015 duke krahasuar ata me kodin e llojit të mbulesës së tokës së qelizave brenda shtresës rasterike “mbulesa e tokës”. Në bazë të 265 pikave është llogaritur përqindja e përputhjes për secilin lloj të mbulesës së tokës ndaras, konform standardeve të parapara në specifikacionin teknik 2.2.

Vlerat e njehsuara të përqindjes së përputhjes së llojit të mbulesës së tokës janë paraqitur në tabelën 8.11, ku vlera e përgjithshme e përputhjes ka rezultuar të jetë rreth 77%. Duke pasur parasysh që vlerësimi i përputhshmërisë është realizuar me mbivendosje të pikave të veçanta me qelizat e shtresës rasteriale me sipërfaqe 4900m², si dhe duke iu referuar pikës 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik të HGB-së, saktësia gjeometrike e të dhënave të zhvilluara për shtresën rasteriale të mbulesës së tokës për Republikën e Shqipërisë në kuadër të HGB-së është në kuadër të saktësisë së projektuar në specifikimin teknik 2.2 për saktësinë planimetricë të të dhënave të publikuara në kuadër të HGB-së.

Shpërndarja e pikave është paraqitur në figurën 8.3, ndërkaq lista e pikave të testuara me koordinata është paraqitur në shtojcë të disertacionit.

Tabela 8.11 Saktësia sipas test pikave për klasat e mbulueshmërisë së tokës

Nr	Klasat	C_2	C_3	C_4	C_5	C_6	C_7	C_8	C_9	C_10	C_11	C_13	C_15	C_16	C_17	C_18	C_20	C_255	Total	Sakt
1	C_2	39	0	0	1	0	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	44	88.0
2	C_3	0	9	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	90.0
3	C_4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.0
4	C_5	0	1	0	9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	90.0
5	C_6	0	0	0	0	7	1	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	0	10	70.0
6	C_7	1	0	1	2	0	17	0	0	1	0	0	0	2	0	1	0	0	25	68.0
7	C_8	1	0	0	2	0	0	16	3	0	0	0	0	2	0	0	0	0	24	66.0
8	C_9	0	0	0	1	0	0	0	17	0	0	0	0	1	0	0	0	0	19	89.0
9	C_10	0	0	0	0	0	0	0	0	7	0	0	0	3	0	0	0	0	10	70.0
10	C_11	1	0	0	4	2	3	1	0	2	19	0	0	1	0	0	0	0	33	57.0
11	C_13	1	1	1	0	0	1	2	0	0	1	11	0	1	0	1	0	0	20	55.0
12	C_15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	9	0	0	0	0	0	10	90.0
13	C_16	0	0	0	0	0	1	1	1	0	0	0	0	7	0	0	0	0	10	70.0
14	C_17	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	9	0	0	0	10	90.0
15	C_18	0	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	1	0	7	0	0	10	70.0
16	C_20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	0	10	100.0
17	C_255	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	10	100.0
18	Total	43	11	2	19	10	26	20	24	10	21	11	9	20	10	9	10	10	265	0.0
19	Saktësia	90.70%	81.82%	0.00%	47.37%	70.00%	65.38%	80.00%	70.83%	70.00%	90.48%	100.00%	100.00%	35.00%	90.00%	77.78%	100.00%	100.00%	0.00%	76.60%

Analiza e të dhënave hapësinore mbi vegjetacionin në kuadër të Hartës Globale Botërore për Shqipërinë në shkallë 1:1 000 000

Analiza është realizuar mbi bazën e 1121 pikave të përzgjedhura si test pika për vegjetacionin nga imazhet ortofoto të vitit 2015 duke krahasuar ato me kodin e llojit të vegjetacionit të qelizave brenda shtresës rasterike “vegjetacioni”. Në bazë të 1121 pikave është llogaritur përqindja e përputhjes për secilin lloj të vegjetacionit ndaras, konform standardeve të parapara në specifikacionin teknik 2.2.

Vlerat e njehsuara të përqindjes së përputhjes së vegjetacionit janë paraqitur në tabelë në shtojcë të disertacionit, ku vlera e përgjithshme e përputhjes ka rezultuar të jetë rreth 81%. Duke pasur parasysh që vlerësimi i përputhshmërisë është realizuar me mbivendosje të pikave të veçanta me qelizat e shtresës rasteriale me sipërfaqe 0.49ha, si dhe duke iu referuar pikës 2 paragrafi 2.4 të specifikimit teknik të HGB-së, saktësia gjeometrike e të dhënave të zhvilluara për shtresën rasteriale vegjetacioni për Republikën e Shqipërisë në kuadër të HGB-së është në kuadër të saktësisë së projektuar në specifikimin teknik 2.2 për saktësinë planimetrike të të dhënave të publikuara në kuadër të HGB-së.

Shpërndarja e pikave është paraqitur në figurën 8.4, ndërkaq lista e pikave të testuara me koordinata është paraqitur në shtojcë të disertacionit.




Figura 8.3 Harta me test pika për mbulesën e tokës



Figura 8.4 Harta me test pika për vejetacionin

Të gjitha të dhënat e ndërtuara në tetë shtresat tematike, i plotësojnë tërësisht kriteret e saktësisë gjeometrike në rrafsh dhe lartësi konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së.

8.3 Saktësia e attributeve

Saktësia e attributeve paraqet nivelin e besueshmërisë ndaj të dhënave alfanumerike që shoqërojnë objektet gjeohapësinore, të vendosura në tabelën e attributeve, respektivisht në bazën e të dhënave. Saktësia e attributeve paraqitet me përqindje të përputhjes së attributeve me vlerat numerike, përshkrimet tekstuale ose kodet përkatëse, që realizohet me krahasimin e tabelës së attributeve të bazës së zhvilluar me vlerat dhe përshkrimet referente.

Analiza e saktësisë së attributeve realizohet ndaras për tri kategori të të dhënave alfanumerike:

- attribute tematike,

- attribute cilësore dhe
- attribute sasiore.

Të dhënat tematike paraqesin atributet mbi kategorinë e objekteve konform kriterit të paraparë për kategorizim (p.sh. destinimi i objektit), të cilat përcaktohen në specifikimet teknike të bazës së të dhënave dhe duhet të zbatohen si të tilla në bazën e të dhënave.

Të dhënat alfanumerike cilësore nënkuptojnë attribute që paraqesin emërtimet dhe format tjera përshkruese të objekteve gjeohapësinore në formë tekstuale (p.sh. emri i komunës), të cilat mund të jenë të standardizuara por në të shumtën e rasteve paraqesin përshkrim tekstual të pastandardizuar në specifikimin teknik ose akt tjetër juridik.

Të dhënat sasiore në tabelën e attributeve janë të dhënat numerike që paraqesin vlerën e ndonjë dukurie të objekteve gjeohapësinore (p.sh. numri i banorëve), të cilat rrallë herë mund të jenë të standardizuara, sikurse rasti i attributeve cilësore.

Analiza e saktësisë së attributeve e bazës së zhvilluar të Shqipërisë për HGB-në është realizuar në kuadër të ASIG-ut, si pronar i të dhënave dhe institucion përgjegjës para komitetit ndërkombëtar për HGB-në dhe para UNGIS-it të Kombeve të Bashkuara. Kriteret e vendosura për analizën e realizuar i kanë përfshirë të tre grupet e attributeve, të paraqitur në diagramin e mëposhtëm.




Figura 8.5 Skema e analizës së saktësisë së attributeve

Të gjitha shtresat vektoriale kanë kaluar nëpër tri filtrat e parapara për analizën e saktësisë së attributeve, duke pasur parasysh faktin që në tabelën e attributeve konform shtojcës D të pikës 3 paragrafi 3.1. të specifikimit teknik 2.2 të HGB-së, katër shtresat vektoriale përmbajnë të dhëna për kategorizimin e të dhënave, të dhëna përshkruese dhe të dhëna numerike-vlera për dukuritë e objekteve gjeohapësinore. Minimizimi i gabimit të rastit gjatë përzgjedhjes së kategorisë së objektit në tabelën e attributeve (p.sh. kodet për kategorizimin e rrugëve, ujërave etj.) në rastin e attributeve tematike dhe emërtimeve të standardizuara (p.sh. emrat e vendbanimeve, porteve etj.) në rastin e emërtimeve cilësore, në rastin tonë është realizuar me krijimin e kodeve domain, që mundësoi përzgjedhjen e kategorisë së objektit dhe emërtimeve të standardizuara me listë zbritëse në tabelën e attributeve, përkundër shkrimit manual të tyre në tabelën e attributeve. Forma e këtillë eliminoi gabimet tipografike gjatë shënimit të attributeve në tabelën e attributeve për dy kategoritë e cekura. Të gjitha të

dhënat janë analizuar nga autoriteti përgjegjës ASIG, me qëllim që të arrijmë relevancën zyrtare të të dhënave attribute të publikuara në kuadër të shtresave vektoriale të HGB-së për Republikën e Shqipërisë.

Analiza e saktësisë së attributeve të të dhënave rasteriale për shkak të karakteristikave teknike të tabelës së attributeve me një brez, u realizua si analizë e attributeve tematike të tri shtresave vegjetacioni, mbulesa e tokës dhe përdorimi i tokës ku vlera paraqet kategori të kodizuara të vegjetacionit, mbulesës së tokës ose përdorimit të tokës, dhe si analizë e attributeve cilësore për shtresën e relievit ku vlera paraqet lartësinë mbidetare të qelizës.

Të gjitha të dhënat e ndërtuara në tetë shtresat tematike janë analizuar sipas skemës së mësipërme në ASIG dhe i plotësojnë tërësisht kriteret e saktësisë së attributeve konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së, si dhe emërtimeve, kategorizimeve dhe vlerave zyrtare të objekteve gjeohapësinore konform bazave zyrtare të institucioneve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë e të harmonizuara dhe të centralizuara në kuadër të ASIG-ut si autoritet përgjegjës për kontrollin e cilësisë së të dhënave hapësinore zyrtare të të gjitha institucioneve në Republikën e Shqipërisë.

8.4 Tërësia

Tërësia nënkupton vëllimin e të dhënave gjeohapësinore që duhet të përmbajë baza e të dhënave konform specifikimit teknik si standard, kundrejt objekteve gjeohapësinore të hapësirës së caktuar që plotësojnë kushtin minimal për inkuadrim në bazën e të dhënave dhe attributeve që përshkruajnë tiparet e caktuara të objekteve të inkuadruara gjeohapësinore. Kontrolli bëhet duke analizuar mbingarkesën dhe mangësinë e hartës në një pjesë të bazës si shembull i rastit. Si tolerancë e lejuar teorike gjatë kësaj analize pranohet dallimi 5%. Krahas tërësisë së të dhënave, në këtë fazë të analizës trajtohet edhe modeli i të dhënave si standard i përcaktuar në specifikimet teknike. Figura në vazhdim paraqet skemën e përgjithshme të analizës së tërësisë:




Figura 8.6 Skema e hierarkisë së llojeve të ndryshme të tërësive

Në rastin e analizës së realizuar për të dhënat e Shqipërisë në kuadër të HGB-së, kontrolli është realizuar duke përfshirë gjithë bazën e të dhënave dhe jo vetëm një shembull të rastit, toleranca është pranuar të jetë 0% me qëllim që të arrihet besueshmëri e plotë ndaj të dhënave të zhvilluara të Shqipërisë, ndërkaq analiza e

modelit nuk është realizuar pasi që specifikimi teknik 2.2 si standard ndërkombëtar që duhet të përdoret nga të gjitha shtetet është jashtë kompetencave tona.

Analiza e tërësisë në rastin tonë të zhvillimit të bazës së të dhënave vektoriale të Shqipërisë për HGB-në është realizuar nga ASIG dhe institucionet tjera përgjegjës nëpërmjet ASIG-ut, duke analizuar tërësinë e të dhënave dhe attributeve të të dhënave kundrejt gjendjes faktike në terren dhe evidencës zyrtare në bazat e të dhënave zyrtare në Shqipëri. Pjesa e analizës së tërësisë së të dhënave rasteriale dhe tërësisë së bazës së zhvilluar kundrejt standardeve të përcaktuara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së është realizuar si pjesë e disertacionit, duke verifikuar përfshirjen hapësinore dhe analizën e qelizave pa vlera në katër shtresat rasteriale, si dhe duke verifikuar inkuadrimin e të dhënave të zhvilluara të Shqipërisë në kuadër të përmbajtjes obligative të HGB-së. Tërësia e të dhënave joobligative është realizuar vetëm nga ASIG-u dhe institucionet përgjegjëse që të sigurohet niveli i tërësisë së të dhënave të publikuara në bazën globale të HGB-së, por jo edhe në funksion të analizës së tërësisë së bazës së zhvilluar kundrejt standardeve të përcaktuara në specifikimin teknik, pasi ata janë zhvilluar që të arrihet bazë cilësore e Shqipërisë në HGB përkundër përmbushjes së kriteve minimale obligative të përmbajtjes. Në figurën e mëposhtme është paraqitur skema e analizës së tërësisë



Figura 8.7 Skema e analizës së tërësisë

Të gjitha të dhënat e ndërtuara për tetë shtresat tematike, janë analizuar në ASIG dhe në kuadër të disertacionit. Ata i plotësojnë 100% kriteret e tërësisë së objekteve dhe të attributeve konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së, si dhe sipas evidencës zyrtare të objekteve gjeohapësinore konform bazave zyrtare të institucioneve përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë e të harmonizuara dhe centralizuara në kuadër të ASIG-ut si autoritet përgjegjës për kontrollin e cilësisë së të dhënave hapësinore zyrtare të të gjitha institucioneve në Republikën e Shqipërisë.

8.5 Konzistenca logjike

Bazuar në standardin ISO 19157:2013 konzistenca logjike paraqet “shkallën e respektimit të rregullave logjike të strukturës së të dhënave, attributeve dhe relacioneve”, respektivisht lidhjen e ndërsjellë strukturore të objekteve, në aspekt hapësinor dhe përshkrues.

Ekzistojnë katër elemente që karakterizojnë konzistencën logjike:

- konzistenca konceptuale,
- konzistenca e domenit,
- konzistenca e formës dhe
- konzistencatopologjike.

Konzistenca konceptuale monitoron respektimin e rregullave të skemës konceptuale të strukturës së bazës së të dhënave, *konzistenca e domenit* kontrollon spektrin e kodeve dhe përshkrimeve/emërtimeve alfanumerike në fusha të caktuara të tabelës së attributeve sipas standardit të përdorur, *konzistenca e formës* kontrollon shkallën e të dhënave gjeohapësinore në përputhje me strukturën fizike të të dhënave, dhe *konzistenca topologjike* shqyrton zbatimin e karakteristikave topologjike të përcaktuara në standard/specifikimin teknik.

Analiza e konzistencës së domenit në këtë fazë nuk është realizuar, pasi që ajo është realizuar në etapën e analizës së attributeve, pikërisht gjatë analizës së domeneve të vendosura për atributet tematike dhe cilësore.

Analiza e konzistencës konceptuale, të formës dhe asaj topologjike në rastin tonë janë realizuar duke iu përmbajtur rregullave të përcaktuara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së, përkatësisht në pikën 3, që më vonë janë verifikuar dhe konfirmuar nga Këshilli Ndërkombëtar i HGB-së. Vetë fakti që baza e zhvilluar e HGB-së për Shqipërinë është publikuar në infrastrukturën globale dhe sot është pjesë e UNGIS-it, vërteton se baza e zhvilluar i ka përmbushur të gjitha kriteret e konzistencës logjike të parapara në specifikimin teknik të HGB-së.

Krahas analizave të përcaktuara në specifikimin teknik 2.2 mbi konzistencën logjike, ne realizuam një sërë analizash plotësuese për konzistencën logjike duke u bazuar në karakteristikat e topografisë së Shqipërisë dhe përmbajtjes së të dhënave hapësinore dhe alfanumerike të Shqipërisë në kuadër të HGB-së:

- konzistenca logjike ndërmjet kufirit shtetëror, të qarqeve dhe të bashkive,
- konzistenca logjike ndërmjet vendbanimeve me bashkitë dhe qarqet,
- konzistenca logjike ndërmjet objekteve të rrjetit rrugor,
- konzistenca logjike ndërmjet rrjetit hekurudhor dhe stacioneve hekurudhore,
- konzistenca logjike ndërmjet vijës bregdetare me rrjetin e komunikacionit,
- konzistenca logjike ndërmjet vijës bregdetare me rrjetin hidrografik,
- konzistenca logjike ndërmjet objekteve hidrografike,
- konzistenca logjike ndërmjet rrjetit të komunikacionit me objektet hidrografike,

- konzistenca logjike ndërmjet kufirit shtetëror dhe të gjitha objekteve nga shtresat e vendbanimeve, rrjetit të komunikacionit dhe hidrografisë,
- konzistenca logjike ndërmjet kufirit shtetëror dhe shtresave rasteriale,
- konzistenca logjike ndërmjet vijës bregdetare dhe shtresave rasteriale, dhe
- konzistenca logjike ndërmjet katër shtresave rasteriale.

Në shembullim e mëposhtëm është paraqitur rasti i mbivendosjes së të dhënave vektoriale me ata rasteriale, në dy raste me forma komplekse të vijave vektoriale, ku mund të vërehet niveli i lartë i konzistencës ndërmjet tyre, që vjen si rrjedhojë e përdorimit të rezolucionit hapësinor 3" ($\approx 70\text{m}$) për shtresat rasteriale. Në rastet e shteteve që kanë përdorur rezolucion hapësinor 30" (konform specifikimeve të HGB-së deri në versionin 2.1) si rasti i Maqedonisë së Veriut, mbivendosja e formave komplekse është e pamundur të realizohet në këtë nivel siç është rasti i Shqipërisë, për shkak të rezolucionit dhjetë herë më të ulët, respektivisht të sipërfaqes së qelizës për 100 herë më të madhe në krahasim me të dhënat rasteriale të Shqipërisë në HGB.




Figura 8.8 Shembuj të mbivendosjes së të dhënave vektoriale dhe rasteriale

Në shembullin në vazhdim do të paraqesim rastin e shtresave të kufijve administrativë, trekufirit ndërmjet Tiranës, Durrësit dhe Kavajës: Kufiri rezultoi të ketë përputhshmëri të plotë, pa mbivendosje, gjë që tregon një tipar shumë cilësor pasi asnjë pikë, vijë ose poligon për të gjithë shtresat vektoriale nuk ka mbivendosje, dublifim ose diçka tjetër në lidhje me topologjinë e hartës.




Figura 8.9 Shembull i mbivendosjes së të dhënave vektoriale në kuadër të shtresës së kufijve

Duke u bazuar në disa analiza paraprake për konzistencën logjike ndërmjet të dhënave hapësinore të shteteve fqinje në kuadër të HGB-së, krahas analizës së realizuar në bazën e Shqipërisë, në kuadër të disertacionit janë realizuar edhe disa analiza të konzistencës logjike ndërmjet bazës së Shqipërisë dhe Kosovës. Në figurën e radhës është paraqitur jokonzistenca logjike e të dhënave nga dy bazat e të dhënave, njëra e Shqipërisë dhe tjetra e Kosovës, të dyjat të publikuara në kuadër të HGB-së dhe tani më pjesë e UNGIS-it. Në rastin konkret të analizës së konzistencës logjike të të dhënave të Shqipërisë me të dhënat e Kosovës, edhe pse vija kufitare ka kaluar procesin e demarkacionit dhe vijat e kufirit shtetëror për dy shtetet janë publikuar nga autoritetet përgjegjëse, poligonet e dy shteteve kanë probleme topologjike të mbivendosjeve dhe zbrazëtirave në vende të caktuara. Gjatë analizës gjithashtu kemi evidentuar mospërputhje hapësinore ndërmjet objekteve që kanë karakter natyror të vazhdimësisë hapësinore, si p.sh. lumenjtë që kalojnë prej njërit shtet në shtetin tjetër, që në rastin konkret nuk sigurohet vazhdimësi hapësinore ndërmjet dy bazave të të dhënave pasi lumenjtë nuk bashkohen në një pikë.




Figura 8.10 Shembull i jokonzistencës logjike ndërmjet të dhënave të Shqipërisë (sipërfaqja majtas) dhe të Kosovës (sipërfaqja djathtas) në kuadër të HGB/UNGIS

Të gjitha të dhënat e ndërtuara për tetë shtresat tematike janë analizuar në ASIG, në kuadër të disertacionit dhe nga Këshilli Ndërkombëtar i HGB-së, dhe i plotësojnë tërësisht kriteret e konzistencës logjike konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së.

8.6 Saktësia semantike

Saktësia semantike shpreh cilësinë me të cilin objektet hapësore përshkruhen në lidhje me modelin e strukturës së bazës së të dhënave. Ky aspekt i cilësisë lidhet më shumë me rëndësinë e domethënies së objekteve hapësore sesa me përfaqësimin e tyre.

Qëllimi i saktësisë semantike është të përshkruajë “distancën semantike” ndërmjet objekteve gjeografike dhe realitetit të perceptuar të terrenit nominal. Ajo nënkupton kualitetin e përshkrimit të të dhënave hapësore konform modelit të definuar të të dhënave, që përmban: harmonizimin me standardet semantike, saktësinë e përshkrimit në momentin e regjistrimit, tërësinë e përshkrimeve dhe saktësinë cilësore dhe sasiore të përshkrimeve.

Semantika gjeohapësore ka të bëjë me kuptimin e përmbajtjes në GIS, duke lidhur pjesën e attributeve dhe simbolizimit të objekteve gjeohapësore bazuar në tiparet e shprehura nëpërmjet attributeve në bazën e të dhënave që shprehin realitetin objektiv në natyrë. Semantika gjeohapësore është e orientuar në perceptim të lehtë të të dhënave nga përdruesit. Ajo duhet të bazohet në standardet e përcaktuara juridike dhe të përdorura në mënyrë joformale-shoqërore.

Analiza e semantikës në bazën hapësore të Shqipërisë të zhvilluar në kuadër të HGB-së është realizuar vetëm në funksion të të dhënave attribute dhe strukturës së shtresave tematike, pasi që konform specifikimit teknik të HGB-së simbolizimi nuk është i detyrueshëm, ndërkaq standardet teknike të përcaktuara në specifikimin teknik janë jashtë kompetencave tona.

Struktura e të gjitha shtresave tematike të zhvilluara në formatin GML (GeographyMarkupLanguage) janë realizuar konform Shtojcës H të specifikimit teknik 2.2 të HGB-së. Ajo është verifikuar gjatë kontrollit teknik nga Komiteti Ndërkombëtar i HGB-së dhe ka rezultuar të jetë plotësisht e ndërtuar konform standardeve teknike të HGB-së. Struktura e këtillë mundësoi zbatimin e plotë të tabelave 1 dhe 2 të Shtojcës 2 për përshkrimin e objekteve dhe dukurive hapësore në lidhje me modelin e strukturës së bazës së të dhënave. Në vazhdim do të japim ekstrakt të modelit semantik të strukturës së shtresës së vendbanimeve, por që gjatë analizës së bazës së Shqipërisë janë ndërtuar skema identike për të gjitha tetë shtresat tematike.




Figura 8.11 Ekstrakt i skemës semantike të shtresës së vendbanimeve konform tabelës 1 të shtojcës D në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së

Gjatë adaptimit të attributeve përshkruese dhe emërtimeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, janë përdorur rregullat për shkrim ndërkombëtar të emërtimeve, për të gjitha qelizat me “Vlerë aktuale”. Pjesa tjetër e tabelës së attributeve është tërësisht e kodizuar në specifikimin teknik. Analiza e bazës së ndërtuar është realizuar në dy drejtime: mënyra e shënimit të emërtimeve në gjuhën angleze dhe përdorimi i drejtë i kodeve tek atributet ku nuk është krijuar kodi domen si në shembullin e paraqitur më sipër për shtresën e vendbanimeve. Në fazën e ndërtimit të të dhënave, analizat dhe korrigjimet u realizuan në disa iteracione, që në fund u verifikua edhe me kontrollin e cilësisë nga Këshilli Ndërkombëtar i HGB-së.

Që ta verifikojmë semantikën e strukturës së bazës së të dhënave të HGB-së, pikërisht perceptimin e lehtë të bazës së zhvilluar të Shqipërisë nga përdoruesit profesionalë dhe joprofesionalë nga ekspertët e GIS-it, pas publikimit të bazës së Shqipërisë në HGB, kemi realizuar anketime me disa përdorues të GIS-it, duke kërkuar nga ata të trëgojnë vlerësimin e tyre për bazën e zhvilluar dhe mundësitë për përdorimin e saj. Këtë analizë e kemi bërë për të analizuar semantikën e përdorur në rastin e bazës së Shqipërisë. Nga anketimet e realizuara, rezultoi që baza e Shqipërisë në HGB është e pakuptueshme edhe për përdoruesit profesionalë të GIS-it dhe, ajo është e papërdorshme përderisa eksperti nuk konsultohet me specifikimin teknik në bazë të të cilit është ndërtuar baza. Nga kjo del që kjo bazë mund të shfrytëzohet maksimalisht vetëm nga njohës të mirë të specifikimit teknik të HGB-së dhe nuk mund të përdoret në masë të gjerë nga përdoruesit e rëndomtë të GIS-it.

Nëse marim parasysh që shtete të ndryshme kanë ndërtuar bazat e tyre në periudha të ndryshme kohore duke u bazuar në specifikime teknike të ndryshme, semantika e bazave të shteteve të ndryshme është johomogjene dhe inkuadrimi i tyre në analiza të integruara ndërkombëtare ka nevojë për harmonizimin e të dhënave.

Të gjitha të dhënat e ndërtuara për tetë shtresat tematike janë analizuar në kuadër të disertacionit dhe nga Këshilli Ndërkombëtar i HGB-së, dhe i plotësojnë tërësisht kriteret semantike konform standardeve të parapara në specifikimin teknik

8.7 Informacioni mbi kohën e të dhënave burimore

Informacioni mbi kohën e marrjes së të dhënave nga terreni për paraqitjen e tyre hartografike paraqet element që pasqyron momentin kohor të cilës i përgjigjen të dhënat e paraqitura në hartë, që njëkohësisht tregon nivelin e besueshmërisë ndaj informacionit të paraqitur në hartë. Data e burimit e të dhënave mund të haset si koha e rievimit aerofotogrametrik, periudha e deshifrimit të terrenit, data e botimit të hartës etj, që varet nga botuesi i hartës.

Në rastin tonë, kjo analizë është realizuar në fazën fillestare të punimeve, duke krijuar listën e burimeve potenciale të të dhënave ekzistuese, të cilat mund të përdoren për zhvillimin e bazës së të dhënave të Shqipërisë konform standardeve të HGB-së. Si rezultat i analizës së datës së të dhënave burimore, është bërë përzgjedhja e të dhënave duke krijuar listën me të dhënat potenciale që përmbushin kushtin e datës duke përzgjedhur të dhënat e fundit, të cilat më pas u përdorën si të dhëna hyrëse për filtrimin e tyre në etapën e analizës së burimeve të të dhënave e paraqitur në pikën 8.1 të këtij punimi.

Të gjitha të dhënat e ofruara nga ASIG-u janë analizuar në disertacion në bazë të datës së informacionit që përmbajnë dhe është formuar lista e të gjitha të dhënave me datë më të re si të dhënave potenciale për përdorimin e tyre për zhvillimin e bazës së Republikës së Shqipërisë konform standardeve të parapara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së. Me këtë analizë është siguruar shfrytëzimi i të dhënave të fundit (me datë më të re) si të dhëna burimore për zhvillimin e bazës së Republikës së Shqipërisë në kuadër të HGB-së.

9 Rezultatet dhe përfundimet

Zhvilimi i infrastrukturës globale i të dhënave hapësinore në rastin e studimit të Hartës Globale Botërore (HGB) që tani është pjesë e UNGIS-it për territorin e Republikës së Shqipërisë është zhvilluar tërësisht në kuadër të disertacionit të doktoratës. Baza e zhvilluar si pjesë praktike e disertacionit tani më është pjesë e HGB-së dhe UNGIS-it, si bazë zyrtare e Republikës së Shqipërisë, e verifikuar nga Komiteti Ndërkombëtar i HGB-së me seli në Institutin e të Dhënave Gjeohapësinore të Japonisë në Tsukuba – Japoni. Kriteret e përdorura për zhvillimin e bazës së të dhënave të Shqipërisë kundrejt standardeve të përcaktuara në specifikimin teknik 2.2 të HGB-së, kanë synuar standardin më të lartë përkundër plotësisht të kriterëve minimale, si p.sh: shtresat rasteriale janë zhvilluar me rezolucion hapësinor 3” si kriter maksimal në kuadër të specifikimit teknik, ndërkaq saktësia e shtresave vektoriale me devijim standard 62m (0.06mm*F) për planimetri dhe 26m për lartësi paraqet saktësi të lartë konform standardeve hartografike për hartat në shkallë 1:1.000.000 dhe kriterëve të parapara në specifikim teknik.

Realizimit praktik të zhvillimit të bazës së të dhënave të Shqipërisë i parapriu kontributi ynë për të iniciuar anëtarësimin e ASIG-ut në HGB dhe UNGIS. Kjo u realizua nëpërmjet kontaktit tonë të drejtpërdrejtë me Komitetin Ndërkombëtar të HGB-së në Japoni, të realizuar nga autori dhe mentori i doktoratës, të dëshmuara në shtojcë të disertacionit. Institucion bartës në realizimin praktik është ASIG-u si autoritet shtetëror, ndërkaq Universiteti Politeknik i Tiranës nëpërmjet disertacionit të doktoratës dha kontributin praktik dhe shkencor në ngritjen e iniciativës për inkuadrimin e Shqipërisë në HGB, zhvillimin e bazës së Shqipërisë konform standardeve të HGB-së, publikimin e bazës së Shqipërisë në kuadër të HGB-së dhe inkuadrimin e të dhënave të Shqipërisë në bazën e UNGIS-it. Për realizimin e një bashkëpunimi të këtillë ndërmjet autoritetit shtetëror dhe institucionit shkencor, në këtë rast ndërmjet ASIG-ut dhe UPT-së, drejtori i ASIG-ut me vendim ngriti një komision për realizimin praktik të iniciativës, të drejtuar nga kandidati për titullin doktor shkencash, Milot Lubishtani. Me këtë, disertacioni e arriti qëllimin parësor të impaktit shkencor në praktikën profesionale në Shqipëri dhe në inkuadrimin e standardeve ndërkombëtare në institucionet dhe praktikën shtetërore, duke ndërkombëtarizuar bazën e Shqipërisë dhe inkuadruar ASIG-un në rrjetin e institucioneve kombëtare në HGB dhe UNGIS. Realizimi i suksesshëm i kësaj iniciative mundësoi lidhjen e autoritetit shtetëror, komitetit ndërkombëtar pranë OKB-së, praktikës profesionale, shkencës, trendeve globale, standardeve ndërkombëtare dhe teknologjisë bashkëkohore në kuadër të disertacionit të doktoratës.

Në analizat e realizuara në disertacion, krahas shqyrtimit të të dhënave burimore dhe përpunimit të tyre për adaptim konform specifikimit teknik të HGB-së, u trajtuan edhe standardet e HGB-së në funksion të përdorimit të tyre për realizimin e qëllimeve për të cilat është krijuar lloji i këtillë i infrastrukturës globale të të dhënave hapësinore, me ç’rast jokonzistenca logjike dhe struktura e kodizuar e tabelës së attributeve janë dy pikat të cilat u paraqitën si elemente negative që pamundësojnë përdorimin e gjerë të HGB-së dhe UNGIS-it, si dhe përdorimin e integruar të bazave të të dhënave të dy e më shumë shteteve për performim të analizave hapësinore për çështje të ndryshme të mjedisit jetësor.

Mangësitë e identifikuar të HGB-së në studimet paraprake si saktësia gjeometrike e HGB-së dhe standardet hartografike, konzistenca logjike ndërmjet të dhënave rasteriale dhe vektoriale, përdorimi i atributit “UNK” për të dhënat e panjohura dhe konzistenca logjike ndërmjet shtresave vektoriale, janë eliminuar tërësisht gjatë zhvillimit të bazës së Republikës së Shqipërisë me metodologjinë e përdorur për përzgjedhje të të dhënave hyrëse dhe verifikim/kontroll të njëpasnjëshëm në formë të iteracioneve. Mangësitë e specifikimit teknik të HGB-së të identifikuar në të kaluarën, na shtynë në zhvillimin e metodologjisë sonë për eliminimin e tërësishëm të tyre gjatë përzgjedhjes dhe përpunimit të të dhënave hapësinore, që rezultoi me zhvillimin e bazës së Shqipërisë me cilësi të lartë konform standardeve hartografike dhe standardeve të parapara në specifikimin teknik të HGB-së, e verifikuar në fazat e kontrollit të cilësisë së të dhënave të Shqipërisë të realizuara në kuadër të disertacionit dhe nga ASIG-u, si dhe nga Komiteti Ndërkombëtar i HGB-së. Baza e zhvilluar e Shqipërisë ka saktësi gjeometrike shumë më të lartë se standardeve hartografike për shkallën 1.000.000, për shkak të saktësisë së lartë të të dhënave vektoriale dhe rezolucionit hapësinor maksimal të lejuar prej 3” është arritur konzistencë e lartë logjike ndërmjet të dhënave vektoriale dhe rasteriale, përdorimi i kodit “UNK” është eliminuar tërësisht, si dhe është arritur konzistencë e plotë logjike ndërmjet shtresave vektoriale si rezultat i rregullave të përcaktuara dhe të zbatuara për modelim topologjik të të dhënave vektoriale në disertacion.

Baza e publikuar e Shqipërisë në kuadër të HGB-së dhe UNGIS-it ka përdorim shumëpërmasor në kuadër të infrastrukturës globale të të dhënave hapësinore zyrtare, në funksion të ruajtjes së mjedisit jetësor, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe planifikimit hapësinor në nivel ndërkombëtar, regjional dhe global. Kjo vjen si rrjedhojë e përmbajtjes së të dhënave në tetë shtresat tematike dhe karakteristikave cilësore dhe sasiore të tyre.

Përditësimi i bazës së të dhënave në periudhë pesëvjeçare mundëson monitorimin e ndryshimeve të mjedisit jetësor në mënyrë të integruar për gjithë rajonin deri në nivel kontinental dhe global. Për shkak të jokonzistencës logjike të bazave të shteteve të veçanta, zbatimi i analizave hapësinore kërkon resurse plotësuese të hulumtuesve për harmonizim të të dhënave, mirëpo baza e krijuar në nivel global ndihmon në zbatimin e analizave hapësinore për proceset që lidhen me mjedisin jetësor në nivel kombëtar, ndërkombëtar e deri në atë global.

Përditësimi i bazës së Shqipërisë duhet të kalojë në kompetencë institucionale të ASIG-ut, në bashkëpunim me institucionet relevante që zhvillojnë të dhëna që përmbajnë tetë shtresat kombëtare dhe dy shtresat globale të UNGIS-it, si pasardhës i HGB-së. Komisioni i ngritur nga drejtori i ASIG-ut e përfundoi me sukses punën për zhvillimin dhe publikimin e bazës së Shqipërisë në kuadër të HGB-së dhe inkuadrimit të Shqipërisë në kuadër të UNGIS-it. Ardhmëria e bazës së krijuar duhet të kalojë në mirëmbajtje dhe përditësim periodik, konform standardeve dhe kërkesave të UNGIS-it.

Promovimi i përdorimit të bazës së UNGIS-it para institucioneve dhe organizatave profesionale dhe shkencore në Shqipëri, duhet të jetë pikësynim i ASIG-ut me qëllim të përdorimit të bazës së UNGIS-it për studime të ndryshme ndërkombëtare nga studiues dhe institucione e organizata shqiptare.

Në universitetet shqiptare, në kuadër të lëndëve të studimit mbi infrastrukturën e të dhënave hapësinore, duhet të inkuadrohet ndërtimi dhe përdorimi i infrastrukturës globale të të dhënave hapësinore, duke përdorur shembullin e bazës së Shqipërisë në kuadër të UNGIS-it.

Specifikimet teknike të HGB-së, si pasardhës i saj edhe të UNGIS-it, gjatë ndërtimit të bazës së Shqipërisë dhe analizave të realizuara rezultuan të kenë mangësi, të cilat pamundësojnë përdorimin e menjëhershëm të tyre pas shkarkimit nga infrastruktura e HGB-së ose UNGIS-it, pa kaluar procesin e harmonizimit të të dhënave. Meqë bazat e shteteve të inkuadruara në UNGIS janë zhvilluar nga një bazë identike, teoretikisht ata duhet të jenë 100% të harmonizuara ndërmjet veti, mirëpo për shkak të disa mangësive të zbuluara në hulumtime të mëhershme dhe në këtë disertacion në standardet e shënuara në specifikimin teknik të HGB-së, në rastin e HGB-së dhe UNGIS-it teoria nuk mund të zbatohet në praktikë. Specifikimi teknik duhet të pësojë ndryshime duke eliminuar të gjitha zbrazëtirat e detektuara në këtë disertacion dhe në hulumtimet tjera paraprahe që shërbyen si referenca gjatë shqyrtimit të literaturës, me qëllim që të ketë përdorim më masiv të bazës së UNGIS-it, si pjesë e infrastrukturës globale të të dhënave hapësinore të ndërtuara nga autoritetet kombëtare për përdorim të hapur për qëllime jofitimprurëse.

Baza e të dhënave të UNGIS-it si pasardhëse e HGB-së mund të përdoret për monitorim të proceseve transformuese në natyrë, monitorim dhe administrim të burimeve natyrore, monitorim të tendencave për ndryshime rajonale deri në globale, planifikim hapësinor në nivel ndërkombëtar, zhvillim të ekosistemit, përdorim të pellgjeve ujëmbledhëse, zhvillim të qëndrueshëm strategjik në nivel rajonal etj. Përdorimi shumëpërmasor i bazës ekzistuese në UNGIS duhet të përkrahet me projekte inicuese nga autoritetet ndërkombëtare duke inkuadruar institucionet shkencore dhe autoritetet shtetërore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për përfitimet nga përdorimi i bazës së UNGIS-it për analiza në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me sektorët e përdorimit të cekur më sipër.

Nga ajo që u tha më lartë, si kontribute dhe arritje kryesore në disertacionin e doktoratës mund të veçohen:

1. Metodologjia e ndërtuar për selektimin, zhvillimin dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave në nivel kombëtar për inkuadrim në kuadër të HGB-së,
2. Inkuadrimi i bazës së Shqipërisë në HGB,
3. Inkuadrimi i bazës së Shqipërisë në UNGIS,
4. Inkuadrimi i të dhënave zyrtare të Shqipërisë në infrastrukturën globale të të dhënave hapësinore (Lubishtani and Idrizi, 2016)
5. Metodologjia e zhvilluar dhe e përdorur me ngritjen e standardeve të të dhënave, për eliminimin e ndikimit negativ të mangësive të specifikimit teknik në cilësinë e të dhënave të bazës së Shqipërisë në HGB dhe UNGIS,
6. Nivel i lartë i konzistencës logjike të shtresave tematike,
7. Plotësimi i të gjitha kritereve mbi cilësinë e të dhënave konform specifikimit teknik dhe kritereve hartografike, dhe
8. Detektimi i mangësive në specifikimin teknik të HGB-së për jokonzistencën logjike të dy shteteve fqinje në funksion të topologjisë dhe të ndryshimit të

srandardeve ndërmjet versioneve të ndryshme të specifikimeve teknike, si dhe struktura e kodizuar e tabelës së attributeve.

Logjikisht ajo duhet të jetë e lidhur me infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore të Shqipërisë, por që në rastin konkret dy infrastrukturat e Shqipërisë, ajo kombëtare dhe ajo globale nuk janë të lidhura njëra me tjetrën as në aspekt formal juridik e as në aspekt teknik në gjeoportalin shqiptar. Kjo paraqet sfidën e radhës së autoritetit shtetëror ASIG, që duhet ta realizojë në periudhën që pason, ose sfidë e ndonjë disertacioni të radhës!

10 Literatura

- ANZLIC, 2009, Homepage of the Spatial Information Council, Australia and New Zealand, (<http://www.anzlic.org.au>), (October 7, 2008).
- ANZLIC (2010) Spatial data infrastructure for Australia and New Zealand. http://www.anzlic.org.au/about_history.html, (13 May 2010).
- Bartha Gabor, (2011). STANDARDIZATION OF GEOGRAPHIC DATA: THE EUROPEAN INSPIRE DIRECTIVE, *European journal of Geography* 2.2 79-89, 2011.
- Beaumont, P., Longley, P.A. and Maguire, D.J. (2005). Geographic information portals--a UK perspective. *Computers, environment and urban systems*, 29(1): 49-69.
